



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë**  
**Bachelor në “Menaxhim Marketing”, ofruar nga Institucioni i**  
**Arsimit të Lartë**  
**Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc Dr. Elena KOKTHI

2. PhD. Ana BUHALJOTI

Mars/2024

**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**  
**Për Programin e studimit Bachelor në “Menaxhim Marketing” ofruar nga Institucioni i**  
**Arsimit të Lartë “Aleksandër Moisiu”, Durrës**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Aleksandër Moisiu, Durrës”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Marketingut
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Menaxhim Marketing”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 685, datë 25.08. 2010
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Riorganizuar me Vendim Senati Nr. 101, datë 14.06.2018, miratuar nga MASR me shkresën me Nr. 7243/1 Prot., datë 22.08.2018
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër i QSHA Nr. 266, datë 22.10.2022
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike / 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuhën shqipe dhe angleze
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli i 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Viti 2020-2021: 30 PAE / 5 PAK Viti 2021-2022: 29 PAE / 4 PAK Viti 2022-2023: 31 PAE / 3 PAK
18	Numri i studentëve:	Viti 2020-2021: 47 studentë Viti 2021-2022: 36 studentë Viti 2022-2023: 42 studentë
19	Komente / të tjera:	-




## PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti "Aleksandër Moisiu" është licencuar me vendim të Këshillit të Ministrave Nr.801 dt.20.12.2005 dhe ka marrë akreditimin e fundit institucional me Vendim të Bordit të Akreditimit me Nr.18, datë 24.03.2022, me kohëzgjatje 4 vite akademike, afati vlefshmërisë deri më 23.03.2026. Universiteti "Aleksandër Moisiu" sipas strukturës aktuale ka në përbërjen e tij pesë fakultete emërtuar si vijon:

1. Fakulteti i Biznesit;
2. Fakulteti i Edukimit;
3. Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike;
4. Fakulteti i Studimeve Profesionale;
5. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit.

Fakulteti i Biznesit është njësia kryesore ku ofrohet cikli i studimit Bachelor në "Menaxhim Marketing" pranë Departamentit të Marketingut. Fakulteti i Biznesit ka në përbërje të tij gjashtë departamente:

1. Departamenti Financë Kontabilitet;
2. Departamenti i Marketingut;
3. Departamenti i Menaxhimit;
4. Departamenti i Shkencave Ekonomike;
5. Departamenti i Turizmit;
6. Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar.

Departamenti i Marketingut ofron dy programe studimi në ciklin e parë 1. Menaxhim Marketing 180 ECTS, 2. Komunikim dhe Marketing Digjital 180 ECTS, si dhe dy programe në nivelin master. Përkatësisht, Master Shkencor në Menaxhim Marketing 120 ECTS dhe Master profesional në Menaxhim Marketing 60 ECTS të cilat janë hartuar në përputhje me Ligjin e fundit të Arsimit të Lartë Nr.80/2015, udhëzimet që pasuan atë si dhe në përputhje me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve. Departamenti i Marketingut ofron edhe ciklin e tretë të studimeve doktrale po në këtë fushë Menaxhim Marketing. Departamenti ku ofrohet programi i studimit ka në përbërje të tij 16 pedagogë të brendshëm, nga të cilët 7 në kategorinë profesor, 6 pedagogë mbajnë gradën doktor dhe 3 janë Msc.

Prioritetet e programit BA në Menaxhim Marketing (MM) janë në përputhje të plotë me ato të UAMD. Ky program studimi synon të bëhet një faktor kyç në disiplinën e menaxhimit të marketingut në rajonin e Durrësit dhe mw gjerë.

GVJ, vlerëson marrëveshjet institucionale me aktorë vendas e të huaj të cilat sigurojnë trajnimin e vazhduar të studentëve, integrimin në tregun e punës, përmirësimin e programit dhe rritje të kapaciteteve. Ndër avantazhet e programit të studimit është lidhja e studentëve me tregun e punës dhe ndërkombëtarizimi.

Gjithashtu, GVJ rekomandon analiza periodike të tregut me të dhëna primare nga biznesi për kompetencat e nevojshme duke pasur parasysh zhvillimet teknologjike si dhe zhvillimin e analizave periodike për përfitimet konkrete të marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit mësimor.

Programi është ndërtuar në përputhje me VKM 41/2018. Lëndët që përbëjnë programin e studimit BA MM mundësojnë dhënie e njohurive dhe aftësimin e studentëve në një spektër të gjerë fushash dhe disiplinash të lidhura me marketingun, biznesin dhe funksionet që zhvillohen brenda tij. GVJ rekomandon përmirësime në kategorizimin e lëndëve që e përbëjnë këtë program, si dhe një argumentim të vendosjes në program të lëndëve si Rajonizim Ekonomik dhe Shkenca Politike.

GVJ vlerëson që UAMD, më konkretisht Fakulteti i Biznesit ka vënë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit si dhe për formimin praktik të studentëve.



## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

ASCAL, bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga IAL, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof. Asoc. Elena Kokthi dhe Dr. Ana Buhaljoti. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga përfaqësuesja teknike e ASCAL, Znj. Ersi Dako.

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Marketing”, i ofruar nga Departamenti i Marketingut të Fakultetit të Biznesit pranë UAMD, filloi me prezantimin, si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga e-ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh, që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

Vizita në UAMD, u realizua në datën 19 dhe 20 Qershor 2023, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara sipas agjendës së vizitës në IAL. Gjatë vizitës, në UAMD, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) zhvilloi takime me: Përgjegjës të Departamentit të Marketingut dhe Dekanin e Fakultetit të Biznesit, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, stafin akademik të programit të studimit, stafin e Drejtorisë së Kurrikulave dhe të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrën e Burimeve Njerëzore, përfaqësues të Zyrës së Karrierës dhe Alumnit, Ndërkombëtarizmit dhe Projekteve; si dhe me Sekretarinë mësimore. GVJ zhvilloi gjithashtu intervista me studentët e programit, vizitoi Bibliotekën e Institucionit si dhe vëzhgoi mjediset e institucionit si: auditorë, laboratorë, shërbimet për studentët, etj.

Gjatë takimeve të realizuara sipas agjendës, u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit bachelor në Menaxhim Marketing, duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ekspertët kanë drejtuar pyetjet përkatëse. Pas vizitës në IAL, GVJ hartoi raportin e vlerësimit të jashtëm, bazuar në dokumentacionin në dispozicion nga dosja e vlerësimit të brendshëm, informacioni i depozituar në sistemin e informacionit të ASCAL, si dhe në informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitës të realizuar në Institucion.

Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm u përcoll në Institucion përmes AMS më datë 29.01.2024 dhe me shkresë zyrtare Nr. 19/17 Prot., datë 30.01.2024. Institucioni, përcolli përgjigjen për Draft-Raportin përmes AMS më datë 01.03.2024 dhe me shkresë zyrtare Nr. 433 Prot., datë 28.02.2024, përmes së cilës është shprehur se nuk ka komente. Për sa më lart, Draft-Raporti kthehet në Raport përfundimtar.

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Menaxhim Marketing”

### I. OFRIMI PROGRAMIT TË STUDIMEVE

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Universiteti Aleksandër Moisiu, UAMD ofron programin e studimit Bachelor në “Menaxhim Marketing” në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar. Ky program studimi është pjesë integrale e studimeve në Fakultetin e Biznesit në UAMD dhe është hapur me VKM Nr. 685, datë 25/08/2010 me 180 kredite dhe kohëzgjatje 3 vite akademike në përputhje me interesat dhe nevojat kombëtare.</p> <p>Kjo është evidentuar në Statutin e UAMD, Rregulloren e Fakultetit të Biznesit dhe Planin e Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025. Në këto evidenca theksohet se institucioni ofron programe studimi që kanë për qëllim të mbështesin prioritetet strategjike të vendit përmes formimit e kualifikimit të specialistëve të lartë të fushës së ekonomisë në përputhje me vlerat akademike kombëtare.</p> <p>Programi i studimit përfron zhvillimet e funksionit të Marketingut me interesat e industrisë dhe shoqërisë.</p> <p>Nga shqyrtimi i programit dhe diskutimet e zhvilluara me përfaqësues të UAMD, GVJ konstaton se programi Bachelor në “Menaxhim Marketing” është në përputhje me kërkesat e tregut kombëtar e ndërkombëtar të punës.</p> <p><i>Ev.1. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025.</i>  <i>Ev.2. Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës.</i>  <i>Ev.15. Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.4. Rregullore e Programit të studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Marketing” është hartuar në përputhje me mënyrën e organizimit të institucionit, të njësisë kryesore dhe në përputhje me qëllimin dhe misionin e UAMD, të shprehur në Statutin (Neni 3) të institucionit. Këtu gjejmë të përcaktuar se UAMD synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike,</p>




	<p>përmes nxitjes së lirisë akademike, kërkimit shkencor, dhe ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave kulturore kombëtare, duke u bërë kontribues në formimin e profesionistëve të rinj në zhvillimin e ekonomisë dhe shoqërisë shqiptare.</p> <p>Në përmbushje të misionit, GVJ konstaton se UAMD dhe Fakulteti i Biznesit mbështet programin e studimit Bachelor në “Menaxhim Marketing” me procese cilësore të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor me qëllim sigurimin e dijeve të qëndrueshme e bashkëkohore bazuar në dokumenta strategjike të institucionit.</p> <p><i>Ev.1. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025.</i>  <i>Ev.2. Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës.</i>  <i>Ev.3. Plani Strategjik per Departamentin e Marketingut-2021 – 2025.</i>  <i>Ev.15. Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.4. Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimit akademike të tij.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Menaxhim Marketing”, në emërtimin, organizimin dhe strukturën është në përputhje të plotë me Statutin dhe Rregulloren e institucionit. Programi është hartuar sipas strategjisë për zhvillim të UAMD, dhe rregullores së njësive përgjegjëse, Fakultetit të Biznesit dhe Departamentit Marketing.</p> <p>Përmes evidencave dhe takimeve, GVJ konstaton se programi Bachelor në “Menaxhim Marketing” është në përmirësim të vazhdueshëm në përputhje me drejtimet prioritare të institucionit dhe kërkesat e tregut.</p> <p><i>Ev.1. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025.</i>  <i>Ev.2. Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës.</i>  <i>Ev.3. Plani Strategjik per Departamentin e Marketingut-2021 – 2025.</i>  <i>Ev.4. Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i>  <i>Ev.15. Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.34. Rregullore e Departamentit Marketing.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>UAMD ka përvojën dhe kapacitetet në fushën akademike për përmbushjen e qëllimit të programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Marketing”. Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës (UAMD), është një institucion publik i arsimit të lartë që zhvillon veprimtari në fushën e arsimit dhe shkencës në Republikën e Shqipërisë, i krijuar me VKM Nr. 801, datë 20.12.2005 "Për hapjen e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës". Universiteti është i organizuar në pesë njësi kryesore:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Fakulteti i Biznesit;</li> <li>2. Fakulteti i Edukimit;</li> <li>3. Fakulteti i Shkencave Politiko-Jurisike;</li> </ol>




	<p>4. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit; 5. Fakulteti i Studimeve Profesionale.</p> <p>Në përbërje të çdo njësie kryesore gjenden njësitë bazë ose departamentet, që ofrojnë programe studimi në ciklin e parë dhe në ciklin e dytë.</p> <p>Departamenti Marketing, si njësi bazë e Fakultetit të Biznesit, nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies dhe veprimtaritë kërkimore të programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Marketing”, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik si edhe shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion të tij. Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Marketing” vë në efikasitet burimet njerëzore të UAMD pasi integron stafin e departamenteve të tjera me qëllim marrjen e njohurive dhe kompetencave në plotësimin e profilizimit në menaxhim marketing.</p> <p>GVJ konstaton se Statuti i UAMD, të dhënat Tabelore në Aneksin I të RVB për personelin akademik, të dhënat tabelore për numrin e programeve në ciklet e ndryshme të studimeve që ofrohen në UAMD si dhe tabela për ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik në të gjitha programet e studimit dëshmojnë për kapacitetet e duhura në ofrimin e programit të studimit.</p> <p><i>Ev.1. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025.</i> <i>Ev.2. Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës.</i> <i>Ev.3. Plani Strategjik per Departamentin e Marketingut-2021 – 2025.</i> <i>Ev.4. Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i> <i>Ev.15. Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i> <i>Ev.17. Raport Vjetor UAMD 2020-2021.</i> <i>Ev.34. Rregullore e Departamentit Marketing.</i> <i>Aneksi I i RVB.</i> <i>Tabela të përditësuara 2, 6, 12.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Marketing” ofrohet nga Departamenti i Marketingut, i cili është pjesë e Fakultetit të Biznesit. Fusha akademike që përfshin ky departament ka të bëjë me shkencën e administrimit të biznesit.</p> <p>Rregullorja e Programit të studimit është në përputhje me fushat didaktike dhe të kërkimit të programit nën njësinë kryesore Fakulteti i Biznesit. Departamenti i Marketingut ofron programin e studimit “Menaxhim Marketing” si në ciklin e parë Bachelor ashtu dhe në ciklin e dytë Master për të thelluar njohuritë dhe specializimin e studentëve.</p>






	<p>Veprimtaria akademike e UAMD zhvillohet në përputhje me parimet dhe standardet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë (HEAL), duke reflektuar parimet dhe objektivat e Procesit të Bolonjës, si dhe kornizën ligjore në fuqi në kodifikimin UAMD-BCH-60414-MEMA.</p> <p><i>Ev.1. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025.</i>  <i>Ev.3. Plani Strategjik per Departamentin e Marketingut-2021 – 2025.</i>  <i>Ev.4. Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i>  <i>Ev.10. Memo Kodifikimi i programeve.</i>  <i>Ev.11. Tabela e kodifikimit të programeve në UAMD.</i>  <i>Ev.15. Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.17. Raport Vjetor UAMD 2020-2021.</i>  <i>Ev.34. Rregullore e Departamentit Marketing.</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p>GVJ konstaton se UAMD ka përvojën dhe kapacitet në fushën akademike për përmbushjen e qëllimit të programit të studimit. Programi i studimit Bachelor në "Menaxhim Marketing" është në koherencë me strategjinë afatgjatë të institucionit për sa i përket përputhjes me fushën akademike dhe kërkimit shkencor, si dhe është në përputhje me direktivat dhe udhëzimet kombëtare e evropiane.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Mbikëqyrja dhe mbarëvajtja e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor "Menaxhim Marketing" bazohet tek Statuti I UAMD, Rregullorja e Fakultetit të Biznesit, Rregullorja e Departamentit Marketing si dhe tek Rregullorja e Programit të studimit, ku përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e të gjithë aktorëve të përfshirë. Fakulteti i Biznesit ka ngritur marrëdhënie bashkëpunimi midis departamenteve për të siguruar ecuri efektive të programit të studimit nëpërmjet ndarjes së detyrave, përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës (Ev. 116).</p> <p>Në Departamentin Marketing bëhet shqyrtimi dhe miratimi i planeve mësimore, hartimi dhe rishikimi i programeve të lëndëve (syllabuseve) bazuar në propozimet e nevojshme; shqyrtimin dhe miratimin i teksteve mësimore në lëndët e programit të studimit; si dhe ndjekja e realizimit të programit të studimit sipas planit të miratuar e cilësisë së mësimdhënies.</p>

	<p>Përgjegjësi i departamentit përgjigjet për vlerësimin e performancës së personelit akademik të Departamentit Marketing. Kjo performancë përfshin korrektesën në respektimin e orarit të punës, cilësinë e mësimdhënies në auditor dhe veprimtarinë e tij shkencore. I gjithë procesi për përmbushjen e disiplinave të formimit dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor mbikqyret nga instancat drejtuese të UAMD duke filluar nga Rektori, Dekani, Përgjegjësi i Departamentit, NJSBC etj. Çdo vit akademik realizohet dhe analizë e punës së njëjësive në përputhje me Rregulloren dhe Statutin e UAMD-së.</p> <p><i>Ev.1. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025.</i>  <i>Ev.2. Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës.</i>  <i>Ev.3. Plani Strategjik per Departamentin e Marketingut-2021 – 2025.</i>  <i>Ev.4. Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i>  <i>Ev.15. Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.17. Raport Vjetor UAMD 2020-2021.</i>  <i>Ev.21. Dep Marketingut Analiza Vjetore 2019-2020.</i>  <i>Ev.27. Organigrama FB.</i>  <i>Ev.28. Organigrama Departamenti i Marketingut 2022.</i>  <i>Ev.34. Rregullore e Departamentit Marketing.</i>  <i>Ev.46. Plani Mesimor Bsc. MM 2021-2024.</i>  <i>Ev116. RVB e fakultetit te biznesit 2020-2021.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>UAMD ka krijuar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, me objekt ndërtimin e kapaciteteve, shkëmbimin e burimeve njerëzore, ndërtimin e programeve të reja të studimit. Pjesë e bashkëpunimeve janë dhe përmes programit Erasmus+. Lista e bashkëpunimeve gjendet në evidencat 13,16,18,19. Gjatë viteve të fundit UAMD ka nënshkruar shumë marrëveshje institucionale dhe marrëveshje me bizneset e organizata. Qëllimi i tyre është trajnimi i vazhduar i studentëve, integrimi në tregun e punës, përmirësimi i programeve dhe rritje e kapaciteteve. Në evidencën 17 paraqiten infomacione mbi ndërkombëtarizimin e UAMD, projektet partnere dhe mobilitetet.</p> <p><i>Ev.13.Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.16.Marreveshjet e bashkepunimit Dep Marketingut.</i>  <i>Ev.17.Raport Vjetor UAMD 2020-2021.</i>  <i>Ev.18.Marreveshje Bashkepunimi UAMD.</i>  <i>Ev.19.Lista e marreveshjeve bilaterale per shkembime.</i>  <i>Ev.21.Dep Marketingut Analiza Vjetore 2019-2020.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për</p>	<p>UAMD ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me shumë struktura shtetërore dhe private. Në çdo marrëveshje bëhen të qarta format e bashkëpunimit dhe përgjegjësitë e secilës pale si dhe përcaktohen përgjegjësitë e punëdhënësve për mbikqyrjen e zhvillimit të praktikës</p>

<p>realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>profesionale nga studentët. Çdo punëdhënës bën vlerësimin e tij për studentin në çështje të caktuara të praktikës, vlerësim i cili dorëzohet para mbrojtjes së saj dhe merret në konsideratë në vlerësimin e studentit. Praktikant janë të rëndësishme jo vetëm për zhvillimin e shprehive praktike, por edhe për të rritur bashkëpunimin në fushën e kërkimit shkencor.</p> <p>Evidenca 18 përmban një listë të Institucioneve/kompanive në të cilat studentët mund të zhvillojnë praktikat e tyre.</p> <p><i>Ev.13.Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.16.Marreveshjet e bashkëpunimit Dep Marketingut.</i>  <i>Ev.17.Raport Vjetor UAMD 2020-2021.</i>  <i>Ev.18.Marreveshje Bashkëpunimi UAMD.</i>  <i>Ev.19.Lista e marreveshjeve bilaterale per shkembime.</i>  <i>Ev.21.Dep Marketingut Analiza Vjetore 2019-2020.</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësisia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Departamenti Marketingpërgjegjës për programin e studimit Bachelor në Menaxhim Marketing përmes strukturave të tij monitoron në vijimësi ecurinë e përgjithshme të punës dhe e integron në Analizën Vjetore (Ev.21) dhe Raportin Institucional vjetor të UAMD.(Ev. 17)</p> <p><i>GVJ inkurajon departamentin për vlerësimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit për këtë program studimi bazuar në treguesit si: realizimi i praktikave mësimore të studentëve pranë kompanive të ndryshme, realizimi i mobiliteteve të studentëve drejt universiteteve europiane, punësimi studentëve, realizimi studimeve shkencore nga stafi akademik, etj.</i></p> <p><i>Ev.13.Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.16.Marreveshjet e bashkëpunimit Dep Marketingut.</i>  <i>Ev.17.Raport Vjetor UAMD 2020-2021.</i>  <i>Ev.18.Marreveshje Bashkëpunimi UAMD.</i>  <i>Ev.19.Lista e marreveshjeve bilaterale per shkembime.</i>  <i>Ev.21.Dep Marketingut Analiza Vjetore 2019-2020.</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>UAMD ka krijuar marrëveshje dhe marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, dhe me shumë struktura shtetërore dhe private me objekt ndërtimin e kapaciteteve, shkëmbimin e burimeve njerëzore, ndërtimin e programeve të reja të studimit dhe aftësimin e studentëve për tregun e punës. Pjesë e bashkëpunimeve janë dhe përmes programit Erasmus+ me përfitim për stafin dhe studentët e programit të studimit. GVJ inkurajon zhvillimin e analizave periodike për përfitimet konkrete të marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit mësimor.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>




Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i Studimit Bachelor në Menaxhim Marketingu (MM) i ofruar nga Departamenti i Marketingut është i strukturuar në 3 vite studime, 6 semestra të rregullt me 180 ECTS, 60 kredite në vit, 30 kredite në çdo semestër.</p> <p>Programi dhe Plani mësimor i programit të studimit BA në MM ka të gjithë elementët në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e UAMD si dhe udhëzimet e MAS në këtë drejtim.</p> <p>Elementët që përbëjnë strukturën e programit të studimit janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Lëndët janë me 4, 5 ECTS, ndërsa praktika dhe detyrimet përmblyëse janë me 6 ECTS. Programi i studimit është i ndërtuar sipas Rregullores së Programit. Programi është i detajuar sipas planit mësimor i cili zberthen çdo modul në orë dhe kredite. Mbështetur në tabelat përmbledhëse të RVB, programi BA në MM është organizuar si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 3 vite akademike/6 semestra;</li> <li>- kredite për semester 30/ për vit akademik 60;</li> <li>- numri i moduleve 40, përfshirë praktikën dhe diplomën;</li> <li>- ngarkesa mësimore 4500 orë: 1785 orë në auditor; 2715 orë jashtë tij, 150 orë praktikë;</li> <li>- ngarkesa mësimore javore 21-22 orë;</li> <li>- forma e mësimdhënies: Leksione / seminare / ushtrime / projekte / detyra kursi.</li> </ul> <p><i>Ev.2. Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës.</i></p>

	<p><i>Ev.4. Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i></p> <p><i>Ev.23. Kurrikula dhe Plani Mësimor BSc MM 2021-2024.</i></p> <p><i>Ev.45. Përshkrimi BSc MM kurikula 2021-2024.</i></p> <p><i>Ev.46. Plani Mesimor Bsc. MM 2021-2024.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Lëndët që e përbëjnë programin e studimit BA MM mundësojnë dhënien e njohurive dhe aftësimin e studentëve në një spektër të gjerë fushash dhe disiplinash të lidhura me marketingun, botën e biznesit dhe funksionet që zhvillohen brenda tij. Programi është ndërtuar në përputhje me VKM 41/2018, i ndryshuar, përsa i përket përmbajtjes sipas kategorive:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Lëndë bazë (20%),</li> <li>• Lëndë karakterizuese (51.1%)</li> <li>• Lëndë plotësuese (13.3%)</li> <li>• Lëndë ndërdisiplinore (12.3%) dhe</li> <li>• Detyrime përmbyllëse (3.3%)</li> </ul> <p>Kështu në vitin e parë zhvillohen 14 lëndë në total, nga të cilat 6 lëndë janë të formimit të përgjithshëm, 4 lëndë karakterizuese për programin e studimit, 2 lëndë integruese dhe 2 lëndë plotësuese. <b><i>GVJ rekomandon një argumentim për përfshirjen e lëndës së Rajonizimit Ekonomik në vitin e parë. GVJ vlerëson që kjo tipologji krijon mundësi për një formim të përgjithshëm të studentit prandaj nevojitet argumenti për përfshirjen e kësaj lënde në këtë program studimi.</i></b> Në vitin e dytë, zhvillohen 13 lëndë, nga të cilat, 3 lëndë të formimit të përgjithshëm, 5 lëndë karakterizuese, 3 lëndë integruese dhe 2 lëndë plotësuese. Në këtë të fundit njëra nga lëndët lidhet me shkencat politike. <b><i>Si më sipër GVJ vlerëson që duhet të argumentohet pse kjo lëndë dhe jo një lëndë si psikologjia e cila nga pikëpamja e përmbajtjes ka më shumë rëndësi në menaxhimin e proceseve të marketingut duke qënë se ndihmon në kuptimin e sjelljes dhe cognitive biases në sjelljen e konsumatorit dhe strategjitë e marketingut në përgjigje të saj.</i></b></p> <p>Ndërsa në vitin e tretë zhvillohen 9 lëndë karakterizuese, 1 lëndë integruese, 1 lëndë plotësuese dhe detyrimet përmbyllëse. Lënda Drejtim i Burimeve Njerëzore është paraqitur si lëndë karakterizuese (B) ndërsa lëndë si E-marketing dhe Menaxhim Shitje si lëndë C. Duke pasur parasysh përmbajtjen e tyre dhe qëllimin e programit të studimit BA MM, <b><i>GVJ rekomandon rishikimin e klasifikimit të këtyre lëndëve. Më konkretisht, Drejtim Burimesh njerëzore në kategorinë C dhe E-Marketing dhe Menaxhim Shitje në kategorinë B.</i></b></p>
	<p><i>Ev.4.Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i></p> <p><i>Ev.23. Kurrikula dhe Plani Mësimor BSc MM 2021-2024.</i></p> <p><i>Ev.45. Përshkrimi BSc MM kurikula 2021-2024.</i></p>

	Ev.46. Plani Mesimor Bsc. MM 2021-2024.
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Mbështetur në VKM 41/2018, e ndryshuar, dhe në Rregulloren e Programit të studimit BA në MM, programi është organizuar si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kategoria A - Lëndë Bazë-përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme 36 ECTS ose 20%, <b>standardi (13-20%)</b>;</li> <li>- Kategoria B - Lëndë Karakterizuese-përgatitje për disiplinën shkencore, kategoria 92 ECTS ose 51.1%, <b>standardi (50-55%)</b>;</li> <li>- Kategoria C - Lëndë ndërdisiplinore/integruese-nëndisiplina, profile dhe grup-lënde me zgjedhje 24 ECTS ose 13.3%, <b>standardi (12-15%)</b>;</li> <li>-Kategoria D - Lëndë plotësuese-gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale, 22 ECTS ose 12.3%, <b>standardi (10-15%)</b>;</li> <li>- Kategoria E - Detyrimet përmbyllëse, 6 ECTS ose 3.3%, <b>standardi (3-5%)</b>.</li> </ul> <p>Mbështetur në Tabelat Përmbledhëse të RVB, programi BA në MM është organizuar si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 3 vite akademike/6 semestra;</li> <li>- kredite për semester 30/ për vit akademik 60;</li> <li>- numri i moduleve 40, përfshirë praktikën dhe diplomën;</li> <li>- <b>ngarkesa mësimore 4500 orë: 1785 orë në auditor; 2715 orë jashtë tij, 150 orë praktikë</b></li> <li>- ngarkesa mësimore javore 21-22 orë;</li> <li>- forma e mësimdhënies: Leksione / seminare / ushtrime / projekte / detyra kursi.</li> </ul> <p>Ev.2.Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës. Ev.4.Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing. Ev.4.Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing. Ev.23.Kurrikula dhe Plani Mësimor BSc MM 2021-2024. Ev.45.Përshkrimi BSc MM kurikula 2021-2024. Ev.46.Plani Mesimor Bsc. MM 2021-2024.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Praktika profesionale është 6 ECTS në programin e studimit BA në MM. Gjatë vizitës në institucion, diskutuam për mënyrën si organizohet praktika. Departamenti cakton një grup pedagogësh për organizimin dhe ndjekjen e saj, si rregull zhvillohet në semestrin e dytë të vitit të tretë, përkatësisht nga 5 orë në javë për një periudhë tre mujore. Praktika zhvillohet pranë organizatave me të cilat Fakultetit i Biznesit ka marrëveshje. Në fund të saj, studentët përgatisin dosjen, të cilën e</p>




	<p>mbrojnë përpara një komisioni dhe vlerësohen me notë. Organizimi praktikës mbështetet në Rregulloren e Praktikës.</p> <p>Në lidhje me Detyrimet Përmbyllëse, ato organizohen në formën e një provimi përfundimtar për studentët me mesatare mbi 7 punim diplome. Në rastin kur studenti ka një mesatare nën notën 7, studenti i shlyen detyrimet përmbyllëse duke zhvilluar provimin për mbylljen e studimeve. Detyrimet përmbyllëse janë 6 ECTS, pesha në kurrikul është 3.3%, standardi (3-5%) sipas VKM 41/2018, e ndryshuar.</p> <p><i>Ev.25.Rregullore e Detyrimeve Përmbyllëse cikli Bachelor (neni 2).</i>  <i>Ev.24.Formulari i Vlerësimit të Praktikës Profesionale.</i>  <i>Ev.13.Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.16.Marreveshjet e bashkëpunimit Dep Marketingut.</i>  <i>Ev.18.Marreveshje Bashkëpunimi UAMD.</i>  <i>Ev.38.Rregullore provimesh FB.</i>  <i>Ev.67.Rregullore Diplomimi.</i>  <i>Ev.68.Evidence komunikim student udhëheqes diplome me email.</i>  <i>Ev.70.Proçes-verbal i mbrojtjes së temës së diplomës Bachelor "Menaxhim Marketing".</i>  <i>Ev.71.Diplomë dhe Supplement i Diplomës.</i>  <i>Ev.124.Rregullore praktike.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>N/A</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në "Menaxhim Marketing" i ofruar nga Departamenti i Marketingut në FB të UAMD, ka ngjashmëri me programet e Menaxhim Marketing të ofruara nga IAL shqiptare.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Bazuar në VKM Nr. 310, dt 11.05.2022 për specifikimet dhe kodifikimet e programeve të studimit të ofruara nga IAL-të, si dhe në udhëzimet e MAS, programi BA-MM është i pajisur me kodin "UAMD-BCH-60414-MEMA"</p> <p><i>Ev.10. Memo Kodifikimi i programeve.</i>  <i>Ev.11. Tabela e kodifikimit të programeve në UAMD.</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>N/A</p>

<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ vlerëson që organizimi i programit bëhet në përputhje me ligjin nga pikëpamja e formës. Nevojiten përmirësime në kategorizimin e lëndëve që e përbëjnë këtë program, si dhe një argumentim të vendosjes në program të lëndëve si Rajonizim Ekonomik, Shkenca Politike.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi II.2</b>	
<b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>UAMD disponon akreditimin e fundit institucional me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr.18, datë 24.03.2022, me kohëzgjatje 4 vite akademike, me afat vlefshmërie deri më 23.03.2026. Universiteti “Aleksandër Moisiu” sipas strukturës aktuale ka në përbërjen e tij pesë fakultete emërtuar si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Fakulteti i Biznesit;</li> <li>• Fakulteti i Edukimit;</li> <li>• Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike;</li> <li>• Fakulteti i Studimeve Profesione</li> <li>• Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit;</li> </ul> <p>Fakulteti i Biznesit është njësia kryesore ku ofrohet cikli i studimit Bachelor në “Menaxhim Marketing” pranë Departamentit të Marketingut. Fakulteti i Biznesit ka në përbërje të tij 5 departamente:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti Financë Kontabilitet;</li> <li>2. Departamenti i Marketingut;</li> <li>3. Departamenti i Menaxhimit;</li> <li>4. Departamenti i Shkencave Ekonomike;</li> <li>5. Departamenti i Turizmit;</li> <li>6. Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar.</li> </ol> <p>Departamenti i Marketingut ofron dy programe studimi në ciklin e parë 1.Menaxhim Marketing 180 ECTS; 2.Komunikim dhe Marketing Digjital 180 ECTS, si dhe dy programe në nivelin master. Përkatësisht, Master Shkencor në Menaxhim Marketing 120 ECTS dhe Master Profesional në Menaxhim Marketing 60 ECTS të cilat janë hartuar në përputhje me Ligjin e fundit të Arsimit të Lartë Nr.80/2015, udhëzimet që pasuan atë si dhe në përputhje me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve. Departamenti i Marketingut ofron edhe ciklin e tretë të studimeve doktorale po në këtë fushë Menaxhim Marketing.</p> <p>GVJ konstaton se Departamenti i Marketingut, në vitin aktual 2022-2023, ka 34 personel akademik gjithsej, 31 pedagogë me kohë të plotë</p>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike. etj.	



(PAE), 3 pedagogë me kohë të pjesshme (PAK), si dhe 1 personel ndihmës. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, referuar listës së stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi (tabelat shtesë të marra gjatë vizitës në institucion):

1. Për vitin akademik 2020-2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 35 pedagogë nga të cilët 30 PAE dhe 5 PAK (85.7% / 14.3%);
2. Për vitin akademik 2021-2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 33 pedagogë nga të cilët 29 PAE dhe 4 PAK (87.9% / 12.1%);
3. Për vitin akademik 2022-2023 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 34 pedagogë nga të cilët 31 PAE dhe 3 PAK (91.2% / 8.8%).

Njësia bazë, Departamenti i Marketingut përgjegjës për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë për vitet akademike:

Tituj/grada	2020 - 2021		2021 - 2022		2022 - 2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	-	-	2	-	2	-
Prof.As.Dr	6	-	6	-	8	-
Dr/PhD	19	2	16	1	16	-
Msc	6	3	5	3	5	3
Në total	31	5	29	4	31	3

Departamenti i Marketingut është e organizuar në dy grupe mësimore kërkimore, Grupi Mësimor – Kërkimor: Menaxhim Marketingu dhe Grupi Mësimor – Kërkimor: Metodatat e Kërkimit, Teknologjia dhe Inovacioni.

Struktura, detyrat dhe përgjegjësitë e njësisë kryesore dhe asaj bazë që është përgjegjëse për programin e studimit, janë të përcaktuara në statutin e institucionit dhe janë në përputhje me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë. Dekani i Fakultetit të Biznesit mban titullin akademik “Profesor Doktor” ndërsa Përgjegjësi i Departamentit titullin akademik “Profesor i Asociuar”.

Për sa më sipër Njësia kryesore (FB) dhe njësia bazë përgjegjëse për programin, përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për:

- numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik;
- organizimin dhe strukturën akademike;

*Ev. tabelat shtesë të marra gjatë vizitës në institucion.*

	<p><i>Ev. Tabelat Menaxhim Marketing.</i>  <i>Ev. 27. Organigrama FB.</i>  <i>Ev.28. Organigrama Departamenti i Marketingut 2022.</i>  <i>Ev.73. Organigrama Departamenti Marketing viti 2022.</i>  <i>Ev.74. CV-te e stafit te departamentit marketing.</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Bazuar në Ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, Rregullorja e UAMD, Rregullorja e departamentit dhe Rregullorja e Programit ka të parashikuar koordinatorin e programit të studimit Menaxhim Marketing.</p> <p><i>Ev.37.Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.</i>  <i>Ev.15.Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.4.Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i>  <i>Ev.15.Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.33.Vendimi i Departamentit për përcaktimin e Koordinatorit të BSc MM.</i>  <i>Ev.34.Rregullore e Departamentit Marketing.</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson që njësia kryesore, Fakulteti i Biznesit dhe njësia bazë, Departamenti i Marketingut, përmbushin kërkesat ligjore në lidhje me numrin e departamenteve dhe stafin akademik në to.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi II.3</b>  <b>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Bazuar në dosjen e plotë të programit të studimit Menaxhim Marketing, në përmbajtjen e silabuseve, në mënyrën e konceptimit të orës së mësimit, kontrollit të njohurive, të ftuarit në leksion, evidentohet që pedagogët përpiqen të bashkojnë nevojat lokale me ato globale, <i>por mbetet ende për t'u bërë në drejtim të diferencimit me programe të ngjashme studimi që ofrohen gjithashtu nga Departamenti i Marketingut si psh "Komunikim dhe Digjital Marketing" sepse ky i fundit mund të jetë pjesë e një programi të vetëm.</i></p> <p>Në faqen zyrtare në internet të UAMD, studentët e FB njihen mbi dokumentat kryesore, planet dhe programet mësimore dhe shumë informacione të tjera në funksion të regjistrimeve dhe kalendarit akademik.</p> <p><a href="https://uamd.edu.al/menaxhim-marketing/">https://uamd.edu.al/menaxhim-marketing/</a></p> <p><i>Ev.13.Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.16.Marreveshjet e bashkëpunimit Dep Marketingut.</i></p>

	<i>Ev.18.Marreveshje Bashkepunimi UAMD.</i>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor. ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Sikurse është përmendur edhe më sipër, mbështetur në VKM 41/2018, e ndryshuar dhe në Rregulloren e Programit të studimit BA në MM, programi është organizuar si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kategoria A-Lëndë Bazë - përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme 36 ECTS ose 20%, <i>standardi (13-20%)</i>;</li> <li>- Kategoria B-Lëndë Karakterizuese - përgatitje për disiplinën shkencore, kategoria 92 ECTS ose 51.1%, <i>standardi (50-55%)</i>;</li> <li>- Kategoria C-Lëndë ndërdisiplinore/integruese - nëndisiplina, profile dhe grup-lënde me zgjedhje 24 ECTS ose 13.3%, <i>standardi (12-15%)</i>;</li> <li>- Kategoria D-Lëndë plotësuese - gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale, 22 ECTS ose 12.3%, <i>standardi (10-15%)</i>;</li> <li>- Kategoria E - Detyrimet përmblylëse, 6 ECTS ose 3.3%, <i>standardi (3-5%)</i>.</li> </ul> <p>Syllabuset e lëndëve paraqesin informacionet e parashikuara në VKM si dhe informacione për kontrollin e njohurive si frekuentimin të cilat ju bëhen me dije studentëve në fillim të vitit akademik. Mënyra e vlerësimit është me një provim të ndërmjetëm (i cili ka 400 pikë të mundshme), provimi përfundimtar (i cili ka 500 pikë) dhe detyrat e kursit (të cilat kanë 100 pikë të mundshme). Në total studenti/ja mund të përfitojë 1000 pikë të mundshme. Vlerësimi përfundimtar bëhet mbi bazën e pikëve të grumbulluara dhe përqindjeve përkatëse. Studenti duhet të ketë përvetësuar 60% të lëndës që të marrë notën kaluese. Të gjitha provimet zhvillohen me shkrim.</p> <p><i>Ev.4.Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i></p> <p><i>Ev.23.Kurrikula dhe Plani Mësimor BSc MM 2021-2024.</i></p> <p><i>Ev.45.Përshkrimi BSc MM kurikula 2021-2024.</i></p> <p><i>Ev.46.Plani Mesimor Bsc. MM 2021-2024.</i></p> <p><i>Ev.31. Syllabuset e Lëndëve BSc.MM.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Kriteret e pranimit të studentëve në Programin BA në MM janë kriteret ligjore të përcaktuara nga MAS dhe udhëzimet që dalin për rregjistrimet në universitete çdo vit akademik.</p> <p>Në Rregulloren e UAMD dhe të programit të studimit, qartësohen kushtet dhe procedurat e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit. Përgjithësisht UAMD dhe FB nuk përcaktojnë kritere shtesë përpos kritereve ligjore.</p>
	<p><i>Ev.4.Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing (Kreu IV, neni 27).</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe takimit më drejtueset, GVB, stafin akademik dhe Zyrën e Kurrikulave dhe Cilësisë, GVJ evidentoi që</p>

për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	<p>programi i studimit silabusit përmban të gjithë elementët në përputhje me VKM 41/2018, e ndryshuar. Më sipër janë detajuar elementët informues sa i takon komponentëve si orë leksion, seminare, brenda auditorit dhe jashtë tij.</p> <p><i>Ev.23.Kurrikula dhe Plani Mësimor BSc MM 2021-2024.</i>  <i>Ev.45.Përshkrimi BSc MM kurikula 2021-2024.</i>  <i>Ev.46.Plani Mesimor Bsc. MM 2021-2024.</i>  <i>Ev.31.Syllabuset e Lëndëve BSc. MM.</i></p>			
<b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	<p>Gjatë vizitës në institucion, diskutuam që përtej ndryshimeve të vogla që programi pëson vit pas viti, nevojitet që Departamenti i Marketigut, të bëjë një vlerësim nisur nga disa burime informacioni:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- programeve të universiteteve perëndimore dhe ballkanike (jo të kryeqyteteve dhe qendrave metropolitane të mëdha);</li> <li>- nevojat e tregut të punës lokal dhe kombëtar;</li> <li>- tryezave të rrumbullakta me alumni, ekspertë dhe kolegë;</li> <li>- fokus grupeve me studentë të BA dhe MM.</li> </ul>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ vlerëson që programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.4</b>	
<b>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	<p>Në takimin që GVJ zhvilloi me përgjegjësin e Departamentit të Marketingut, u theksua se programi BA në MM siç kemi theksuar dhe më lart në këtë raport, mbështetet në përvojën e hershme të Departamentit me këtë program studimi, që nis në vitin 2009. Në ndryshim nga Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Tiranës, u inicua një program i veçantë në Menaxhim Marketing. Rreth 20% e studentëve vijnë nga Tirana. Mbështetur në Rregulloren e Programit, silabuset e lëndëve, mund të themi që lëndët dhe përmbajtja e tyre, shërbejnë për të krijuar njohurinë dhe aftësuar studentëve në fushat bazë e marketingut dhe menaxhimit të tij në fushën e biznesit. Ky program studimi u krijon mundësi që të përsosin të menduarin kritik dhe instrumenta të analizës, duke u përqasur si në funksion të nevojave që tregu lokal apo ndërkombëtar të punës. Ky program krijon një bazë të domosdoshme për studime të tjera e thellime në fusha më specifike të</p>
<b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	
<b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raportit teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	

<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>biznesit. <i>Megjithatë, GVJ vlerëson që ka shume ngjashmëri me programet e ofruara nga Departamenti i Menaxhimit. Në këtë kuadër, njësia bazë por edhe ajo kryesore sugjerohet të promovojnë ndryshimet midis programeve të studimit që ata ofrojnë dhe kë inventar kapacitetesh dhe njohurish kanë objektiv të ofrojnë me segmente punonjësish të caktuar.</i></p> <p>Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formuese, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p> <p><i>Ev.4.Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i>  <i>Ev.23.Kurrikula dhe Plani Mësimor BSc MM 2021-2024.</i>  <i>Ev.45.Përshkrimi BSc MM kurrikula 2021-2024.</i>  <i>Ev.46.Plani Mesimor Bsc. MM 2021-2024.</i>  <i>Ev.31.Syllabuset e Lëndëve BSc. MM.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Në lidhje me syllabuset, sikurse e kemi përmendur edhe më lart, formati i silabusit është përshtatur sipas VKM 41/2018, e ndryshuar. <i>Në disa raste literatura nuk është e 5 viteve të fundit në lëndët si Bazat e Biznesit, Makroekonomi I, Shkrim Akademik, Hyrje në Shkencat Politike, Metodat e Kërkimit Shkencor, Drejtim Marketing. Nga analiza e programeve mësimore, u konstatua mungesa e integritit të hulumtimeve shkencore të pedagogëve në literaturën e sugjeruar. Ky inkorporim do të ngrinte cilësinë e stafit akademik në fushat që ata mbulojnë.</i> Po kështu departamenti na ka vënë në dispozicion dhe një praktikë të ndryshimit të syllabusit në funksion të kompetencave të reja të nevojitura.</p> <p><i>Ev.46.Plani Mesimor Bsc. MM 2021-2024.</i>  <i>Ev.31.Syllabuset e Lëndëve BSc. MM.</i>  <i>Ev.44.Raport mbi ndryshimin e Syllabusit te lendes Kerkim Marketing.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Qëllimi dhe objektivat e këtij programi studimi janë në përputhje të plotë me qëllimin që Ligji i Arsimit të Lartë i atribuon programeve bachelor. Struktura dhe përmbajtja e programit, përmbajtja e silabuseve, raporti teori-praktikë synon të garantojë formimin të mirë të studentëve nga pikëpamja njohurive dhe aftësimi praktik, për t’ju përgjigjur dinamikave të tregut lokal dhe global. Element i rëndësishëm është fokusimi i studentëve në raporte ndërveprimi me tregun e punës përmes orëve të hapura si dhe Panairit të Punës që do të jenë në fokus të Departamentit të Marketingut.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Mënyra si konceptohet dhe zhvillohet praktika mësimore, krijon hapësira për aftësimin, por dhe oportunitet për t’u punësuar. Po kështu studentët që mbarojnë këtë program studimi mund të vazhdojnë studimet në nivelin master shkencor dhe profesional.</p> <p><i>Ev.46.Plani Mesimor Bsc. MM 2021-2024.</i></p>

	<i>Ev.31.Syllabuset e Lëndëve BSc.MM.</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ vlerëson që struktura dhe organizimi është në përputhje me objektivat, përmbajtja është dhe duhet të jetë në një proces përmirësimi dhe përditësimi në përputhje me zhvillimet në tregun e punës dhe qasjet e reja të shoqërisë. Në disa raste literatura nuk është e 5 viteve të fundit. Mendojmë e sugjerojmë më shumë diferencim me programet e studimit të ofruar nga vetë Departamenti i Marketingut dhe Departamenti i Menaxhimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi II.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës. gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Tregu i punës sot është ndikuar në mënyrë të thellë nga dinamikat lokale dhe globale, veçanërisht në fushat e menaxhimit dhe marketingut, ku zhvillimet teknologjike po ndodhin me një ritëm shumë të shpejtë. Kjo epokë e re, e karakterizuar nga inovacioni i shpejtë dhe ndryshimi i vazhdueshëm, ka sfiduar thellësisht institucionet arsimore, veçanërisht universitetet. Pavarësisht përpjekjeve për të qëndruar në krye të valës së ndryshimit, universitetet po përballen me vështirësi të konsiderueshme në përditësimin e kurrikulave dhe metodave të mësimdhënies në mënyrë që të pasqyrojnë këto trende të reja. Kjo hap një hendek ndërmjet asaj që mësohet në mjediset akademike dhe aftësive të kërkuara në tregun e punës, duke e bërë më të vështirë për të sapo diplomuarit të përshtaten me kërkesat e vazhdueshëm në ndryshim të peizazhit profesional. Në këtë kontekst, adaptueshmëria dhe njohja e vazhdueshme e nevojave të tregut janë bërë më të rëndësishme se kurrë, duke sfiduar universitetet të rishikojnë dhe të përshtatin qasjet e tyre në arsimit të lartë.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	
<b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	<i>Në këtë kuadër, ekzistojnë praktika të mira të bashkëpunimit FB-UAMD me industrinë lokale por ato kanë nevojë të monitorohen dhe të bëhen më të qëndrueshme, madje dhe në nivel departamenti sa i përket prurjes së ideve që biznesi ka në rishikimin e vazhdueshëm të programit. GVJ vlerëson që programet e studimit të ofruar nga Departamenti i Marketingut vijon të ketë studentë, por tkurrja e numrit të studentëve e bën të nevojshëm analizën e avantazhit krahasues të një studenti që diplomohet në programin e studimit BA Marketing Menaxhim, BA "Komunikim dhe Digjital Marketing" si dhe programet e ofruar nga Departamenti i Menaxhimit.</i>

Pozitive janë raportet e pedagogëve me organizatat/bizneset, bashkëpunimi ndodh, thjeshtë në një pjesë të rasteve duhet formalizuar, ndërkohë universiteti duhet të decentralizojë buxhetin dhe ta drejtojë për intensifikimin e këtyre bashkëpunimeve.

Panairi i Punës, Konferencat studentore dhe praktikat mësimore, leksionet me të ftuar nga biznesi/institucionet përbëjnë një mundësi për ndërveprim, feedback dhe propozime konkrete. Pozitiv është fakti që një pjesë e pedagogëve të jashtëm vinin nga eksperiencia biznesi, drejtimi institucionesh dhe organizatash me peshë në zonën e Durrësit, të cilët luajnë një rol të rëndësishëm në ndërveprimin universitet – biznes ose departament- biznes.

Përfshirja e studentëve në diskutimet e përmirësimit të programit bëhet përmes rrugëve formale dhe joformale. Drejtuesi i departamentit, dhe pedagogët u shprehën gjatë takimeve në institucion që në mënyrë periodike takohet dhe diskuton me studentët për procesin mësimor, problematikat e ndeshura, përmbajtjen e lëndëve etj. Gjithashtu, në nivel institucioni, bazuar në elementët e ofruar në kuadër të paketës cilësisë (Evidenca 104-110) bëhen pyetësorë për vlerësimin e programit dhe të mësimdhënies, rezultatet e të cilave shërbejnë për të diskutuar e marrë vendime të mëtejshme.

*Ev.16. Marreveshjet e bashkëpunimit Dep Marketingut.*

*Ev.17. Raport Vjetor UAMD 2020-2021.*

*Ev.18. Marreveshje Bashkëpunimi UAMD.*

*Ev.19. Lista e marreveshjeve bilaterale per shkembime.*

*Ev.20. Lista e Mobiliteteve te Stafit \_ Studenteve.*

*Ev.21. Dep Marketingut Analiza Vjetore 2019-2020.*

*Ev.22. Call for Papers - ISCOIM 2022.*

*Ev.23. Kurrikula dhe Plani Mësimor BSc MM 2021-2024.*

*Ev.83. Vendim grupi i punes\_paniri i punes dhe i karrieres.*

*Ev.84. Draft\_Agjendë\_panairi i punes dhe i karrieres 2022.*

*Ev.49. Të dhëna ALUMNI mbi punësimin e studentëve.*

*Ev.50. Formulari i vlerësimit të lektorëve nga studentët - final*

*Ev. 51. Shoqata Alumni UAMD dhe Aktivitetet.*

*Ev.104. Pyetsor online për studentët nga Njësia Kryesore për vlerësimin e stafit administrativ dhe akademik.*

*Ev.105. Raport vlerësimi për stafin akademik nga studentët shembull.*

*Ev.106. Pyetesor per studentet Bsc MM mbi permisimin e metodikes se mesimdhënies.*

*Ev.107. Relacion i NjBSC mbi realizimin e mesimdhënies online dhe pyetesori.*

*Ev.108. Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD.*

*Ev.109. Model pyetsori për vlerësimin e stafit akademik*

*Ev.110. Formular vetvleresimi.*

<b>Konkluzione</b>	<p>GVJ vlerëson se në mënyrë formale dhe joformale, studentët bëhen pjesë e procesit të përmirësimit të vazhdueshëm. Gjithashtu, vlen të theksohet dhe mënyra se si bashkëpunojnë me institucione, biznese dhe organizata të tjera dhe si ndikonin veprimtaritë e tyre. Për të adresuar tkurrjen e numrit të studentëve në Departamentin e Marketingut, rekomandohet për tu patur në konsideratë në të ardhmen një analizë e thellë e avantazhit krahasues të programeve të studimit si BA Marketing Menaxhim dhe BA "Komunikim dhe Digjital Marketing", si dhe të atyre të ofruara nga Departamenti i Menaxhimit. Kjo analizë duhet të përqendrohet në:</p> <p>Ndërthurjen me Trendet e Tregut-Identifikimi i mënyrave se si këto programe i përgjigjen kërkesave aktuale dhe të ardhshme të tregut të punës. Për shembull, vlerësimi i aftësive digjitale dhe analitike që janë në kërkesë dhe përfshirja e tyre në kurrikula;</p> <p>Bashkëpunimet me Industrinë- Krijimi i partneriteteve me kompani dhe organizata për të ofruar praktika, projekte dhe raste studimore që janë të lidhura ngushtë me sfidat reale të biznesit;</p> <p>Përshtatshmëria dhe Inovacioni në Mësimdhënie- Integrimi i metodave të reja të mësimdhënies që përfshijnë mësimdhënie hibride, projekte praktike dhe përdorimi i teknologjisë për të pasuruar përvojën e mësimi.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X
--	----------------	-----------------------	----------------------	----------------------------

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transferimit të dijeve e njohurive në Bachelor "Menaxhim Marketing" janë leksionet, seminarët, detyra e kursit, projektet, praktikat profesionale dhe provim përmbyllës/diploma. GVJ konstaton se janë shprehur të detajuara në planin mësimor dhe programet e lëndëve dhe janë të evidentuara në Rregulloren e Fakultetit dhe të Programit të Studimit.



Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor “Menaxhim Marketing” realizohet me 180 kredite me kohëzgjatje normale 3 vite akademike. Programi është i organizuar në 40 module përfshirë praktikën dhe diplomën; ngarkesa mësimore 4500 orë: 1785 orë në auditor; 2715 orë jashtë tij, 150 orë praktikë. Format e mësimdhënies: Leksione / seminare / ushtrime / projekte / detyra kursi. Bazuar në disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese, që ofrohen në këtë program studimi, janë të organizuara në kategori të klasifikuara nga A në E.

Kuadri i përgjithshëm formues i programit të studimit:

Kategoria	Kriteri për Bachelor (VKM 41, dt. 24.01.2018)	Kreditet përkatëse për kategori të programit	% e ECTS /kategoritë të programit
A	15%-20%	36	20%
B	50%-55%	92	51.1%
C	12%-15%	24	13.3%
D	10-15%	22	12.3%
E	3%-5%	6	3.3%
Σ		180	100%

Kreditet e çdo lënde mbajnë parasysh ngarkesën në orë mësimore në auditor, si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Një kredit është 25 orë mësimore pune të studentit, e përbërë nga orë mësimore për transmetim dijesh në auditor dhe orë mësimore për përgatitje ose punë individuale të studentit.

Mësimdhënia/mësimnxënia rregullohet në Statut, Rregulloren e Fakultetit dhe Rregulloren e Programit të Studimit, që shërbejnë si referencë me nenet përkatëse.

Përmirësimi i metodave të mësimdhënies përbën prioritet për njësinë (Departamentin e Marketingut), dhe është reflektuar në dokumenta zyrtarë si *Ev.3. Plani Strategjik per Departamentin e Marketingut-2021 - 2025*, por dhe në takimet e GVJ me Përgjegjësën e Departamentit dhe

	<p>stafin akademik të programit të studimit. <i>GVJ konstatoi një përpjekje serioze nga ana e stafit në dobi të rritjes së nivelit të mësimdhënies dhe për një përfshirje aktive të studentëve gjatë orës së mësim, në diskutimin e rasteve studimore dhe detyrave në grup e individuale. Kjo e fundit u pohua dhe gjatë takimit që GVJ zhvilloi me studentët, të cilët vlerësonin interaktivitetin në klasë, diskutimet gjatë orës së mësimit të rasteve praktike dhe marrëdhënien e gadishmërinë e pedagogëve.</i></p> <p><i>Ev.2.Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës.</i>  <i>Ev.3.Plani Strategjik per Departamentin e Marketingut-2021 – 2025.</i>  <i>Ev.4.Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i>  <i>Ev.15.Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.23.Kurrikula dhe Plani Mësimor BSc MM 2021-2024.</i>  <i>Ev.34.Rregullore e Departamentit Marketing.</i>  <i>Ev.46.Plani Mesimor Bsc. MM 2021-2024.</i>  <i>Ev.116.RVB e fakultetit te biznesit 2020-2021.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Personeli akademik respekton nevojat e studentëve, duke ofruar metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në Menaxhim Marketing. Pjesa më e madhe e moduleve të programit përmbajnë detyrime për përgatitjen e detyrave të kursit në grup, të cilat i aftësojnë studentët për përthithjen dhe zbatimin e informacionit teorik.</p> <p>Nga takimi që GVJ zhvilloi me studentë të programit u theksua se diskutime dhe punë në grupe, krijimi i skenarëve të diskutimit gjatë lëndëve nxisin interesin dhe të menduarit kritik.</p> <p>Format e mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe kontrollit të dijeve parashikohen në planet mësimore dhe syllabuset e lëndëve.</p> <p><i>Ev.4.Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i>  <i>Ev.15. Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.23.Kurrikula dhe Plani Mësimor BSc MM 2021-2024.</i>  <i>Ev.31.Syllabuset e Lëndëve BSc. MM.</i>  <i>Ev.34.Rregullore e Departamentit Marketing.</i>  <i>Ev.46.Plani Mesimor Bsc. MM 2021-2024.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësit.</p>	<p>UAMD mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet homologe. Objekti kryesor i këtyre marrëveshjeve përfshin: shkëmbimin e personelit akademik (pedagog, kërkues) për procesin mësimor dhe veprimtari kërkimore; nxitjen dhe realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore shkencore; organizimin e konferencave, trajnimeve, seminareve, shkëmbimin e materialeve akademike dhe literaturës shkencore.</p>




	<p>Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se në funksion të moduleve, UAMD ka në dispozicion infrastrukturën dhe laboratorët kompjuterike ku stafi akademik, përdor mjete audio-vizive të mësimdhënies dhe studentët mund të mësojnë duke zgjidhur vetë raste e detyra praktike.</p> <p><i>Ev.19.Lista e marreveshjeve bilaterale per shkembime.</i>  <i>Ev.20.Lista e Mobiliteteve te Stafit _ Studenteve.</i>  <i>Ev.21.Dep Marketingut Analiza Vjetore 2019-2020.</i>  <i>Ev.42.Lista e mobiliteteve te studenteve dhe stafit akademik ne FB 2016 - 2022 dhe Mobility agreement.</i>  <i>Ev.65.Analiza Vjetore e Departamentit të Marketingut, 2021-2022.</i>  <i>Ev.66.Lista Aktiviteve Dep Marketingut v.a. 2020-2021.</i>  <i>Ev.69.Foto të auditorëve, bibliotekës, sallave të konferncave, laboratorëve.</i>  <i>Ev.90.Kapacitetet infrastrukurore të godinës Nr. 2 Kampus.</i>  <i>Ev.85.Përmbledhëse e kapaciteteve të UAMD-së.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Personeli akademik, i angazhuar në mësimdhënie në Programin e Studimit në Bachelor Menaxhim Marketing është i kualifikuar sipas profilit të lëndës që zhvillon. Kompetencat dhe kualifikimi i stafit akademik dhe stafit ndihmes akademik jepen në mënyrë të detajuar dhe në CV-të e tyre.(<i>Ev.74. CV-te e stafit te departamentit marketing</i>). Njësia bazë planifikon ngarkesën mësimore për të gjithë anëtarët e personelit akademik, mbështetur në normat e ngarkesës mësimore të përcaktuara nga udhëzimet e MASR, në shkallën e kualifikimit, të eksperiencës dhe fushën e kompetencës të çdo anëtari të personelit akademik, si dhe në numrin e grupeve mësimore për programet e studimit ku është i përfshirë.</p> <p>Nga shqyrtimi i CV-ve dhe dokumentacionit të personelit akademik, GVJ konstaton se fusha e ekspertizës së pedagogëve përputhet me syllabusin e lëndës në të cilën është titullar dhe mbështesin studentët përmes metodave interaktive të mësimdhënies të evidentuara dhe në Programet e Lëndëve përgjegjëse. Gjithashtu, stafi akademik është i angazhuar në këshillim për studentët dhe ndihmon e asiston ne detyra administrative.</p> <p><i>Ev.8.Lektorët me fusha specifike.</i>  <i>Ev.9.Të dhëna të detajuara të stafit të Departamentit Marketing.</i>  <i>Ev.29.Krijimi i grupeve mesimore kerkimore.</i>  <i>Ev.31.Syllabuset e Lëndëve BSc. MM.</i>  <i>Ev.65.Analiza Vjetore e Departamentit të Marketingut, 2021-2022.</i>  <i>Ev.74.CV-te e stafit te departamentit marketing.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e</p>	<p>Përfshirja e studentëve në procesin e përmirësimit të kurrikulës universitare dhe rritjes së cilësisë është pjesë e politikave dhe strategjisë se UAMD.(<i>Ev.2 Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu,</i></p>

<p>metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p><i>Durrës</i>). Studentët bëhen pjesë e përmirësimit të cilësisë përmes përfaqësimit të tyre në organet dhe strukturat përkatëse të UAMD-së, anketimit periodik, takimet e hapura dhe komunikimi me koordinatoren e programit të studimit. Departamenti i Marketingut vlerëson dhe adreson kërkesat dhe sugjerimet e studentëve për të rritur cilësinë e mësimdhënies.</p> <p>Me rëndësi të veçantë në këtë proces është dhe anketimi i realizuar nga Rektorati dhe NJSBC çdo fund semestri janë mënyra kryesore për tërheqjen e mendimit të studentëve. (Ev 50,57,106).</p> <p>Mendimet dhe sugjerimet reflektohen në vazhdimësi me qëllim përmirësimin e metodave të mësimdhënies. Gjithashtu, titullari i lëndës në përfundim të procesit mësimor, jep mendime në lidhje me zhvillimin e lëndës, si dhe propozojnë përmirësime në programin e lëndës.</p> <p><i>Ev.2.Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu.</i>  <i>Ev.15.Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.50.Formulari i vlerësimit të lektorëve nga studentët.</i>  <i>Ev.57.Tabela e vlerësimit të stafit akademik nga rektorati.</i>  <i>Ev.105.Raport vlerësimi për stafin akademik nga studentët.</i>  <i>Ev.106.Pyetesor për studentët Bsc MM mbi permisimin e metodikes se mesimdhënies.</i>  <i>Ev.110.Formular vetvleresimi.</i>  <i>Ev.115.Raporti-i-Vetevleresimit 2019-2020 NJSBC.</i>  <i>Ev.118.Analiza e rezultateve të anketimit për studentët, stafin akademik dhe administrative.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>UAMD është angazhuar në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies me ngritjen e strukturës përkatëse të Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, dhe Drejtorisë së Kurrikulës dhe Sigurimit të Cilësisë të cilat janë përgjegjëse për respektimin e standardeve të përgatitjes së planeve mësimore, syllabuseve të lëndëve si dhe të gjithë dokumentacionit të programeve të studimit, si dhe për përmirësimin e cilësisë së stafit akademik, përmirësimin e infrastrukturës laboratorike e të mësimdhënies dhe përsosjen e metodave të mësimdhënies, elementë të cilët i nënshtrohen një vlerësimi periodik nga njësitë bazë dhe studentët. NJSBC gëzon autonomi të plotë në veprimtarinë e saj dhe planifikon dhe organizon vlerësimin e brendshëm të cilësisë së programeve të studimit. Për këtë qëllim ajo bashkëpunon me autoritetet dhe strukturat përkatëse të institucionit për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p> <p>Gjithashtu, UAMD trajnon personelin akademik përmes Qendës së Edukimit në Vazhdim (<a href="https://uamd.edu.al/qendra-per-edukim-ne-vazhdim/">https://uamd.edu.al/qendra-per-edukim-ne-vazhdim/</a>). GVJ u informua në takimin me NJSBC se stafi akademik i cili vlerësohet më pak në anketimet e studentëve, zhvillon trajnime të vazhduara përmes qendrës sipas planifikimit të njësisë bazë.</p>




	<p>Ev.105.Raport vlerësimi për stafin akademik nga studentët.</p> <p>Ev.107.Relacion i NjBSC mbi realizimin e mesimdhënieve online dhe pyetesori.</p> <p>Ev.108.Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD.</p> <p>Ev.111.Urdheri i Rektorit për ngritjen e NjSBC.</p> <p>Ev.115.Raporti-i-Vetevlerësimit 2019-2020 NJSBC.</p> <p>Ev.118.Analiza e rezultateve të anketimit për studentët, stafin akademik dhe administrative.</p> <p>Ev.120.Takim informues i NJSBC me koordinatore të GVB.</p>			
<b>Konkluzione</b>	<p>Mësimdhënia/mësimnxënirregullohet në Statut, Rregulloren Institucionale dhe Rregulloren e Programit të Studimit. Pjesa më e madhe e moduleve të programit përmbajnë detyrime për përgatitjen e detyrave të kursit në grup, të cilat i aftësojnë studentët për përthithjen dhe zbatimin e informacionit teorik si dhe aftësinë e të punuarit në grup. Përfshirja e studentëve në procesin e përmirësimit të kurrikulës universitare dhe rritjes së cilësisë është pjesë e politikave dhe strategjisë së UAMD.</p> <p>UAMD është angazhuar në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënieve me ngritjen e strukturave përkatëse të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë, të cilat janë përgjegjëse për respektimin e standardeve të cilësisë.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri I.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>GVJ evidentoi se mënyra e kontrollit të dijeve në UAMD përcaktohet në Rregulloren Institucionale, Rregulloren e Fakultetit të Biznesit dhe në Rregulloren e Programit të Studimit.</p> <p>Njohuritë e përfutura nga studenti kontrollohen përmes një kombinimi të frekuentimit dhe aktivizimit të studentit gjatë orëve të mësimi, provimeve me shkrim, detyrave të kursit, që zhvillohen sipas afateve të caktuara në kalendarin akademik, të bëra publike nga Departamenti përkatës dhe që janë të detyrueshme për zbatim si nga pedagogët ashtu dhe nga studentët.</p> <p>GVJ konstaton se në syllabusin e secilës lëndë të këtij programi studimi përshkruhet një seksion i veçantë lidhur me formën e kontrollit dhe vlerësimit të njohurive. Raporti i vlerësimit të vazhduar gjatë vitit me</p>

	<p>raportin përfundimtar përcaktohet nga pedagogu i lëndës dhe miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit në fillim të çdo semestri.</p> <p><i>Ev.2.Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu.</i>  <i>Ev.4.Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i>  <i>Ev.15.Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.23.Kurrikula dhe Plani Mësimor BSc MM 2021-2024.</i>  <i>Ev.31.Syllabuset e Lëndëve BSc. MM.</i>  <i>Ev.37.Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Personeli akademik i programit Bachelor Menaxhim Marketing në fillim të çdo lënde/moduli informon studentët për metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore në përputhje me Rregulloren Institucionale, Rregullorene Fakultetit dhe atë të programit të studimit. Në programin e lëndës shprehen mënyrat e vlerësimit të saj, të cilat i bëhen të njohura studentit me fillimin e procesit mësimor nëpërmjet sqarimit nga ana e pedagogut të syllabusit përkatës, i cili përmban metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive dhe aftësive.</p> <p><i>Ev.2.Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu.</i>  <i>Ev.4.Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i>  <i>Ev.15.Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.23.Kurrikula dhe Plani Mësimor BSc MM 2021-2024.</i>  <i>Ev.31.Syllabuset e Lëndëve BSc. MM.</i>  <i>Ev.37.Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Instrumente në kontrollin e vazhdueshëm, përpara provimit përfundimtar përfshinë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Raste studimore;</li> <li>• Punë në grupe;</li> <li>• Detyra Kursi;</li> <li>• Projekte Kërkimore;</li> <li>• Provime të ndërmjetme (testimeve gjatë semestrit).</li> </ul> <p>Kontrolli përfundimtar i dijeve së një lënde (provimi përfundimtar) bëhet me shkrim duke u mbështetur në programin mësimor.</p> <p>Pedagogu i lëndës i komunikon studentit, në orën e fundit të mësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të drejtën e paraqitjes ose jo në provim;</li> <li>• nivelin e pikëve të fituara në format e tjera të kontrollit të vazhdueshëm;</li> <li>• kriteret e vlerësimit përfundimtar.</li> </ul>
	<p>Rregulla dhe specifika të provimeve, përqindja e secilit provim apo detyre në vlerësimin përfundimtar, detyrat e kursit, projektet</p>




	<p>individuale, apo forma të tjera të vlerësimeve gjatë vitit, përcaktohen në syllabus-in e lëndës të hartuar nga pedagogu dhe u bëhet i ditur studentëve në fillim të procesit mësimor.</p> <p><i>Ev.2.Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu.</i>  <i>Ev.4.Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i>  <i>Ev.15.Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.23.Kurrikula dhe Plani Mësimor BSc MM 2021-2024.</i>  <i>Ev.31.Syllabuset e Lëndëve BSc. MM.</i>  <i>Ev.37.Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>GVJ konstaton se përfshirja e studentëve në procesin e përmirësimit të kurrikulës universitare dhe rritjes së cilësisë është pjesë e politikave dhe strategjisë së UAMD e evidentuar në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit. Sudentët bëhen pjesë e përmirësimit të cilësisë përmes përfaqësimit të tyre në organet dhe strukturat përkatëse të UAMD-së, anketimit periodik, takimet e hapura dhe komunikimi me koordinatoren e programit të studimit. Departamenti i Marketingut vlerëson dhe adreson kërkesat dhe sugjerimet e studentëve për të rritur cilësinë e mësimdhënies. Gjithashtu, anketimi i realizuar nga NJSBC çdo fund semestri është mënyra kryesore për tërheqjen e mendimit të studentëve. Mendimet dhe sugjerimet reflektohen në vazhdimësi me qëllim përmirësimin e metodave të mësimdhënies. Për më tepër titullari i lëndës në përfundim të procesit mësimor, jep mendime në lidhje me zhvillimin e lëndës, si dhe përmirësime në programin e lëndës.</p> <p><i>Ev.4.Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i>  <i>Ev.15.Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.23.Kurrikula dhe Plani Mësimor BSc MM 2021-2024.</i>  <i>Ev.31.Syllabuset e Lëndëve BSc. MM.</i>  <i>Ev.37.Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.</i>  <i>Ev.59. Pyetsor per metodat e mesimdhënies nga Lektori.</i>  <i>Ev.107.Relacion i NjBSC mbi realizimin e mesimdhënies online dhe pyetesori.</i>  <i>Ev.118.Analiza e rezultateve të anketimit për studentët, stafin akademik dhe administrative.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshiatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të</p>	<p>Nga takimi i zhvilluar me personelin akademik të programit të studimit, GVJ u informua se stafi nxiti studentët të ndërmarrin iniciativa të lira dhe të pavarura në ngritjen e grupeve të punës, zgjedhjen e temave, përgatitjen e detyrave të kursit në të cilat vlerësohen dhe mbi bazën e iniciativës dhe krijimtarisë së tyre, bashkëpunim në zgjidhjen e problemave në seminare. Bashkëpunimi i ndësjellitë pedagog-studentë u evidentua nga takimi me studentët gjatë vizitës në institucion ku u theksua se studentët kanë mbështetje në detyrat e ndryshme të kursit, në</p>




<p>studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>projekte e hartimin e diplomës dhe komunikimi i ndërsjellë lehtësohet përmes sistemit të komunikimit.</p> <p><i>Ev.4.Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i>  <i>Ev.23.Kurrikula dhe Plani Mësimor BSc MM 2021-2024.</i>  <i>Ev.31.Syllabuset e Lëndëve BSc. MM.</i>  <i>Ev.37.Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.</i>  <i>Ev.60.Foto-Kendi i studentit.</i>  <i>Ev.137.Foto e afishimit të emrit të lektorit, orës dhe ditës së konsultimit model.</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Kontrolli dhe vlerësimi i dijeve në UAMD është përcaktuar në Rregulloren Institucionale dhe në Rregulloren e Programit të Studimit. Njohuritë e përftuara nga studenti kontrollohen përmes një kombinimi të frekuentimit dhe aktivizimit të studentit gjatë orëve të mësimit në auditor, provimeve me shkrim, detyrave të kursit, që zhvillohen sipas afateve të caktuara në kalendarin akademik. Në syllabusin e secilës lëndë të këtij programi studimi përshkruhet një seksion i veçantë lidhur me formën e kontrollit dhe vlerësimit të njohurive.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht <b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.3</b>  <b>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri I.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar. të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Kontrolli i dijeve në një lëndë në nivelin bachelor në UAMD bëhet në mënyrë të vazhdueshme, përgjatë zhvillimit të lëndës. Format kryesore të kontrollit të vazhduar janë: detyrat e kursit, provimet e ndërmjetme dhe provimi përfundimtar. GVJ nga shqyrtimi i Syllabusave konstaton se në asnjë rast nuk kemi një rezultat përfundimtar të kontrollit të dijeve bazuar vetëm në rezultatin e provimit përfundimtar.</p> <p>Bazuar në Rregulloren e Fakultetit të Biznesit dhe Rregulloren e Programit të studimit vlerësimi organizohet në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Detyra Kursi- 10%;</li> <li>• Provim i Ndërmjetëm -40%;</li> <li>• Provim Përfundimtar- 50%.</li> </ul> <p>Studenti ka të drejtën e hyrjes në provim kur plotëson kushtet e përcaktuara në rregulloret e studimeve sipas procedurës për vlerësimin e dijeve, dhe i nënshtrohet provimit përfundimtar.</p> <p><i>Ev.4.Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i>  <i>Ev.15.Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i></p>



	<p><i>Ev.23.Kurrikula dhe Plani Mësimor BSc MM 2021-2024.</i></p> <p><i>Ev.31.Syllabuset e Lëndëve BSc. MM.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>UAMD ka në përdorim Sistemin ESSE, dhe sistemin AULA për administrim, dokumentim, ndjekje, raportim dhe shpërndarje të evidencave nga pedagogët, sekretaria mësimore për studentët.</p> <p>Vendosja e rezultateve në sistemin elektronik ESSE lejon secilin student të shikojë vetëm vlerësimin e tij dhe askush tjetër nuk ka akses për të parë vlerësimet e tjetrit.</p> <p>UAMD ka në përdorim dhe sistemin elektronik të vlerësimit Clean Score i mundur nga AADF dhe garanton shpejtësi, transparencë, objektivitet dhe informim të menjëhershëm të vlerësimit të studentëve.</p> <p><i>Ev.61.Marrëveshja Clean – Score.</i></p> <p><i>Ev.62.Clean Score Trajnim.</i></p> <p><i>Ev.63.Sistemi PITAGORA (RASH).</i></p> <p><i>Ev.64.Manual_Aula.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Proçesi i vlerësimit të dijeve dhe njohurive të fituara nga studentët në programin e studimit Bachelor në Menaxhim Marketing bëhet në përputhje me përcaktimet në Rregulloren e UAMD, Rregulloren e Fakultetit të Biznesit dhe Rregulloren e Programit të studimit. Në syllabuset e lëndëve shprehen modalitetet e vlerësimit dhe detyrimet e studentit, të cilat i bëhen të njohura studentëve me fillimin e procesit mësimor. Vlerësimi përfundimtar i studentëve bëhet brenda shtatë ditëve nga data e dhënies së provimit. Pas këtij afati pedagogu hedh notën në system dhe dorëzon procesverbalet në sekretarinë mësimore.</p> <p><i>Ev.4.Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i></p> <p><i>Ev.15.Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i></p> <p><i>Ev.37.Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.</i></p> <p><i>Ev.100.Rregullore Sekretarise mesimore.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Gjatë vlerësimit të të gjithë elementëve të një moduli si provim i ndërmjetëm, detyra e kursit, dhe provimi përfundimtar, stafi akademik bën komente me shkrim gjatë korrigjimit në tezën e provimeve ose komente direkte në rastin detyrave/projekteve të kursit, të cilat ndihmojnë studentin në përmirësimin e njohurive si dhe sqarimin e paqartësive që mund të lindin gjatë këtij proçesi. Lektori i bën me dije studentit për rezultatin e vlerësimit përpara plotësimit të dokumentacionit përkatës. Studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi nga ana e tij ose të paraqesë pretendimet e tij për rezultatin e marrë. Në kontakt me pedagogët, studentët njihen me vërejtjet e pedagogëve gjatë korrigjimit si edhe me zgjidhjene saktë.</p> <p>Gjatë takimit me studentët, GVJ konstatoi se ndjekja individuale i ndihmon studentët të përmirësohen në aspekte të mësimnxënies. Gjithashtu në Rregulloren e UAMD, Rregulloren e Fakultetit të Biznesit</p>

	<p>dhe Rregulloren e Programit të studimit parashikohet ballafaqimi ivlerësimit të provimeve me studentët.</p> <p><i>Ev.4.Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i>  <i>Ev.15.Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.37.Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.</i>  <i>Ev.100.Rregullore Sekretarise mesimore.</i>  <i>Ev.31.Syllabuset e Lëndëve BSc. MM.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Në Rregulloren e UAMD dhe Rregulloren e provimeve të Fakultetit të Biznesit janë të specifikuara qartë veprimet e ndaluara gjatë zhvillimit të provimit, përfshirë edhe kopjimin në provim dhe penalitetet për rastet e konstatimit të kopjimit ose plagjiaturës. Në provim nuk lejohet mbajtja dhe përdorimi i telefonave celularë apo mjeteve të dyshimta elektronike. Studenti që në provim përdor forma e mjete të palejueshme, përjashtohet nga provimi. Komisioni i provimit vë në dijeni drejtuesin e njësisë bazë dhe njësisë kryesore, për të proceduar më tej në përputhje me Kodin e Etikës.</p> <p><i>Lidhur me plagjiaturën në detyra kursi, apo tema diplome, ajo nuk mund të evidentohet pasi në institucion mungon një program specifik për këtë qëllim.</i></p> <p><i>Ev.4.Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i>  <i>Ev.15.Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.37.Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.</i>  <i>Ev.38. Rregullore provimesh FB.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Proçesi i vlerësimit të dijeve të fituara nga studentët bëhet në përputhje me përcaktimet në Rregulloren e Fakultetit të Biznesit dhe Rregulloren e Programit të studimit.</p> <p>Gjithashtu, në programet e lëndëve shprehen modalitetet e vlerësimit dhe detyrimet e studentit, të cilat i bëhen të njohura studentëve me fillimin e procesit mësimor. Gjatë procesit të kontrollit stafi shënon pikët për çdo pyetje si dhe tregohet i kujdesshëm në ndarjen e pikëve të tezës. Tezat hartohen në mënyrë që të përfshijnë të gjithë informacionet e marra gjatë zhvillimit të lëndës.</p> <p>Përmes sistemit online ESSE studenti informohet brenda afateve të përcaktuara për rezultatet e provimit. Bazuar në rregulloren e Fakultetit të Biznesit tezat e korigjuara dorëzohen brenda një jave nga data e zhvillimit të provimit, ndërsa seancat sqaruese dhe rishikuese bëhen brenda dy javëve nga data e zhvillimit të provimit.</p> <p>Gjithashtu nga takimi i GVJ me studentët u konfirmua se vlerësimi është transparent dhe nuk ka pasur raste të shkeljes së meritës.</p> <p><i>Ev.4.Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i></p>




	<p><i>Ev.15.Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.37.Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.</i>  <i>Ev.38.Rregullore provimesh FB.</i></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>GVJ konstatoi se UAMD ka dokumentacion të plotë që siguron garantimin e të drejtave të studentëve për tu njohur me vlerësimin, dhe kërkuar rishikim të vlerësimit bazuar në rregulloren dhe procedurat përkatëse.<i>(Ev 15, 4, 38).</i></p> <p>Studenti ka të drejtë të ankimojë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit (provim i ndërmjetëm, detyrë kursi, provim përfundimtar), pasi ka zhvilluar procedurën e rishikimit me pedagogun e lëndës. Ai mund t'i drejtojë një kërkesë me shkrim përgjegjësit të Departamentit dhe Dekanit ku të parashtrijë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Me marrjen e ankesës, Dekanati në bashkëpunim me Përgjegjësin e Departamentit ngre një komision i cili bën shqyrtimin e kërkesës dhe merr vendim me shumicë të thjeshtë. Vlerësimi i komisionit mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi i kontestuar.</p> <p>Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës si dhe vendimi i marrë dokumentohet dhe arkivohet. Vlerësimi përfundimtar pasqyrohet në një procesverbal të ri të firmosur nga komisioni i cili i bashkëlidhet atij të mëparshmit si dhe pasqyrohet në sistemin elektronik.</p> <p><i>Ev.4.Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i>  <i>Ev.15. Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.37.Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.</i>  <i>Ev.38.Rregullore provimesh FB.</i>  <i>Ev.100.Rregullore Sekretarise mesimore.</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konstatoi se institucioni ka dokumentacion të plotë që siguron garantimin e të drejtave të studentëve për tu njohur me vlerësimin, dhe kërkuar rishikim të vlerësimit. Proçesi i vlerësimit të dijeve dhe njohurive të fituara nga studentët në programin e studimit Bachelor në Menaxhim Marketing bëhet në përputhje me përcaktimet në Rregulloren Fakultetit të Biznesit dhe Rregulloren e Programit të studimit. Në programet e lëndëve shprehen modalitetet e vlerësimit dhe detyrimet e studentit, të cilat i bëhen të njohura studentëve me fillimin e proçesit mësimor.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### Standardi III.4

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-13123

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

35

<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Marketing ofron njohuri në një spektër të gjerë fushash dhe disiplinash të lidhura me marketingun, botën e biznesit dhe funksionet që zhvillohen brenda tij. Programi është ndërtuar në përputhje me VKM 41/2018, e ndryshuar dhe përmban:</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Lëndë bazë (20%);</li> <li>• Lëndë karakterizuese (51.1%);</li> <li>• Lëndë plotësuese (13.3%);</li> <li>• Lëndë ndërdisiplinore (12.3%). dhe</li> <li>• Detyrime përmbyllëse (3.3%).</li> </ul> <p>Në vitin e parë zhvillohen 14 lëndë në total, nga të cilat 6 lëndë janë të formimit të përgjithshëm, 4 lëndë karakterizuese për programin e studimit, 2 lëndë integruese dhe 2 lëndë plotësuese.</p> <p>GVJ vlerëson që kjo tipologji krijon mundësi për një formim të përgjithshëm të studentit. <i>GVJ sugjeron rishikimin e lëndës Rajonizimit Ekonomik në vitin e parë dhe rekomandon një argumentim për përfshirjen e lëndës.</i></p> <p>Në vitin e dytë, zhvillohen 13 lëndë, nga të cilat, 3 lëndë të formimit të përgjithshëm, 5 lëndë karakterizuese, 3 lëndë integruese dhe 2 lëndë plotësuese. Në këtë të fundit njëra nga lëndët lidhet me shkencat politike. <i>GVJ rekomandon përfshirjen në vend të saj të lëndës si psikologjia e cila nga pikëpamja e përmbajtjes ka më shumë rëndësi në menaxhimin e proceseve të marketingut duke qënë se ndihmon në kuptimin e sjelljes së konsumatorit.</i></p> <p>Ndërsa në vitin e tretë zhvillohen 9 lëndë karakterizuese, 1 lëndë integruese, 1 lëndë plotësuese dhe detyrimet përmbyllëse. Lënda Drejtim i Burimeve Njerëzore është paraqitur si lëndë karakterizuese (B) ndërsa lëndët si E-marketing dhe Menaxhim Shitje si lëndë C. Duke pasur parasysh përmbajtjen e tyre dhe qëllimin e programit të studimit, <i>GVJ rekomandon rishikimin e klasifikimit të këtyre lëndëve, Drejtim Burimesh njerëzore në kategorinë C dhe E-Marketing dhe Menaxhim Shitje në kategorinë B.</i></p> <p><i>Ev.4.Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i>  <i>Ev.23.Kurrikula dhe Plani Mësimor BSc MM 2021-2024.</i>  <i>Ev.45.Përshkrimi BSc MM kurikula 2021-2024.</i>  <i>Ev.46.Plani Mesimor Bsc. MM 2021-2024.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët</p>	<p>Në fillim të çdo lënde studentët informohen nga titullari i lëndës mbi programin e lëndës, objektivat, kompetencat dhe aftësitë që pritet të fitojë studenti gjatë zhvillimit të lëndës. Në fund të modulit gjithashtu këto elementë shqyrtohen dhe analizohen përsëri për të vënë në dukje arritjet e studentëve.</p>




<p>për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Në javën e fundit të semestrit pedagogët realizojnë seanca konsultuese ku orientojnë studentët në lidhje me çështjet ku do të përqëndrohet përgatitja e studentëve për provimin përfundimtar. Gjatë seancës trajtohen konceptet kryesore, struktura e përgjithshme e tezës dhe udhëzime të tjera lidhur me natyrën e pyetjeve që do të përfshihen në provimin përfundimtar.</p> <p>UAMD tregon vemendje lidhur me bashkëveprimin me studentët, si një proces periodik në të gjitha lëndët. Nga takimi me studentët, GVJ kuptoi se ata ndihen të lirë dhe të motivuar për të pyetur për çdo paqartësi lidhur me orët e leksionit/seminarit.</p> <p><i>Ev.4.Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i>  <i>Ev.15.Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.23.Kurrikula dhe Plani Mësimor BSc MM 2021-2024.</i>  <i>Ev.38.Rregullore provimesh FB.</i>  <i>Ev.31.Syllabuset e Lëndëve BSc. MM.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparura kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Nga takimi i GVJ me studentët dhe stafin akademik u konstatua se në çdo lëndë u jepet mundësi studentëve të zhvillojnë njohuritë e marra në projektet dhe rastet studimore. Përmes tyre studentëve u krijohet mundësi të zhvillojnë të menduarin kritik dhe analizën në funksion të nevojave të tregu të punës. Detyrat e kursit u japin mundësinë studentëve të analizojnë një rast real me të dhëna të ofruara nga pedagogu apo dhe të dhëna të cilat mund të sigurohen nga vetë studentët, sipas udhëzimeve të pedagogut.</p> <p>Në programet e lëndëve dhe në rregulloren mësimore të programit të studimit, paraqiten format kryesore të punës mësimoretoreike e praktike, ku përfshihen leksionet, seminarët, ushtrimet, konsultimet, praktikat profesionale, detyrat e kursit, projekt – diplomat, etj.;</p> <p>Gjithashtu aktivitetet e organizuara nga Departamenti marketing si workshope e konferenca përforcojnë zhvillimin e kërkimeve dhe ideve novatore në funksion të programit të studimit Bachelor në Menaxhim Marketing.</p> <p><i>Ev.4.Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i>  <i>Ev.15.Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.31.Syllabuset e Lëndëve BSc. MM.</i>  <i>Ev.21.Dep Marketingut Analiza Vjetore 2019-2020.</i>  <i>Ev.23.Kurrikula dhe Plani Mësimor BSc MM 2021-2024.</i>  <i>Ev.65.Analiza Vjetore e Departamentit të Marketingut, 2021-2022.</i>  <i>Ev.66.Lista Aktiviteteve Dep Marketingut v.a. 2020-2021.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Nga takimet në institucion, GVJ u njoh me aktivitetet e mbajtura si trajnime, konferenca, leksione me të ftuar të industrisë dhe tryeza të rrumbullakëta. Përshkrimi i këtyre aktiviteteve është evidentuar në <i>Ev.66. Lista Aktiviteteve Dep Marketingut v.a. 2020-2021</i> dhe <i>Ev.65. Analiza Vjetore e Departamentit të Marketingut, 2021-2022.</i></p>

	GVJ inkurajon bashkëpunimet e UAMD me Universitete e Institucione kombëtare dhe ndërkombëtare për shkëmbime dhe adoptimin e zhvillimeve të reja të shkencës në funksion të ndërkombëtarizimit të programit të studimit.			
	<p><i>Ev.31.Syllabuset e Lëndëve BSc. MM.</i></p> <p><i>Ev.21.Dep Marketingut Analiza Vjetore 2019-2020.</i></p> <p><i>Ev.23.Kurrikula dhe Plani Mësimor BSc MM 2021-2024.</i></p> <p><i>Ev.65.Analiza Vjetore e Departamentit të Marketingut, 2021-2022.</i></p> <p><i>Ev.66.Lista Aktiviteteve Dep Marketingut v.a. 2020-2021.</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	GVJ vlerëson se Programi i Studimit Bachelor "Manaxhim Marketing" ofron njohuri në një spektër të gjerë fushash dhe disiplinash të lidhura me marketingun dhe biznesin. Nga shqyrtimi i Planit mësimor dhe Programeve të Lëndëve, GVJ rekomandon përditësime në kategorizimin e lëndëve që e përbëjnë këtë program studimi.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	<p>UAMD ka rregullore dhe procedura të miratuara për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. (Ev.67).</p> <p>Diploma zhvillohet në përputhje me kriteret dhe standardete përcaktuara nga njësia të cilat bëhen publike përmes Rregullores së Brendshme të FB, Rregullores e programit të studimit, rregullores së diplomimit.</p> <p>Bazuar në rregulloren e Fakultetit të Biznesit, dhe rregulloren e Diplomimit, studentët e ciklit të parë të cilët kanë një mesatare mbi notën 7 zhvillojnë një punim diplome si detyrim përmbyllës, ndërsa studentët me mesatare nën notën 7 zhvillojnë provimin e përgjithshëm përfundimtar si detyrim përmbyllës. Departamenti Marketing përcakton kriteret dhe asiston studentët në zhvillimin e provimit përmbyllës ose punimit të diplomës.</p> <p><i>Ev.4.Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i></p> <p><i>Ev.15.Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i></p> <p><i>Ev.37.Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.</i></p> <p><i>Ev.38.Rregullore provimesh FB.</i></p> <p><i>Ev.67.Rregullore Diplomimi.</i></p>

	<p><i>Ev.70.Proçes-verbal i mbrojtjes së temës së diplomës Bachelor“Manaxhim Marketing.</i></p> <p><i>Ev.100.Rregullore Sekretarise mesimore.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Gjatë takimeve me përgjegjësin e departamentit dhe stafin, GVJ u informua se departamenti vë në dispozicion një grup pune të përbërë nga personeli i tij akademik me funksion koordinimin dhe mbështetjen e studentëve për procesin e diplomimit.</p> <p>Studentëve ju mundësohenanca metodologjike sipas një kalendari takimesh të përcaktuar nga pedagogët udhëheqës si dhe ju vihet në dispozicion udhëzuesi për përgatitjen e Mikrotezës.</p> <p>Personeli akademik orienton studentët në zgjedhjen e temës sipas fushave të kërkimit që mbulon programi i studimit Bachelor në Menaxhim Marketing.</p> <p><i>Ev.4.Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i></p> <p><i>Ev.38.Rregullore provimesh FB.</i></p> <p><i>Ev.67.Rregullore Diplomimi.</i></p> <p><i>Ev.70.Proçes-verbal i mbrojtjes së temës së diplomës Bachelor“Manaxhim Marketing.</i></p> <p><i>Ev.100.Rregullore Sekretarise mesimore.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e Fakultetit të Biznesit, dhe rregulloren e Diplomimit, detyrimi përmbyllës i programit të studimit bëhet me punim diplome për studentët me mesatare mbi notën 7 dhe me provim të përgjithshëm për studentët me mesatare nën notën 7.</p> <p>Grupi i punës i përbërë nga koordinatori i programit dhe pedagogët udhëheqës për procesin e diplomimit orientojnë studentët në përcaktimin e temave të diplomave. Studentëve u vihet në dispozicion një listë me tema të sugjeruara të punimit të diplomës, të përgatitura nga stafi akademik në përputhje me fushat kërkimore të programit të studimit në Bachelor Menaxhim Marketing.</p> <p>Procedurat e mbrojtjes së diplomës përfshin një paraqitje të përmbledhjes së punimit të diplomës, dhe në vletësimin e saj merren në konsideratë njohuritë dhe arritjet akademike të studentit gjatë ciklit të studimeve, vlerësimi nga udhëheqësi i mikrotezës, dhe vlerësimi i jurisë.</p> <p><i>Ev.4.Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i></p> <p><i>Ev.38.Rregullore provimesh FB.</i></p> <p><i>Ev.67.Rregullore Diplomimi.</i></p> <p><i>Ev.70.Proçes-verbal i mbrojtjes së temës së diplomës Bachelor“Manaxhim Marketing.</i></p>




<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>GVJ u njoh me procedurën e diplomimit të studentëve nga takimi në institucion dhe Rregullorja e Diplomimit. Studenti propozon pedagogun udhëheqës pasi ka marrë paraprakisht dhe aprovimin e këtij të fundit. Departamenti shqyrton propozimet e studentëve dhe garanton që udhëheqësi të jetë në përputhje me fushën e kërkimit të studentit. Përgjegjësi i departamentit miraton listën e temave dhe udhëheqësve shkencor. Gjatë seancave orientuese studentët asistohen nga pedagogu udhëheqës për përcaktimin e temave të diplomës dhe përmbajtjen e saj. Studenti nuk mund të mbrojë temën e diplomës pa marrë miratimin e udhëheqësit si garantues i cilësisë së saj akademike.</p> <p><i>Ev.4.Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i>  <i>Ev.38.Rregullore provimesh FB.</i>  <i>Ev.67.Rregullore Diplomimi.</i>  <i>Ev.70.Proçes-verbal i mbrojtjes së temës së diplomës Bachelor "Manaxhim Marketing.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion, GVJ u informua se UAMD vë në dispozicion të studentëve 2 laboratorë dhe pajisjet që ata disponojnë për kryerjen e mbledhjes së të dhënave, analizave, si dhe asistencë në përgatitjen e prezantimit të punimeve. GVJ gjykon se UAMD ka kapacitetet e duhura për zhvillimin e diplomës. Para mbrojtjes së punimit të diplomës, udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer dhe lejon mbrojtjen e tij duke e firmosur atë. Studenti dorëzon kopjen e firmosur të punimit të diplomës në Departament.</p> <p><i>Ev.67.Rregullore Diplomimi.</i>  <i>Ev.85.Përmbledhëse e kapaciteteve të UAMD-së.</i>  <i>Ev.86.Ambiente të Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.87.Foto të laboratorëve.</i>  <i>Ev.88.Bibloteka online.</i>  <i>Ev.90.Kapacitetet infrastrukturore të godinës Nr. 2 Kampus.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë.</p>	<p>Sipas Rregullores së Diplomës dhe Rregullores së Programit të Studimit, mbrojtja e diplomës bëhet me gojë dhe studentit vlerësohet me notë sipas komisionit të vlerësimit për mbrojtjen e diplomave. Komisioni bën vlerësimin unanimor të bazuar dhe në vlerësimin e udhëheqësit. Mesatarja e vlerësimeve të anëtarëve të komisionit të provimit konvertohet në notë.</p> <p>Në përfundim të mbrojtjes së punimeve të diplomave, kryetari i komisionit, në prani të anëtarëve, i komunikon çdo studentit notën me të cilën është vlerësuar punimi i tij. Në rast se studentit vlerësohet me notë negative në mbrojtjen që i bën punimit të tij, ai mund të ri-mbrojë të njëjtin punim ose të mbrojë një punim të ri, në një afat kohor i cili</p>






	<p>përcaktohet në rregulloren e programit të studimit, pa tejkaluar afatin maksimal të përcaktuar në kornizën ligjore në fuqi.</p> <p><i>Ev.4.Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i>  <i>Ev.15.Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.67.Rregullore Diplomimi.</i>  <i>Ev.70.Proçes-verbal i mbrojtjes së temës së diplomës Bachelor“Manaxhim Marketing.</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Sipas Rregullores së UAMD, studenti nuk mund të mbrojë punimin e diplomës pa përmbushur të gjitha detyrimet e tjera të programit.</p> <p>Diplomat për ciklin e parë të studimeve shoqërohen me suplementin e diplomës i cili hartohet në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Studenti ka të drejtë të marrë një kopje zyrtare të syllabuseve të programit të studimit të zhvilluar.</p> <p><i>Ev.4.Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i>  <i>Ev.15.Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.37.Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.</i>  <i>Ev.67.Rregullore Diplomimi.</i>  <i>Ev.71.Diplomë dhe Suplement i Diplomës.</i>  <i>Ev.100.Rregullore Sekretarise mesimore.</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se dokumentacioni i studentit ruhet në sekretarinë mësimore. GVJ vizitoi nga afër arkivin e sekretarisë mësimore ku verifikoi dosje të studentit, regjistrin themeltar, regjistrin e arritjeve akademike dhe vlerësoi angazhimin e institucionit në këtë drejtim.</p> <p>Pas përfundimit të studimeve nga studenti, kopje e dokumentacionit të tij të regjistrimit arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat. Në përmbushje të detyrimeve institucionale, informacioni mbi studentët paraqitet rast pas rasti dhe jepet për palët e interesuara apo institucionet përkatëse në përputhje me parashikime ligjore dhe përcaktimet në aktet e brendshme rregullatore.</p> <p><i>Ev.4.Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i>  <i>Ev.15.Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.37.Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.</i>  <i>Ev.67.Rregullore Diplomimi.</i>  <i>Ev.100.Rregullore Sekretarise mesimore.</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se UAMD ka rregullore dhe procedura të miratuara për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e zhvillimit dhe mbrojtjes së diplomës.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1																																																						
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.																																																						
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																					
<b>Kriteri I.</b> Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	GVJ konstaton se, nga shyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, referuar listës së stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi ( <i>tabelat shtesë të marra gjatë vizitës në institucion</i> ), personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi, në tre vitet e fundit akademike paraqitet si në vijim:																																																					
	<table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Tituj/grada</th> <th colspan="2">2020 - 2021</th> <th colspan="2">2021 - 2022</th> <th colspan="2">2022 - 2023</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE:</th> <th>PAK:</th> <th>PAE:</th> <th>PAK:</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>2</td> <td>-</td> <td>2</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof.As.Dr</td> <td>6</td> <td>-</td> <td>6</td> <td>-</td> <td>8</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>18</td> <td>2</td> <td>16</td> <td>1</td> <td>16</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>6</td> <td>3</td> <td>5</td> <td>3</td> <td>5</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>Në total</td> <td>30</td> <td>5</td> <td>29</td> <td>4</td> <td>31</td> <td>3</td> </tr> </tbody> </table>							Tituj/grada	2020 - 2021		2021 - 2022		2022 - 2023		PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:	Prof.Dr	-	-	2	-	2	-	Prof.As.Dr	6	-	6	-	8	-	Dr/PhD	18	2	16	1	16	-	Msc	6	3	5	3	5	3	Në total	30	5	29	4	31
Tituj/grada	2020 - 2021		2021 - 2022		2022 - 2023																																																	
	PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:																																																
Prof.Dr	-	-	2	-	2	-																																																
Prof.As.Dr	6	-	6	-	8	-																																																
Dr/PhD	18	2	16	1	16	-																																																
Msc	6	3	5	3	5	3																																																
Në total	30	5	29	4	31	3																																																
	Bazuar në Nenin 59 i Ligjit 80/2015 për kategoritë e personelit akademik ku përcaktohet që titullarët e lëndëve dhe moduleve i përkasin kategorisë profesor (Prof.Dr dhe Prof.Asoc), <i>GVJ vlerëson që një pjesë e konsiderueshme e titullarëve nuk i përkasin kategorive të sipërpërmendura</i> . Si vijon përmendim disa prej tyre: Baza Biznesi - Titullari: Doktor; Matematika - Titullari: Master i Shkencave; Baza Kontabiliteti - Titullari: Doktor; Kërkim në Marketing - Titullari: Doktor; Bazat e Menaxhimit - Titullari: Doktor; Shkrim Akademik -																																																					

Titullari: Doktor; Informatikë - Titullari: Master i Shkencave; Menaxhimi i Markës - Titullari: Doktor etj.

Po kështu nga analiza e ngarkesës së stafit të angazhuar në këtë program studimi *Ev.65- Ngarkesa faktike mësimore për lektorët me kohë të plotë në Departamentin Marketing për vitin akademik 2021-2022, vihet re tejkallim i normës nga të gjithë pedagogët.* Është thelbësore që çdo tejkallim i normës të trajtohet me seriozitet për të siguruar cilësinë e arsimit (mësimdhënie/kërkim) dhe mirëqenien e stafit mësimor.

Nga vlerësimi i CV-ve të stafit të angazhuar në këtë program studimi vihet re cilësia e stafit akademik në tregues si:

1. Pjesëmarrja në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare;
2. Pjesëmarrja në projekte ndërkombëtare Stars Eu (<https://uamd.edu.al/projektet-aktuale/>);
3. Pjesëmarrja në mobilitete kërkimore;
4. Pjesëmarrja në mobilitete teaching në, Spanjë, Portugali Gjermani, Angli, Poloni, Letoni, Lituani, Rumani, Bullgari, Greqi, etj;
5. Pjesëmarrja në trajnime të ndryshme që lidhen me tematikat që mbulojnë në këtë program studimi për organizata të ndryshme në zonën e Durrësit por edhe me gjerë;
6. Pjesëmarrja në projekte Erasmus Capacity Building (ju mundëson përmirësim të vazhdueshëm të metodologjive mësimdhënëse (<https://uamd.edu.al/marredheniet-me-jashtedhe-projektet/>);
7. Prania e pjesës më të madhe të stafit të angazhuar në outlete si google scholar, research gate dhe scopus, si dhe publikime me faktor impakti me citime të konsiderueshme (psh Përgjegjësi i Departamentit);
8. Eksperienca jashtë auditorit në organizatat e biznesit mundëson përçim të elementëve praktikë te studentët.

*GVJ vlerëson që në analizën e Departamentit të Marketingut theksohet rëndësia e hartimit, zhvillimit dhe aplikimit të politikave të Marketingut të Territorit në Rajonin e Durrësit. Si fokusi i këtyre politikave qëndron zhvillimi i Markës së Turizmit dhe politikave të shërbimit cilësor në funksion të rritjes së numrit të turistëve dhe besnikërisë së tyre në Rajonin e Durrësit. Sa i përket veprimtarisë botuese të anëtarëve të Departamentit të Marketingut, ky i fundit ka synuar arritjen e dy objektivave kryesore: së pari, artikuj cilësorë që synojnë të kenë impakt në ekonominë e rajonit të Durrësit dhe së dyti, botimet në revista prestigjioze, që ti shërbejë promovimit të kapaciteteve akademike të departamentit por edhe prezantimit së njësisë bazë drejt një rrjeti akademik më elitare.*

	<p>GVJ vlerëson që të gjithë këto tregues influencojnë pozitivisht në cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në njësinë bazë dhe kryesore përgjegjëse për programin e studimit BA në "Menaxhim Marketing".</p> <p>Ev.74.CV-te e stafit te departamentit marketing. Ev.20.Lista e Mobiliteteve te Stafit _ Studenteve. Ev.21.Dep Marketingut Analiza Vjetore 2019-2020. Ev.19.Lista e marreveshjeve bilaterale per shkembime. Tabelat përmbledhëse bachelor (tabela 19, të dhëna për kërkimin shkencor të stafit të angazhuar në programin e studimit; tabelat shtesë të marra gjatë vizitës në institucion).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Kështu bazuar në tabelat përmbledhëse lidhur me orët te paraqitur nga IAL vlerësohet që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Për vitin akaemik 2020-2021: 87.5% mbulohet nga stafi PAE dhe 12.5% nga stafi PAK;</li> <li>• Për vitin akademik 2021-2022: 89.7% mbulohet nga stafi PAE dhe 10.3% nga stafi PAK;</li> <li>• Për vitin akademik 2022-2023: 92.3% mbulohet nga stafi PAE dhe 7.7% nga stafi PAK.</li> </ul> <p>Ev. tabelat shtesë të marra gjatë vizitës në institucion. Ev.23. Kurrikula dhe Plani Mësimor BSc MM 2021-2024.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Institucioni ka angazhuar staf akademik PAE dhe PAK për të plotësuar kërkesat e programit, të cilët kanë përgatitjen profesionale në fusha të ndryshme dhe të angazhuar në mësimdhënie të lëndëve që përputhen me fushat e tyre të kërkimit shkencor. Nga analiza e CV-ve të stafit, tabelave të ngarkesës si dhe mosha e personelit të angazhuar, GVJ vlerëson që ky kriter plotësohet. Nga takimi me stafin u evidentua ndjesia e përkatësisë me institucionin e cila lidhet dhe me angazhimin në punë dhe për rrjedhojë cilësinë. Një pjesë e stafit përmendi që është rritur profesionalisht në UAMD.</p> <p>Ev.74.CV-te e stafit te departamentit marketing.pdf 20. Lista e Mobiliteteve te Stafit _ Studenteve. Ev.20.Lista e Mobiliteteve te Stafit _ Studenteve. Ev.21.Dep Marketingut Analiza Vjetore 2019-2020. Ev.19.Lista e marreveshjeve bilaterale per shkembime. Ev.76.Vertetim per kontributet e sigurimit shoqeror dhe shendetesor. Tabelat përmbledhëse bachelor (tabela 19, të dhëna për kërkimin shkencor të stafit të angazhuar në programin e studimit; tabelat shtesë të marra gjatë vizitës në institucion).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të</p>	<p>UAMD, në përputhje me aktet e veta rregullatore (Ev.2. Statuti i UAMD, Neni 42-48),ka të përcaktuara procedurat e rekrutimit të personelit akademik, jo akademik si dhe personelit ndihmës akademik. Në bazë të</p>

<p>publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>dokumentacionit si edhe në vizitën që GVJ pati në IAL evidentohet rruga dhe procedurat që ndiqen për punësimin e stafit akademik dhe ndihmës akademik. Departamenti bën planifikimin për staf akademik bazuar nënevojën dhe mbingarkesën e stafit aktual, dhe kjo kërkesë kalohet për miratim tek Rektori i UAMD, pasi është miratuar nga Dekani i FB. Pasi kërkesa miratohet, nga Fakulteti ajo publikohet në faqen e internetit të institucionit. Çdo kandidaturë për pozicionet e hapura vlerësohet nga një Komision ad-hoc, i cili përbëhet nga drejtues të Rektoratit, fakultetit dhe departamentit të gjithë me gradën “Profesor”. Komisionet propozohen nga shefi i departamentit dhe miratohen nga dekani i fakultetit. Në to marrin pjesë stafi më i kualifikuar dhe me eksperiencë më të gjatë në fakultet. Ky komision kryesohet nga përgjegjësi i departamentit.</p> <p><i>Ev.76.Vertetim per kontributet e sigurimit shoqeror dhe shendetesor.</i>  <i>Ev.77.FormularAplikimi Akademik.</i>  <i>Ev.78.Fakulteti-i-Biznesit-njoftim-per-staf-akademik-me-kohe-te-pjesshme.</i>  <i>Ev.79.Fakulteti i Biznesit, kriteret e vendeve te lira te punes.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Për programin e studimit, departamenti angazhon staf ndihmës për menaxhimin e sallave kompjuterike. Nga vizita në IAL u evidentua 1 sallë kompjuterike 52m2 në dispozicion të studentëve dhe stafit të programit të studimit. Stafi i angazhuar ka kualifikimin e nevojshëm për vendin e punës dhe është në dispozicion të nevojave të studentëve.</p> <p><i>Ev.69.Foto të auditorëve, bibliotekës, sallave të konferencave, laboratorëve etj.</i>  <i>Ev.87. Foto të laboratorëve.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike në UAMD është miratuar në strukturën administrative sipas Vendimit nr. 30, datë 31.05.2018 të Bordit të Administrimit të Universitetit “Aleksandër Mosiu” Durrës. Kjo drejtori është e përbërë nga tre sektorë: 1. Sektori i Protokoll Arkivës, 2. Sektori i Burimeve Njerëzore, 3. Sektori i Shërbimeve Juridike (<i>Dokument 14. Organigrama UAMD</i>). Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Juridike, është autoriteti më i lartë i kësaj Drejtorie. Drejtori ka varësi të drejtpërdrejtë nga Rektori i Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës. Gjithashtu, realizon detyra të ngarkuara nga Administratori i Universitetit. Sektori i Burimeve Njerëzore përbëhet nga një përgjegjës dhe katër specialistë; Sektori i Protokoll Arkivës përbëhet nga një përgjegjës sektori dhe dy specialistë; Sektori i shërbimeve juridike përbëhet nga një përgjegjës sektori dhe nga tre specialistë.</p>
	<p>Zyra e Burimeve njerëzore, mbledh, ruan dhe përditëson të dhënat e personelit akademik dhe ndihmës akademik pranë UAMD. Nga intervistimi i personelit të Sektorit të Burimeve njerëzore por edhe nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, kjo zyrë është përgjegjëse</p>

	<p>për të ruajtur të gjithë dokumentacionin procedural lidhur me stafin që angazhohet në fakultet, ruajtjen dhe përditësimin në çdo vit akademik të të dhënave të personelit efektiv dhe atij me kontratë.</p> <p>Kjo zyrë ka ndjekur procedurat për rekrutimin e personelit, ku kriteret i përcaktonte njësia bazë përkatëse, në vijim pritëshin aplikimet, kontrolloheshin nga personeli përgjegjës, dhe procedoheshin për intervistim (<i>Takimi me specialistin e Burimeve Njerëzore</i>). Nga investigimi i dy dosjeve të rastësishme (një PAE dhe një PAK) nuk u vërejtën mangësi në dokumentacion (<i>Takimi me specialistë të Burimeve njerëzore</i>).</p> <p><i>Ev.78.Fakulteti-i-Biznesit-njoftim-per-staf-akademik-me-kohe-te-pjesshme.</i></p> <p><i>Ev.79.Fakulteti i Biznesit, kriteret e vendeve te lira te pune</i></p> <p><i>Ev.14.Organigrama UAMD.</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>UAMD-FB-Departamenti i Marketingut ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi me IAL të tjera, përfaqësues të biznesit, etj. Përsa i përket tutorëve për mbikëqyrjen, udhëheqjen dhe keshillimin e studentëve në praktikën profesionale, Departamenti i Marketingut vë në dispozicion pedagogë të brendshëm me ekspertizën përkatëse për t'i ardhur në ndihmë studentëve. Po kështu IAL ka vënë në dispozicion edhe një vlerësim të udhëheqësit të praktikantit në institucion.</p> <p><i>Ev.13.Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit.</i></p> <p><i>Ev.16.Marreveshjet e bashkepunimit Dep Marketingut.</i></p> <p><i>Ev.17.Raport Vjetor UAMD 2020-2021.</i></p> <p><i>Ev.18.Marreveshje Bashkepunimi UAMD.</i></p> <p><i>Ev.19.Lista e marreveshjeve bilaterale per shkembime.</i></p> <p><i>Ev.20.Lista e Mobiliteteve te Stafit _ Studenteve.</i></p> <p><i>Ev.24.Formulari i Vlerësimit të Praktikës Profesionale.</i></p>
<p><b>Kriter 8.</b> Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Marrëveshja me punëdhënësit pranë të cilëve studenti ndjek praktikën, parashikon që punëdhënësi të bëjë një vlerësim të ndjekjes dhe angazhimit së studentit në aktivitetet e biznesit/institucionit. Ai vlerëson nëse studentit ka përmbushur objektivat e synuara gjatë periudhës së praktikës mësimore. Vlerësimi i studentit gjatë praktikës është objekt analize edhe nga pedagogët përgjegjës të caktuar nga departamenti. Në fund të praktikës profesionale, studentit përgatit një raport ku paraqet arritjet dhe njohuritë e fituara gjatë praktikës. Po kështu IAL ka vënë në dispozicion edhe një vlerësim të udhëheqësit të praktikantit në institucion.</p> <p><i>Ev.24.Formulari i Vlerësimit të Praktikës Profesionale.</i></p> <p><i>Ev.124.Rregullore praktike.</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson se personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit. Ky vlerësim është</i></p>

	bazuar në një sërë indikatorësh të evidentuar si sa i përket mbulimit PAE/PAK por edhe indikatorët cilësorë të analizuar mbi bazën e CV dhe angazhimit të stafit në aktivitete përpos mësimdhënies. Megjithatë GVJ vlerëson gjithashtu që IAL duhet të bëjë më shumë përpjekje për të zbatuar standartet në lidhje me titullarët e moduleve të cilët duhet të jenë të kategorise Profesor si dhe të trajtojë me prioritet tejkalin e normës mësimore për të siguruar cilësinë e arsimit (mësimdhënie/kërkim) dhe mirëqenien e stafit mësimor.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Referuar vizitës në institucion dhe të dhënave për infrastukturën e UAMD-FB, GVJ konstaton se Fakulteti i Biznesit disponon 16 salla leksionesh dhe auditorë për seminare. 1 sallë kompjuterash me sipërfaqje 52m <sup>2</sup> , një sallë për aktivitete promovuese me sip 192.8 m <sup>2</sup> ,një sallë bibliotekë 45.7 m <sup>2</sup> .Sallat e leksioneve dhe të seminareve janë të pajisura me kompjutera e projektorë.  Zyrat që kryejnë funksionet mbështetëse, të tilla si: Burimet Njerezore, Financa, Biblioteka, etj janë të akomoduar në ambjentet e tyre përkatëse të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një funksionim normal të aktiviteteve të tyre në godinën numër 2 ku ndodhet dhe kampusi i UAMD.  <i>Ev.85.Përmbledhëse e kapaciteteve të UAMD-së.</i> <i>Ev.86.Ambiente të Fakultetit të Biznesit.</i> <i>Ev.87.Foto të laboratorëve.</i> <i>Ev.88.Bibloteka online.</i> <i>Ev.89.Kalendari i funksionimit të Bibliotekës në fundjavë.</i> <i>Ev.90.Kapacitetet infrastrukturore të godinës Nr. 2 Kampus.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Në ambjentet e FB ndodhen një laborator informatike me sip. 52m <sup>2</sup> dhe biblioteka. Laboratori përdoret në aplikimin praktik të metodave kërkimore dhe programeve informative. Në këto laboratore janë të instaluar programet SPSS dhe ALFA, në mënyrë që studentët t'i aplikojnë direkt njohuritë teorike të marra në orët përkatëse mësimore.  <i>Ev.85.Përmbledhëse e kapaciteteve të UAMD-së.</i> <i>Ev.86.Ambiente të Fakultetit të Biznesit.</i> <i>Ev.87.Foto të laboratorëve.</i> <i>Ev.88.Bibloteka online.</i>

	<p><i>Ev.89.Kalendari i funksionimit të Bibliotekës në fundjavë.</i>  <i>Ev.90.Kapacitetet infrastrukturore të godinës Nr. 2 Kampus.</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Nga takimi me stafin e angazhuar në progamin e studimit por edhe vizita në IAL, u evidentua që laboratorët janë të pajisur me programet e nevojshme për arritjen e objektivave mësimorë të studentëve. <i>GVJ rekomandon që IAL të ketë në konsideratë në vijim pajisjen me software të tjerë më të përditësuar duke pasur parasysh evolimin e teknologjisë si dhe tematikat e reja të studimit që lidhen me Inteligjencën artificiale dhe ndryshimet e fundit në teknologjitë e analizës së biznesit sidomos ato që lidhen me menaxhimin e aktiviteteve të marketingut.</i></p> <p><i>Ev.85.Përmbledhëse e kapaciteteve të UAMD-së.</i>  <i>Ev.86.Ambiente të Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.87.Foto të laboratorëve.</i>  <i>Ev.88.Bibloteka online.</i>  <i>Ev.89.Kalendari i funksionimit të Bibliotekës në fundjavë.</i>  <i>Ev.90.Kapacitetet infrastrukturore të godinës Nr. 2 Kampus.</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Nga takimi në IAL, u evidentua se në ambjentet e FB-UAMD ku zhvillohet mësimi për programin e studimit në ciklin e parë në “Menaxhim Marketing”, ndodhet një sallë laboratorit informatik. Laboratori përdoret për aplikimin praktik të metodave kërkimore për nevojat e programit të studimit. <i>GVJ vlerëson që IAL ofron për programin e studimit mjaftueshëm kapacitete laboratorike për arritjen e objektivave të tij dhe pse ka nevojë për një përditësim të softeve të përdorura.</i></p> <p><i>Ev.85.Përmbledhëse e kapaciteteve të UAMD-së.</i>  <i>Ev.86.Ambiente të Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.87.Foto të laboratorëve.</i>  <i>Ev.88.Bibloteka online.</i>  <i>Ev.89.Kalendari i funksionimit të Bibliotekës në fundjavë.</i>  <i>Ev.90.Kapacitetet infrastrukturore të godinës Nr. 2 Kampus.</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson që UAMD-FB ka vënë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik dhe rekomandon që IAL të ketë në konsideratë në vijim pajisjen me software të tjerë më të përditësuar duke pasur parasysh evolimin e teknologjisë si dhe tematikat e reja të studimit që lidhen me Inteligjencën artificiale dhe ndryshimet e fundit në teknologjitë e analizës së biznesit sidomos ato që lidhen me menaxhimin e aktiviteteve të marketingut.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>



Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme. të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>GVJ, pasi vlerësoi syllabuset dhe realizoi vizitën në IAL, evidentoi dy elementë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit, <i>por ajo nuk është në të gjitha rastet e 5 viteve të fundit si: Bazat e Biznesit, Makroekonomi I, Shkrim Akademik, Hyrje në Shkencat Politike, Metodat e Kerkimit Shkencor, Drejtim Marketing.</i></li> <li>IAL është pjesë e U.Librari.Rash (<a href="https://ulibrary.rash.al/">https://ulibrary.rash.al/</a>) si dhe ka një bibliotekë më një numër të konsiderueshëm numrash që lidhen direkt me programin e studimit në fjalë <a href="https://uamd.edu.al/biblioteka-universitare/">https://uamd.edu.al/biblioteka-universitare/</a>. Akses në: U-LIBRARY (EBSCO) dhe lista e paketave që përfshihen U-LIBRARY janë: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Academic Search;</li> <li>- Complete: databaza kryesore e revistave/ periodikeve/ librave, etj., të dedikuar vetëm për arsimin e lartë dhe kërkimin;</li> <li>- Business Source Complete;</li> <li>- Regional Business Nees Plus;</li> <li>- Neëspaper Source Plus;</li> <li>- MasterFILE Complete;</li> <li>- Health Source: Academic &amp; Nursing Edition;</li> <li>- Consumer Edition;</li> <li>- ERIC;</li> <li>- MEDLINE;</li> <li>- Rosetta Stone Library Solution Plus;</li> <li>- eBook Academic Collection;</li> <li>- EBSCO Discovery Service (EDS) (without OPAC).</li> </ul> </li> <li>Aksesinë: <a href="http://Jstor.org">Jstor.org</a>. Biblioteka ofron mbi 12 milion artikuj shkencorë, libra, në 75 disiplina të ndryshme.</li> </ol> <p>Pra, IAL disponon të gjitha mundësitë për të ofruar literaturën e nevojshme që mbështet arritjen e objektivave të programit të studimit.</p> <p><i>Tabelat përmbledhëse bachelor MM (tabela 17).</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>GVJ vlerëson se njësia bazë paraqet nëpërmjet raportimit të saj në RVB dhe nga vizita në Institucion, se syllabuset (programet e lëndëve) përditësohen çdo vit duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të viteve të fundit. <i>Megjithatë kjo nuk evidentohet në të gjithë silabuset e paraqitur nga IAL.</i> Kështu, për lëndët “Baza biznesi”, literatura e</p>

	<p>rekomanduar është e viteve 2007-2009 ( A crash in Business Basics, Richard Stem &amp; Lisa Guerin, Delta Printing Solutions Inc, New York, 2008 • Introduction to business, Jef Madurra (4th edition), Thomson, South Eest, USA, 2007 • Introduction to Business, Gareth R. Jones, McGraë-Hill Irëin, Boston, 2009), po kështu për këtë lëndë do të ishte e rekomandueshme që titullarët e lëndëve të paraqesin literaturën në të cilën ata janë bazuar si dhe vitin e botimit të saj. Për lëndën “Menaxhimi i Markës”, literatura e rekomanduar: Brand Management: Research, Theory and Practice, Tilde Heding, Charlotte F. Knudtzen, Mogens Bjerre, 2009 , Brand Management 101: 101 Lessons from real World marketing, Mainak Dhar, 2007 Understanding Brands, Peter Cheverton, 2006. Për lëndën Shkrim akademik, literatura bazë e detyrueshme bazohet te leksionet e pedagogut të kursit nga -Kennedy, X. J. &amp; Dorothy M., &amp; Maria F. (2009). Për lëndën Informatikë, paraqitet që disponohet cikli i leksioneve por nuk evidentohet titulli i librit dhe viti i botimit të tij.</p> <p><i>Për të garantuar një arsimim cilësor dhe relevant në fushën e Menaxhimit të Marketingut, është thelbësore që pedagogët të përditësojnë vazhdimisht literaturën në syllabuset e tyre. Po kështu GVJ rekomandon që për çdo cikël leksionesh të përgatitur nga pedagogu titullar të shoqërohet me një listë të detajuar të burimeve dhe literaturës së përdorur. Kjo jo vetëm ndihmon studentët të ndjekin dhe të kuptojnë më mirë materialin, por gjithashtu mundëson monitorimin e zbatimit të standardeve ligjore dhe akademike.</i></p> <p>GVJ vlerëson se lidhjet akademike me pedagogë të universiteteve të tjera si dhe pjesëmarrja aktive e stafit në projekte Capacity Building në Universitet bëjnë të mundur pajisjen me libra të formatit hard-copy dhe online version të tyre duke mundësuar perditësimin e vazhdueshëm të literatures se detyrueshme dhe te rekomanduar.</p> <p><i>Ev.31.Syllabuset e Lëndëve BSc. MM.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. Ajo funksionon në përputhje me Ligjin Nr. 8576, datë 03.02.2000 “Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë”, neni 30. Ajo kryen dixhitalizimin e skedarëve dhe ka në fondin e saj rreth 12.000 libra në gjuhën shqipe dhe të huaj, në formatin letër dhe elektronik. Gjithashtu, ofron mundësi kërkimi të informacionit on-line, në sallën e leximit, mundësi shfletimi të literaturës elektronike, pranë kompjuterave të sallës, si edhe lehtësi në kërkimin bibliografik të informacionit. Biblioteka ofron për përdoruesit e saj një sërë shërbimesh si: shërbimin e informacionit dhe të huazimit, vë në dispozicion të tyre mediatekën si dhe salla leximi.</p>

	<p><i>Ev.88. Bibloteka online.</i>  <i>Ev.89. Kalendari i funksionimit të Bibliotekës në fundjavë.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, në gjuhën shqipe dhe të huaj, libra apo revista shkencore të nevojshme. Këto info gjenden edhe në websiten e Bibliotekës.</p> <p><i>Vizita e GVJ në IAL.</i>  <i>Ev.88. Bibloteka online.</i>  <i>Ev 89. Kalendari i funksionimit të Bibliotekës në fundjavë.</i>  <a href="https://uamd.edu.al/biblioteka-universitare/">https://uamd.edu.al/biblioteka-universitare/</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Studentët kanë akses të plotë në shfrytëzimin e kapaciteteve të bibliotekës, pa pagesë duke ofruar edhe platforma online. Biblioteka u ofron shërbim pedagogëve dhe studentëve përmes sportelit të huazimit, sportelit të informacionit dhe mediatekës. Po kështu ata kanë akses dhe në katalogët:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Katalogu Botëror WorldCat <a href="http://www.worldcat.org/">http://www.worldcat.org/</a>;</li> <li>• Katalogu i Bibliotekës Britanike <a href="http://catalog.bl.uk/">http://catalog.bl.uk/</a>;</li> <li>• Katalogu i Bibliotekës së Kongresit Amerikan <a href="http://catalog.loc.gov/">http://catalog.loc.gov/</a>;</li> <li>• Index Translationum <a href="http://databases.unesco.org/xtrans/xtra-form.shtml">http://databases.unesco.org/xtrans/xtra-form.shtml</a>;</li> <li>• Katalogu përmbledhës i bibliotekave të Francës – CCFr <a href="http://ccfr.bnf.fr/portailccfr/servlet/LoginServlet">http://ccfr.bnf.fr/portailccfr/servlet/LoginServlet</a>.</li> </ul> <p><i>Vizita e GVJ në IAL, RVB dhe konsultimi i website.</i>  <a href="https://uamd.edu.al/biblioteka-universitare/">https://uamd.edu.al/biblioteka-universitare/</a></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike. që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka ka në përbërjen e saj sallën e kompjuterave nr. 205, e cila i mundëson përdoruesve përdorimin e kompjuterave, zhvillimin e aktiviteteve, trajnim mbi përdorimin e katalogut online, etj.</p> <p>Me shfrytëzimin e sistemeve me bazë “kod të hapur”, mbështetur në udhëzimet e Bashkimit Europian, nenit nr. 179 të Traktatit të Lisbonës mbi burimet e hapura (open access), me mbështetjen e IFLA-s, Biblioteka Universitare, në shtator 2014, instaloi falas Katalogun Online të Integruar, për menaxhimin e fondit të saj. Katalogu ofron një version të avancuar në kërkimin e informacionit. Përveç përshkrimit bibliografik, katalogu ofron falas në formatin elektronik artikuj, teza, kërkimin shkencor dhe disertacionet e stafit akademik të Universitetit “Aleksandër Moisiu”.</p> <p><a href="https://uamd.edu.al/biblioteka-universitare/">https://uamd.edu.al/biblioteka-universitare/</a></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit</p>	<p>Orari i punës në bibliotekë shpallet në mjediset e institucionit dhe në web-in e universitetit, nga e hëna në të premte: 08.00-16.00, ndërsa</p>

<p>mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>shërbimi i informacionit elektronik (me e-mail/katalog elektronik) e hënë-e diel: 8:00-20:00.</p> <p>Çdo student/pedagog ka të drejtën e anëtarësimit falas në bibliotekë. Studenti disponon një kartelë regjistrimi me të dhënat personale dhe pajiset me librezë anëtarësie. Ai ka të drejtë të përdorë kompjuterat e sallave për përdorimin e katalogut elektronik. Kapaciteti i stafit të bibliotekës është i tillë që përballon nevojat e studentëve për shërbim, apo edhe shfrytëzim të mjediseve për punë në grup apo prezantime.</p> <p><i>Ev.69. Foto të auditorëve, bibliotekës, sallave të konferencave, laboratorëve etj.</i></p> <p><i>Ev.88. Bibloteka online.</i></p> <p><i>Ev.89. Kalendari i funksionimit të Bibliotekës në fundjavë.</i></p> <p><i>Ev.91. Memo e kalendarit të bibliotekës.</i></p> <p><i>Ev.92. Rregullorja e Bibliotekes Shkencore.</i></p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Përpos burimeve fizike, biblioteka ofron dhe Burime ndërkombëtare elektronike me tekst të plotë për stafin e pedagogëve, studentëve dhe përdoruesve të tjerë të BUSH Biblioteka Universitare Shkencore përmes projektit ERA 2012 (Elektronik Resources for Albania) siguron akses pa pagesë në burimet ndërkombëtare elektronike me tekst të plotë nga: <a href="http://kataloguonline.uamd.edu.al">kataloguonline.uamd.edu.al</a>.</p> <p>Biblioteka e UAMD si një bibliotekë me fonde të hapura dhe hibride, mundëson kërkim të informacionit “online”, në sallën e leximit, skedarë elektronikë, lehtësira në kërkimin bibliografik të informacionit, mundësi shfletimi të literaturës elektronike pranë kompjuterave të sallës. GVJ rekomandon një analizë të shfrytëzimit të sallave të studimit.</p> <p><a href="http://kataloguonline.uamd.edu.al">kataloguonline.uamd.edu.al</a>.</p> <p><i>Ev.69. Foto të auditorëve, bibliotekës, sallave të konferencave, laboratorëve etj.</i></p> <p><i>Ev.88. Bibloteka online.</i></p> <p><i>Ev.89. Kalendari i funksionimit të Bibliotekës në fundjavë.</i></p> <p><i>Ev.91. Memo e kalendarit të bibliotekës.</i></p> <p><i>Ev.92. Rregullorja e Bibliotekes Shkencore.</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ vlerëson që IAL ka të gjitha kapacitetet për të ofruar literaturë fizike dhe online për nevojat e programit të studimit. Për të garantuar një arsimim cilësor dhe relevant në fushën e menaxhimit të marketingut, është thelbësore që pedagogët të përditësojnë vazhdimisht literaturën në syllabuset e tyre. Po kështu GVJ rekomandon që për çdo cikël leksionesh të përgatitur nga pedagogu titullar të shoqërohet me një listë të detajuar të burimeve dhe literaturës së përdorur. Kjo jo vetëm ndihmon studentët të ndjekin dhe të kuptojnë më mirë materialin, por gjithashtu mundëson monitorimin e zbatimit të standardeve ligjore dhe akademike.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p><b>X</b></p>	

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43 123

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

52

<b>Standardi IV.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni disponon një sërë procedurash të cilat rregullojnë menaxhimin e informacionit që lidhet me studentin. Sekretaria mësimore disponon një sistem kompjuterik menaxhimi dhe administrimi të informacionit të studentit nga krijimi i kartelës dhe regjistrimi i parë deri në diplomim të tij (sekretaria online). Dokumentacioni themelor për studentët është: regjistri themeltar, që vërteton regjistrimin e studentit pajiset me numër matrikullimi, regjistri i arritjeve akademike të studentëve si dhe regjistri i lëshimit të diplomave. Këto regjistra pas diplomimit të studentëve arkivohen në arkivën e UAMD në formë hardcopy dhe elektronike. Gjatë vizitës në institucion, GVJ verifikoi mbajtjen e regjistrave manual nga sekretaria mësimore në lidhje me studentët e programit. UAMD ofron faqen elektronike online <a href="https://uamd.edu.al/kriteret-e-pranimit/">https://uamd.edu.al/kriteret-e-pranimit/</a> ku studentët vihen në dijeni të njoftimeve, eventeve, orareve, datave të provimeve, etj. Platforma elektronike <a href="https://uamd.edu.al/pitagora/">https://uamd.edu.al/pitagora/</a> krijon lehtësi në sistemin e menaxhimit të të dhënave për studentët dhe stafin mësimdhënës. Aty studentët kanë mundësi të regjistrojnë orarin, të shohin rezultatet etj. Pasi studenti fiton të drejtën e studimit, regjistrohet në sekretarinë mësimore dhe pajiset me një llogari, e cila ka username dhe password personal për platformën online. <a href="https://uamd.edu.al/kriteret-e-pranimit/">https://uamd.edu.al/kriteret-e-pranimit/</a> <a href="https://uamd.edu.al/pitagora/">https://uamd.edu.al/pitagora/</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sikurse është përmendur edhe më lart, UAMD ka adoptuar sistemin e menaxhimit të studentëve Pitagora që nga viti akademik 2019, i cili kryen funksionin në formë elektronike, krahas asaj të shkruar. Para këtij viti disponohet një regjistër i tillë vetëm në formë të shkruar. Platforma Pitagora për menaxhimin e studentëve, garanton një menaxhim efikas të të dhënave të studentit gjatë gjithë karrierës së tij dhe pas saj. UAMD disponon laboratorë të IT-së, Sektorin e Menaxhimit të Sistemit, serverat, telefoninë. UAMD publikon në faqen zyrtare të gjitha të dhënat statistikore për numrin e studentëve sipas programeve, ofertën akademike, ndërtimin dhe funksionimin e institucionit, si dhe statutin dhe rregulloret e funksionimit të tij. (<a href="http://www.uamd.edu.al">www.uamd.edu.al</a>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit</p>	<p>Të dhënat janë të ruajtura në një bazë të dhënash qendrore në një server, i cili ndodhet në ambientet e AKSHI-i. Softi përdoret nga disa kategori përdoruesish:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dekanët e fakulteteve;</li> </ul>

<p>ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejtorët e departamenteve;</li> <li>• Drejtoria Juridike dhe e Burimeve njerëzore;</li> <li>• Drejtoria ekonomike;</li> <li>• Drejtoria Kurikulave, Kërkimit Shkencor dhe standardeve;</li> <li>• Drejtoria IT.</li> </ul> <p>Sektori i Teknologjisë dhe Informacionit në UAMD, bashkërendon veprimtaritë në fushën e teknologjisë së informacionit, duke pasqyruar oraret e mësimit, datat e provimeve, strukturën organizative, organigramën, detyrimet e studentit, tarifat e studimit, vlerësimet e studenteve, veprimtarinë akademike dhe sociale të USH-së (<a href="http://www.uamd.edu.al">www.uamd.edu.al</a>).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Monitorimi në kohë reale i aktivitetit të personelit akademik dhe ndihmës akademik, në Departamentin e Marketingut në FB në UAMD, bëhet nga përgjegjësi i departamentit. Raportet e monitorimit në lidhje me orarin e mësimit, ngarkesën mësimore, etikën e komunikimit etj, përcillen në fakultet. Një praktikë e monitorimit të aktivitetit akademik është krijuar me raportimin e analizës mësimore kërkimore. Në këto të fundit monitorohen të gjitha aktivitetet që lidhen me programin e studimit nga këndvështrimi sasior dhe cilësor. GVJ e vlerëson këtë praktikë dhe informacionet shteruese që gjenden në të.</p> <p><i>Ev.21. Dep Marketingut Analiza Vjetore 2019-2020.</i>  <i>Ev.66. Lista Aktiviteteve Dep Marketingut v.a. 2020-2021.</i>  <i>Ev.65. Analiza Vjetore e Departamentit të Marketingut, 2021-2022.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Informacionet që lidhen me programet e studimit publikohen në faqen e internetit të UAMD, si dhe në rrjetet sociale zyrtare të UAMD. Gjithashtu, edhe aktivitetet që realizohen publikohen në faqen e internetit. Nga konstatimi i GVJ, faqja web zyrtare e UAMD (<a href="https://uamd.edu.al/">https://uamd.edu.al/</a>) si edhe ajo e Fakultetit të Biznesit, ndër të tjera, përfshin informacion lidhur me programin dhe stafin dhe njoftime të ndryshme. Faqja web është e ndërtuar në dy gjuhë: shqip dhe anglisht. Po kështu nga takimi me stafin e angazhuar në këtë program studimi komunikimi u evidentua si një pikë e fortë. Po kështu edhe studentët kur u pyetën se si u njoftuan për programin e studimit përmenden mediat sociale të UAMD.</p> <p><a href="https://uamd.edu.al/fakulteti-i-biznesit/">https://uamd.edu.al/fakulteti-i-biznesit/</a>  <a href="https://uamd.edu.al/departamenti-i-marketingut/">https://uamd.edu.al/departamenti-i-marketingut/</a>  <a href="https://uamd.edu.al/menaxhim-marketing/">https://uamd.edu.al/menaxhim-marketing/</a>  <a href="https://www.facebook.com/uamdofficial/">https://www.facebook.com/uamdofficial/</a>  <a href="https://www.linkedin.com/company/aleksander-moisiu-university/">https://www.linkedin.com/company/aleksander-moisiu-university/</a>  <a href="https://www.instagram.com/uamdofficial/">https://www.instagram.com/uamdofficial/</a></p> <p><i>Ev.128. Publikime ne Rrjete sociale FB -Raundet e Regjistrimit.</i>  <i>Ev.129. Publikime ne Rrjete sociale FB -Raundet e Regjistrimit.</i>  <i>Ev.130. Promovimi ne faqen e departamentit.</i>  <i>Ev.131. Promovim tek maturantet.</i></p>




	<i>Ev.132.Promovimi ne Rrethe -Broshura Promovimi i Programeve.</i>		
<b>Konkluzione</b>	GVJ vlerëson që UAMD disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit. Gjithashtu, UAMD informon në mënyrë të vazhdueshme për përmirësimin e mëtejshëm të shërbimeve digjitale për të gjithë aktorët.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi IV.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ referuar RVB dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga IAL, konstaton se Institucioni harton një raport financiar dhe planin për mbështetjen financiare konform legjislacionit në fuqi, që rregullon veprimtarinë e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. Raporti financiar i hartuar nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në UAMD detajohet dhe paraqitet me zërat e kostove përkatëse për programet e cikleve të studimit Bachelor, Master Profesional dhe Master i Shkencave në rang fakulteti.  <i>RVB Bsc. Menaxhim Marketing.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	GVJ referuar RVB dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Institucioni, konstaton se në planin financiar përfshihen:  a) të ardhura: buxheti i shtetit, tarifat e shkollimit, tarifat e regjistrimit, të ardhura nga shërbime të ndryshme të kryera, donacione e burime të tjera etj;  b) shpenzime: për pagat, shpenzime operative, sigurimin e cilësisë, pasurimin e bibliotekës etj;  Të gjitha kategoritë e këtij kriteri janë të përfshira në këtë plan financiar.  <i>RVB Bsc. Menaxhim Marketing.</i> <i>Tabelat përmbledhëse Bachelor (tabela 18, të dhëna për financimet e ndryshme në tre vitet e fundit).</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Institucioni, nëpërmjet Drejtorisë së Auditit të Brendshëm i cili është nën varësinë e Bordit të Administrimit të Institucionit, kryen audit të brendshëm të përvitshëm. Referuar RVB-së konstatohet se në mënyrë periodike kjo drejtori, bën relacion mbi projekt buxhetin me qëllim që të kontrollojë mbarëvajtjen e programeve të studimit të të gjitha cikleve përgjatë kohës së shtrirjes së studimeve. <i>Megjithatë, për të pasur ecuri</i>

	<p>të qëndrueshme financiare, njësia bazë dhe ajo kryesore duhet të bëjnë më shumë përpjekje për të ofruar një program sa më të diferencuar në raport me programet që ofrohen nga Departamenti i Turizmit, Menaxhimit dhe vetë Departamenti i Marketingut.</p> <p><i>RVB Bsc. Menaxhim Marketing.</i>  <i>Tabelat përmbledhëse Bachelor (tabela 18, të dhëna për financimet e ndryshme në tre vitet e fundit).</i>  <i>Ev.94. Raporti-financiar-2021-2022.</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Institucioni harton raportin për tre vitet e kaluara për të evidentuar masën e realizimit të të ardhurave si dhe nivelin e shpenzimeve. Raporti financiar përmban informacion lidhur me tarifat e shkollimit dhe kontributet e tjera, si dhe ndarjen e burimeve financiare.</p> <p><i>Ev.RVB Bsc. Menaxhim Marketing.</i>  <i>Ev.94. Raporti-financiar-2021-2022.</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ duke ju referuar RVB dhe vizitës në institucion, evidenton se IAL dëshmon dhe garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe kjo duke ju referuar numrit të studentëve të regjistruar në programin e studimit BA MM (për vitin akademik 2020-2021 janë regjistruar 51 studentë, prej të cilëve 4 janë çregjistruar; për vitin akademik 2021-2022 janë regjistruar 39 studentë, prej të cilëve 3 janë çregjistruar; për vitin akademik 2022-2023 janë regjistruar 42 studentë).</p> <p>Drejtoria e financës dhe buxhetit hartojnë relacionin për buxhetin afat-mesëm dhe afat-gjatë duke analizuar të gjithë programet e studimit. Në këtë mënyrë evidentohen problemet përkatëse dhe nevojat për investime dhe burimet e të ardhurave për realizimin e tyre.</p> <p><i>Ev. RVB Bsc Menaxhim Marketing</i>  <i>Ev.37. Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës neni 91-96</i>  <i>Ev.94. Raporti-financiar-2021-2022.</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ vlerëson se UAMD garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësues-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve. Megjithatë, për të pasur ecuri të qëndrueshme financiare, njësia bazë dhe ajo kryesore duhet të bëjnë më shumë përpjekje për të ofruar një program sa më të diferencuar në raport me programet që ofrohen nga Departamenti i Turizmit, Menaxhimit dhe vetë Departamenti i Marketingut.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	



## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Politikat dhe procedurat e hartuara që mbulojnë ciklin e parë të studimeve reflektohen në Rregulloren Institucionale të UAMD; Rregulloren e Brendshme të Fakultetit të Biznesit; Rregulloren e Departamentit Marketing dhe Rregulloren e programit të studimit Bachelor “Menaxhim Marketing”. GVJ konstaton se të gjitha dokumentet e mësipërme janë hartuar në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë dhe aktet e tjera rregullatore në zbatim të tyre. Njëpërmjet tyre zbatohen politikat dhe procedurat që përfshijnë gjithë aktivitetin akademik të studentëve gjatë të gjithë ciklit të studimeve. Ndër të tjera janë të parashikuara procedurat e propozimit dhe miratimit të kuotave, të kriterëve të pranimit, procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve, rregullat e vlerësimit të njohurive të studentëve, rregullat e kalimit nga një vit në tjetrin, të transferimit të studentëve, të ndjekjes së programeve të ciklit të parë.</p> <p><i>Ev.2.Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës.</i>  <i>Ev.3.Plani Strategjik per Departamentin e Marketingut-2021 – 2025.</i>  <i>Ev.4.Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i>  <i>Ev.15.Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.25.Rregullore e Detyrimeve Permbyllese cikli Bachelor.</i>  <i>Ev.34.Rregullore e Departamentit Marketing.</i>  <i>Ev.37.Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Politikat dhe procedurat në lidhje me pranimin, përparimin e studentëve, frekuentimin dhe përfaqësimin e tyre në organet drejtuese janë të rregulluara njëpërmjet Rregullores Institucionale të UAMD; Rregullores se Brendshme të Fakultetit të Biznesit; Rregulloren e Departamentit Marketing dhe Rregulloren e programit të studimit Bachelor “Menaxhim Marketing”. Pranimi i kandidatëve të rinj bëhet konform udhëzimeve të MAS dhe kriterëve të përcaktuara nga njësia kryesore (fakulteti) e të miratuara në Senatit Akademik, ndërsa barazia dhe të drejtat e njëjta për studentët e programit të studimit garantoohen nga rregulloret. GVJ konstaton se UAMD ndjek një proces transparent dhe jo diskriminues, duke mundur një konkurrencë të drejtë bazuar në vlerat individuale të gjithsecilit student.</p> <p><i>Ev.2.Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës.</i>  <i>Ev.3.Plani Strategjik per Departamentin e Marketingut-2021 – 2025.</i></p>




	<p><i>Ev.4.Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i>  <i>Ev.15.Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.25.Rregullore e Detyrimeve Permbyllese cikli Bachelor.</i>  <i>Ev.34.Rregullore e Departamentit Marketing.</i>  <i>Ev.37.Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në ciklin e studimeve 3-vjeçare Bachelor "Menaxhim Marketing" përcaktohen nga MAS për vitin akademik përkatës dhe publikohen nga institucioni në fillim të çdo viti akademik. Në Rregulloren e UAMD dhe të programit të studimit, qartësohen kushtet dhe procedurat e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit.</p> <p>Sipas rregullores së programit të studimit, pranimi në programet e studimit të ciklit të parë bëhet i mundur për ata që kanë përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm të përgjithshëm ose profesional, si dhe kandidatët që disponojnë diplomën e shkollës së mesme jashtë vendit (të ekuivalentuar nga MAS).</p> <p><i>Ev.2.Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës.</i>  <i>Ev.4.Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i>  <i>Ev.15.Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.34.Rregullore e Departamentit Marketing.</i>  <i>Ev.37.Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit e transferimit të tyre janë të evidentuara sipas Statutit të UAMD, Rregullores Institucionale të UAMD; Rregullores së Brendshme të Fakultetit të Biznesit; Rregullores së Departamentit Marketing dhe Rregullores së programit të studimit Bachelor "Menaxhim Marketing". Njohja e plotë dhe e pjeshme e krediteve të studentëve që vijnë me transferim nga programe të tjera studimi brenda ose dhe jashtë UAMD u mundësohet studentëve sipas Rregullores së UAMD. Kriteret dhe procedurat e pranimit e transferimit janë lehtësisht të aksesueshme dhe të kuptueshme nga studentët në faqen web të UAMD <a href="https://uamd.edu.al/kriteret-e-pranimit/">https://uamd.edu.al/kriteret-e-pranimit/</a>.</p> <p><i>Ev.2.Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës.</i>  <i>Ev.4.Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i>  <i>Ev.15.Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.34.Rregullore e Departamentit Marketing.</i>  <i>Ev.37.Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.</i>  <i>Ev.95.Kritere pranimi bachelor dhe msc ne dep.e marketingut 2019-2020.</i>  <i>Ev.134.Publikimi i Kritereve e Pranimit 2022-2023.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në</p>	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik UAMD realizon një fushatë informimi dhe ndërgjegjësimi, për të gjithë të interesuarit që duan të vazhdojnë studimet e tyre në Bachelor "Menaxhim Marketing", duke</p>




<p>lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>publikuar informacione e shpërndarë njëkohësisht broshura e fletëpalosje informuese. Gjatë takimit në institucion, GVJ u informua se përcjelljen e kërkesave e kriterëve të programit për publikun dhe të interesuarit, UAMD e realizon edhe nëpërmjet aktiviteteve të tjera të realizuara në koordinim edhe me Zyrën e Studentit dhe Karrierës. Disa nga format e promovimit përfshijnë: ditët e hapura, panairi work&amp;study, dhe aktivitete të ndryshme sensibilizuese të cilat promovohen edhe në webfaqen e institucionit.</p> <p>Informacionet që lidhen me programet e studimit publikohen në faqen e internetit të UAMD, si dhe në rrjetet sociale zyrtare të UAMD. Nga konstatimi i GVJ, faqja web zyrtare e UAMD, si edhe ajo e Fakultetit të Biznesit, përmbajnë informacione lidhur me programin. Nga takimi i GVJ me stafin e angazhuar në këtë program studimi, komunikimi u evidentua si një pikë e fortë. Gjithashtu studentët kur u pyetën se si u njoftuan për programin e studimit përmenden mediat sociale të UAMD.</p> <p><a href="https://uamd.edu.al/fakulteti-i-biznesit/">https://uamd.edu.al/fakulteti-i-biznesit/</a>  <a href="https://uamd.edu.al/departamenti-i-marketingut/">https://uamd.edu.al/departamenti-i-marketingut/</a>  <a href="https://uamd.edu.al/menaxhim-marketing/">https://uamd.edu.al/menaxhim-marketing/</a>  <a href="https://www.facebook.com/uamdofficial/">https://www.facebook.com/uamdofficial/</a>  <a href="https://www.linkedin.com/company/aleksander-moisiu-university/">https://www.linkedin.com/company/aleksander-moisiu-university/</a>  <a href="https://www.instagram.com/uamdofficial/">https://www.instagram.com/uamdofficial/</a></p> <p>Ev.84.Draft_Agjendë_panairi i punes dhe i karrieres 2022.  Ev.95.Kritere pranimi bachelor dhe msc ne dep.e marketingut 2019-2020.  Ev.128.Publikime ne Rrjete sociale FB -Raundet e Regjistrimit.  Ev.129.Publikime ne Rrjete sociale FB -Raundet e Regjistrimit.  Ev.130.Promovimi ne faqen e departamentit.  Ev.131.Promovim tek maturantet.  Ev.132.Promovimi ne Rrethe -Broshura Promovimi i Programeve.  Ev.134.Publikimi i Kriterëve e Pranimi 2022-2023.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Pranimi i kandidatëve të rinj bëhet konform udhëzimeve të MAS, kuotave të propozuara nga njësia bazë dhe kriterëve të përcaktuara nga njësia kryesore e të miratuara në Senat Akademik. Ky proces siguron një hyrje të drejtë për të gjithë studentët, duke garantuar barazinë dhe të drejtat e njëjta në fillim të studimeve.</p> <p>Për studentët e programit të studimit 3-vjeçare Bachelor “Menaxhim Marketing”, barazia dhe të drejtat e tyre specifike janë garantuar nga rregulloret e posaçme përkatëse të UAMD, dhe Fakultetit të Biznesit. Këto masa dhe udhëzime përbëjnë bazën për një mjedis të drejtë dhe të barabartë për të gjithë studentët në rrugëtimin e tyre të arsimit universitar.</p> <p>Ev.2.Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës.  Ev.4.Rregullore e Programit të studimit Bachelor Menaxhim Marketing.  Ev.15.Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</p>




	<p><i>Ev.34.Rregullore e Departamentit Marketing.</i>  <i>Ev.37. Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.</i>  <i>Ev.95.Kritere pranimi bachelor dhe msc ne dep.e marketingut 2019-2020</i>  <i>Ev.134.Publikimi i Kritereve e Pranimi 2022-2023.</i></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Shtetasit shqiptarë, shqipëtarët jashtë kufijve shtetërorë, si dhe shtetasit e huaj kanë të drejtën të ndjekin studimet vetëm nëse përmbushin kriteret e përcaktuara nga MAS, statuti i UAMD dhe rregulloret përkatëse në lidhje me studimet e ciklit të parë.</p> <p><i>Ev.2.Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës.</i>  <i>Ev.4.Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i>  <i>Ev.15.Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.34.Rregullore e Departamentit Marketing.</i>  <i>Ev.37.Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.</i>  <i>Ev.95.Kritere pranimi bachelor dhe msc ne dep.e marketingut 2019-2020.</i>  <i>Ev.134.Publikimi i Kritereve e Pranimi 2022-2023.</i></p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtesa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimi në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e UAMD studentëve me arritje të lartë akademike u akordohen bursa studimi dhe përjashtohen nga tarifa e studimit sipas meritës së mesatares.</p> <p>Gjithashtu për kategori të veçanta të studentëve me aftësi ndryshe apo në nevojë aplikohen tarifa të reduktuara.</p> <p><i>Ev.2.Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës.</i>  <i>Ev.4.Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i>  <i>Ev.15.Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.34.Rregullore e Departamentit Marketing.</i>  <i>Ev.37.Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.</i>  <i>Ev.95.Kritere pranimi bachelor dhe msc ne dep.e marketingut 2019-2020.</i>  <i>Ev.133.Tabelen me Kuotat e miratuara per programet e Ciklit te pare dhe ciklit te dyte te studimeve.</i>  <i>Ev.134.Publikimi i Kritereve e Pranimi 2022-2023.</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>UAMD ka hartuar politika dhe procedura të qarta për të trajtuar çështjet si pranimi i studentëve të rinj, transferimi i studentëve nga një program në tjetrin, njohja e dijeve, vlerësimi i studentëve dhe diplomimi. Pranimi i kandidatëve bëhet konform udhëzimeve të MAS, kuotave të propozuara nga njësia bazë dhe kritereve të përcaktuara nga njësia kryesore e të miratuara në Senatin Akademik, ndërsa barazia dhe të drejtat e njëjta për studentët e programit të studimit garantohen nga rregulloret institucionale e të programit të studimit.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<b>Standardi V.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin janë të përcaktuara në Rregulloren e UAMD, Rregulloren e Fakultetit të Biznesit dhe Rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Departamenti Marketing, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Sekretaria mësimore vënë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve</p> <p>Ndihmë në procesin e infomimit të studentëve të ciklit të parë japin dhe pedagogët e departamentit Marketing të cilët asistojnë dhe orientojnë studentët gjatë periudhës së studimeve në Bachelor Menaxhim Marketing.</p> <p><i>Ev.4.Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i>  <i>Ev.15.Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.34.Rregullore e Departamentit Marketing.</i>  <i>Ev.37.Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.</i>  <i>Ev.95.Kritere pranimi bachelor dhe msc ne dep.e marketingut 2019-2020.</i>  <i>Ev.134.Publikimi i Kritereve e Pranimit 2022-2023.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>UAMD përmes Fakultetit të Biznesit, Departamentit Marketing orienton studentët në lidhje me përmbajtjen dhe organizimin e programit të studimit, kohëzgjatjen e studimeve në këtë program dhe afatin e përfundimit, kalendarin akademik, fillimin dhe mbarimin e vitit akademik, njohjen e kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesshme që ata mund të kenë kryer, sezonet e provimeve etj. Drejtuesi i Departamentit bashkë me stafin akademik të programit bëjnë pritjen e studentëve dhe prezantimin e programit mësimor në javën orientuese. Gjatë javës së orientimit realizohen takime për shpjegimin e sistemit të studimeve, rregulloreve dhe procedurave administrative të UAMD.</p> <p>Kriteret e procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme janë të unifikuara në nivel Institucioni dhe paraqiten në Rregulloren e UAMD, Rregulloren e Fakultetit të Biznesit dhe Rregulloren e programit të studimit.</p> <p><i>Ev.4.Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i>  <i>Ev.15.Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.34.Rregullore e Departamentit Marketing.</i></p>




	<p><i>Ev.37.Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu _Durrës.</i> <i>Ev.134.Publikimi i Kriteve e Pranimi 2022-2023.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve janë të unifikuara në nivel Institucioni dhe paraqiten në Rregulloren e UAMD, Rregulloren e Fakultetit të Biznesit dhe Rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Në rregulloret përkatëse paraqitet sistemi i vlerësimit; forma e vlerësimit; forma e kontrollit të dijeve; kushtet për hyrjen në provim; organizimin e provimeve; shpalljen e rezultateve; ankimimin dhe rishikimin e notës.</p> <p>Në syllabuset e secilës lëndë të programit Bachelor në Menaxhim Marketing ka informacion të detajuar lidhur me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve si vlerësimi i provimit të ndërmjetëm, vlerësimi i aktivizimit në seminare, detyrat e kursit dhe vlerësimi përfundimtar.</p> <p>Njohuritë e përfituara nga studenti kontrollohen dhe vlerësohen me pikë përmes një kombinimi të frekuentimit dhe aktivizimit të studentit gjatë orëve të mësimit në auditor, provimeve me shkrim, detyrave të kursit, që zhvillohen sipas afateve të caktuara në kalendarin akademik, të bëra publike nga Departamenti Marketing dhe janë të detyrueshme për zbatim si nga pedagogët ashtu dhe nga studentët.</p> <p><i>Ev.4.Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i> <i>Ev.15.Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i> <i>Ev.25.Rregullore e Detyrimeve Permbyllese cikli Bachelor.</i> <i>Ev.31.Syllabuset e Lëndëve BSc. MM.</i> <i>Ev.34 Rregullore e Departamentit Marketing.</i> <i>Ev.37.Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu _Durrës.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në lidhje me Detyrimet Përmbyllëse, ato organizohen në formën e një provimi përfundimtar kur studenti ka një mesatare nën notën 7, dhe punim diplome për studentët me mesatare mbi notën 7.</p> <p>Kriteret e punimit të diplomës janë të specifikuara në rregulloren e detyrimeve përmbyllëse dhe rregulloren e diplomimit dhe u bëhen të ditura studentëve përmes departamenti Marketing. Gjatë periudhës së përgatitjes së punimit të diplomës zhvillohen seancat përgatitore ku pedagogu udhëheq studentët për punimin e diplomës dhe përmbushjen e detyrimeve lidhur me diplomimin.</p> <p>Fazat kohore të dorëzimit dhe mbrojtjes së diplomës bëhen të ditura në fillim të çdo viti akademik.</p> <p><i>Ev.25.Rregullore e Detyrimeve Permbyllese cikli Bachelor (neni 2).</i> <i>Ev.38.Rregullore provimesh FB.</i> <i>Ev.67.Rregullore Diplomimi.</i> <i>Ev.68.Evidence komunikim student udheheqes diplome me email.</i></p>




	<p><i>Ev.70.Proçes-verbal i mbrojtjes së temës së diplomës Bachelor "Manaxhim Marketing.</i></p> <p><i>Ev.71.Diplomë dhe Suplement i Diplomës.</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Çdo fillim viti akademik UAMD organizon takime informuese me studentët, ku u jepen informacionet e nevojshme lidhur me organizimin dhe funksionimin e programeve të studimit. Pjesë e tyre është dhe Dita e Informimit të Maturantëve ku janë organizuar takime të hapura informuese në shkollat e mesme të përgjithshme dhe profesionale të Durrësit dhe Rretheve të tjera. (Ev.132)</p> <p>Gjithashtu faqja zyrtare online dhe rrjetet sociale japin informacion për të interesuarit mbi programet e studimit.</p> <p>Gjatë javës së pare orientuese studentët njihen me programin që do të ndjekin, strukturën dhe përmbajtjen e tij, mundësitë që ofron ky program studimi, rregullat për frekuentimin dhe vlerësimin, praktikën mësimore, dhe diplomimin.</p> <p><i>Ev.128.Publikime ne Rrjete sociale FB -Raundet e Regjistrimit.</i></p> <p><i>Ev.129.Publikime ne Rrjete sociale FB -Raundet e Regjistrimit.</i></p> <p><i>Ev.130. Promovimi ne faqen e departamentit.</i></p> <p><i>Ev.131.Promovim tek maturantet.</i></p> <p><i>Ev.132.Promovimi ne Rrethe -Broshura Promovimi i Programeve.</i></p> <p><i>Ev.123.Orientimi i studenteve Universiteti Aleksander Moisiu.</i></p> <p><i>Ev.135.Foto Java e Orientimit Viti i I.</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UAMD është i angazhuar në informimin e studentëve në lidhje me progresin e tyre akademik dhe procedurat për diplomim. Institucioni përmes organeve dhe rregulloreve përkatëse u mundëson informacion të plotë studentëve për planifikimin dhe ndjekjen e studimeve.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

**Standardi V.3**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë takimit, GVJ u informua se UAMD informon studentët nëpërmjet njoftimeve në faqen zyrtare web, njoftimet në ambientet e fakultetit, komunikimin direkt me strukturat përkatëse dhe pedagogët. Universiteti ka struktura të veçanta për pritjen, informimin e studentëve si Sekretaria mësimore dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni.</p> <p>Studentët informohen që në momentin e regjistrimit mbi organizimin, kohëzgjatjen dhe statusin e programit të studimit. Po kështu ata marrin informacion në javën e parë të fillimit të vitit të parë "Java orientuese".</p>

	<p>Departamenti Marketing është i angazhuar në çdo fillim semestri me anë të pedagogëve të departamentit të sigurojë informacion në lidhje me lëndët/modulet, kreditet, syllabusin përkatës, ngarkesën mësimore, frekuentimin dhe orët në auditor, vlerësimin, etj.</p> <p><i>Ev.4.Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i>  <i>Ev.15.Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.34.Rregullore e Departamentit Marketing.</i>  <i>Ev.123.Orientimi i studenteve Universiteti Aleksander Moisiu.</i>  <i>Ev.128.Publikime ne Rrjete sociale FB -Raundet e Regjistrimit.</i>  <i>Ev.130.Promovimi ne faqen e departamentit.</i>  <i>Ev.131.Promovim tek maturantet.</i>  <i>Ev.135.Foto Java e Orientimit Viti i I.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Me fillimin e semestrit, secili pedagog i programit Bachelor në Menaxhim Marketing bën publik informacionin mbi modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese, të pasqyruara në syllabusin e lëndës tek studentët. Gjithashtu në faqen web studentëve u jepet informacion i nevojshëm për programin e studimit, qoftë nëpërmejt guidës për studentët, planit mësimor, rregullores së programit të studimit.</p> <p><i>Ev.31.Syllabuset e Lëndëve BSc. MM.</i>  <i>Ev.46.Plani Mesimor Bsc. MM 2021-2024.</i>  <i>Ev.123.Orientimi i studenteve Universiteti Aleksander Moisiu.</i>  <i>Ev.128.Publikime ne Rrjete sociale FB -Raundet e Regjistrimit.</i>  <i>Ev.130. Promovimi ne faqen e departamentit.</i>  <i>Ev.135.Foto Java e Orientimit Viti i I.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>UAMD ka ngritur Zyrën e Karrierës dhe Alumni me qëllim të orientojë, inkurajojë dhe mbështesë studentët dhe të diplomuarit me mundësi për zhvillim personal dhe profesional përmes informimit, këshillimit, trajnimit dhe udhëzimit në karrierë. Bashkëpunimet me industrinë, biznesin, dhe institucionet mbështeten në marrëveshje të institucionalizuara dhe bëhen publike në faqen e web përmes njoftimeve për punësime, internship-e, trajnime për studentët. UAMD i ka dhënë prioritet organizimit të aktiviteteve të tilla si panairë të punës dhe takime e leksione të hapura me aktorë nga industria si veprimtari që synojnë të orientojnë studentët rreth mundësive për praktika profesionale në bashkëpunim me institucione partnere.</p> <p><i>Ev.13.Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.16.Marreveshjet e bashkepunimit Dep Marketingut.</i>  <i>Ev.18.Marreveshje Bashkepunimi UAMD.</i>  <i>Ev.51.Shoqata Alumni UAMD dhe Aktivitetet.</i>  <i>Ev.80.Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit _ Karrierës.</i></p>






	<p><i>Ev.83.Vendim_grupi i punes_paniri i punes dhe i karrieres.</i>  <i>Ev.84.Draft_Agjendë_panairi i punes dhe i karrieres 2022.</i>  <i>Ev.99.UAMD Udhezues nga Qendra e Karrieres dhe Alumni.</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Departamenti i Marketingut luan një rol të rëndësishëm në orientimin dhe këshillimin e studentëve të programit të studimit Bachelor në Menaxhim Marketing. Në fillim të çdo viti zhvillohet Java e Orientimit të Studentëve dhe mbahen takime informuese mbi programin e studimit, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të tij.</p> <p>Përmes faqes zyrtare të web studentët marrin informacion për orarin e mësimor, orarin e provimeve, strukturën mësimore, bibliotekën, rregulloret dhe procedurat e ndryshme të institucionit.</p> <p><i>Ev.89.Kalendari i funksionimit të Bibliotekës në fundjavë.</i>  <i>Ev.91.Memo e kalendarit të bibliotekës.</i>  <i>Ev.100.Rregullore Sekretarise mesimore.</i>  <i>Ev.101.Strategjia e Komunikimit – UAMD.</i>  <i>Ev.123.Orientimi i studenteve Universiteti Aleksander Moisiu.</i>  <i>Ev.130.Promovimi ne faqen e departamentit.</i>  <i>Ev.135.Foto Java e Orientimit Viti i I.</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Informacioni për studentët e programit të studimit Bachelor në Menaxhim Marketing mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm Pitagora që nga viti akademik 2019. Ky sistem garanton një menaxhim efikas të të dhënave të studentit dhe është lehtësisht i aksesueshëm prej tyre edhe në distancë nëpërmjet aksesit të krijuar nga përdorimi i “user name” dhe “password”, me të cilin studentët janë pajisur në momentin e regjistrimit në programin e studimit.</p> <p>UAMD ka në përdorim Sistemin ESSE, dhe sistemin AULA për administrim, dokumentim, ndjekje, raportim dhe shpërndarje të evidencave nga pedagogët, sekretaria mësimore për studentët.</p> <p><i>Ev.63.Sistemi PITAGORA (RASH).</i>  <i>Ev.64.Manual_Aula.</i>  <i>Ev.101.Strategjia e Komunikimit – UAMD.</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UAMD ndjek një politikë të informimit të vazhdueshëm të studentëve përmes njoftimevetë ndryshme në faqen zyrtare web, njoftimet në ambientet e fakultetit, komunikimin direkt me strukturat përkatëse dhe pedagogët.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;">X</p>

**Standardi V.4**  
**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Informacioni lidhur me statistikat vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor në Menaxhim Marketing” menaxhohet nga Sekretaria Mësimore e Fakultetit të Biznesit. Këto të dhëna ruhen në formë të shkruar (hard copy) dhe në formë elektronike në regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave sipas mënyrës së përcaktuar në udhëzimet përkatëse të MAS.</p> <p>Nëpërmjet Zyrës së Karrierës dhe Alumni në mënyrë periodike mbahen kontakte të vazhdueshme me ish-studentë me qëllim jo vetëm ndarjen e eksperiencave dhe arritjeve profesionale por edhe krijimin e urave efektive lidhëse midis universitetit e tregut të punës.</p> <p><i>Ev.17.Raport Vjetor UAMD 2020-2021.</i>  <i>Ev.65.Analiza Vjetore e Departamentit të Marketingut, 2021-2022.</i>  <i>Ev.100.Rregullore Sekretarise mesimore.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Nga takimi me sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se informacioni lidhur me ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në Menaxhim Marketing mbahet nga Sekretaria mësimore e Fakultetit të Biznesit.</p> <p>GVJ verifikoi statistikat për ecurinë e studentëve përgjatë këtyre tre viteve të fundit akademike dhe përfshijnë të dhëna mbi numrin e studentëve sipas viteve të studimit, nota mesatare e hyrjes dhe e daljes, studentë të transferuar sipas viteve akademike të programit.</p> <p><i>Ev.17.Raport Vjetor UAMD 2020-2021.</i>  <i>Ev.65.Analiza Vjetore e Departamentit të Marketingut, 2021-2022.</i>  <i>Ev.100.Rregullore Sekretarise mesimore.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Sekretaria mësimore menaxhon të dhënat e studentëve për programin e studimit dhe informacioni mbahet në databazën e sekretarisë. Po ashtu, sekretaria përpilon regjistrat, të cilët janë specifik për çdo lëndë, si dokument zyrtar që evidenton dhe vërteton zhvillimin e orës së mësimit nga pedagogu dhe frekuentimin e orës së mësimit nga studenti dhe evidenton kreditet që ai ka siguruar në atë lëndë si dhe zhvillimin e orëve dhe tematikave të parashikuara sipas syllabusit të lëndës.</p>
	<p>Vlerësimi i studentëve pasqyrohet në procesverbale të cilat sekretaria mësimore i vë në dispozicion pedagogut të lëndës në sezonin e provimeve, të cilat depozitohen dhe ruhen sërish në sekretari. Të dhënat</p>




	<p>e studentëve janë të pasqyruara në Regjistrin themeltar, në Regjistrin e rezultateve akademike të studentit.</p> <p>Të dhënat statistikore mbi procesin mësimor të studentëve të përmendura me lart menaxhohen nëpërmjet sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit duke ruajtur konfidencialitetin.</p> <p><i>Ev.17.Raport Vjetor UAMD 2020-2021.</i>  <i>Ev.63.Sistemi PITAGORA (RASH).</i>  <i>Ev.64.Manual_Aula.</i>  <i>Ev.65.Analiza Vjetore e Departamentit të Marketingut, 2021-2022.</i>  <i>Ev.72.Rregullorja për Qarkullimin dhe Arshivimin e dokumentacionit të brendshëm në UAMD.</i>  <i>Ev.100.Rregullore Sekretarise mesimore.</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>UAMD mbikëqyr dhe dokumenton në mënyrë sistematike të dhëna analitike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre. Këto raporte janë pjesë e analizës vjetore që nis nga stafi akademik, departamentet, fakulteti dhe institucioni.</p> <p>Gjurmimi i punësimit të studentëve evidentohet përmes një regjistri përkatës që mbahet dhe përditësohet nga specialisti karrierës dhe alumni.</p> <p><i>Ev.17.Raport Vjetor UAMD 2020-2021.</i>  <i>Ev.65.Analiza Vjetore e Departamentit të Marketingut, 2021-2022.</i>  <i>Ev.102.RVB e fakultetit te biznesit 2020-2021.</i>  <i>Ev.80.Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit _ Karrierës.</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>				
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se UAMD zbaton politika dhe praktika të mbledhjes dhe administrimit të të dhënave për të përmirësuar eksperiencën e studentëve dhe performancën e institucionit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

**Standardi V.5**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e</p>	<p>Përfshirja e studentëve të UAMD në një sërë strukturash vendimmarrëse si Senati Akademik, Këshilli i Fakultetit, Komisioni i Përherëshëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, Komisioni i Përherëshëm i</p>

<p>këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Kurrikulës, Këshilli i Etikës dhe në Këshillat e studentëve rregullohet nga Statuti i UAMD dhe Rregullorja UAMD, Regullaroja e Fakultetit të Biznesit.</p> <p><i>Ev.2.Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu.</i>  <i>Ev.4.Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i>  <i>Ev.15.Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.37.Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Bazuar në Statutin, UAMD mbështet krijimin e Këshillave dhe Qeverisë Studentore dhe financon aktivitetet e organizuara prej tyre.</p> <p>Studentët e programit Bachelor Menaxhim Marketing kanë mundësi që nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në organet drejtuese të shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet si për planet mësimore dhe programet e studimeve, rregulloret e studimeve, apo çështje që lidhen me jetën sociale studentore dhe aktivitetet shkencore.</p> <p>Pjesë e vlerësimit të cilësisë së UAMD është pyetësori online për studentët nga Njësia Kryesore për vlerësimin e stafit administrativ dhe akademik dhe pyetësori për studentët Bsc. MM mbi përmirësimin e metodikës së mësimdhënies.</p> <p><i>Ev.2.Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu.</i>  <i>Ev.4.Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i>  <i>Ev.15.Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.37.Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.</i>  <i>Ev.104.Pyetësor online për studentët nga Njësia Kryesore për vlerësimin e stafit administrativ dhe akademik.</i>  <i>Ev.105.Raport vlerësimi për stafin akademik nga studentët shembull.</i>  <i>Ev.106.Pyetësor per studentet Bsc MM mbi permisimin e metodikes se mesimdhënies.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>NJSBC në fund të çdo semestri organizon dhe ndjek zhvillimin e Anketimit Studentor për cilësinë e mësimdhënies, për çdo program studimi. Përfundimet e marra nga ky anketim janë objekt diskutimi dhe reflektimi në njësinë bazë dhe përfaqësojnë kontributin e studentëve gjatë procesit të rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit. Të dhënat e këtyre raporteve gjithashtu përbëjnë një bazë për hartimin e raporteve të analizës mësimore në nivel departamenti dhe fakulteti.</p> <p>Gjithashtu,UAMD i kushton vëmendje propozimeve të studentëve në organet drejtuese si Senati Akademik, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës, Këshilli i Etikës.</p>
	<p><i>Ev.2.Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu.</i>  <i>Ev.4.Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Marketing.</i>  <i>Ev.15.Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i></p>

	<p><i>Ev.37.Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.</i>  <i>Ev.104.Pyetësor online për studentët nga Njësia Kryesore për vlerësimin e stafit administrativ dhe akademik.</i>  <i>Ev.105.Raport vlerësimi për stafin akademik nga studentët shembull.</i>  <i>Ev.106.Pyetësor per studentet Bsc MM mbi permisimin e metodikes se mesimdhenies.</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Rregullorja e UAMD dhe Rregullorja e Fakultetit i garanton studentit të drejtën e ankimit, në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat procedurale gjatë zhvillimit të provimit ose nuk është dakord me vlerësimin e bërë. Kjo ankesë shqyrtohet nga Dekani, i cili mund të thërrasë për sqarime drejtuesin e njësisë bazë, komisionin e provimit dhe vetë studentin. Kur ankesa është e drejtë, Dekani e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit për të cilin studenti është ankuar dhe vendos që studenti të rivlerësohet ose të rijapë provimin me anëtarë të tjerë. Gjithashtu studentëve u mundësohet të japin mendim mbi ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve gjatë plotësimit të pyetësorëve për lëndët, në fund të semestrit.</p> <p><i>Ev.15.Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.37.Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.</i>  <i>Ev.104.Pyetësor online për studentët nga Njësia Kryesore për vlerësimin e stafit administrativ dhe akademik.</i>  <i>Ev.105.Raport vlerësimi për stafin akademik nga studentët shembull.</i>  <i>Ev.106.Pyetësor per studentet Bsc MM mbi permisimin e metodikes se mesimdhenies.</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>UAMD përmes organeve përfaqësuese mbështet studentët të shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet si për planet mësimore dhe programet e studimeve, rregulloret e studimeve, apo çështje që lidhen me jetën sociale studentore dhe aktivitetet shkencore.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<p><b>Standardi V.6</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</b></p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të</p>	<p>UAMD ka struktura të veçanta për pritjen, informimin dhe pranimin e studentëve. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni dhe Sekretaria mësimore janë struktura ndihmuese për informimin e studentëve.</p> <p>Disa nga njësitë e informimit për shërbimet ndaj studentëve janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Departamenti</i>, ku studenti merr informacione mbi organizimin e mësimit, aktivitete të ndryshme, diplomimin, procesin mësimor;</li> </ul>

<p>posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Sekretaria mësimore</i> ku studenti merr shërbime, informohet mbi ecurinë dhe progresin e tij në këtë program studimi;</li> <li>- <i>Zyra e karrierës dhe Alumni</i> ku studentët marrin informacion mbi trajnimet, praktikat dhe ofertat e punësimit.</li> </ul> <p>Në Rregulloren Institucionale përcaktohen mënyrat e komunikimit të informacionit tek studentët në lidhje me programet e studimit, procesin mësimor, rregulloret e brendshme, vendimet e rëndësishme të marra nga Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Rektorati dhe Dekanati të lidhura me studentët. Gjatë gjithë periudhës së studimeve studentit i jepet mundësia të komunikojë me pedagogun, jo vetëm në auditor por edhe nëpërmjet postës elektronike dhe sistemit të menaxhimit të informacionit të brendshëm.</p> <p><i>Ev.15.Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Ev.37.Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.</i>  <i>Ev.63.Sistemi PITAGORA (RASH).</i>  <i>Ev.64.Manual_Aula.</i>  <i>Ev.51.Shoqata Alumni UAMD dhe Aktivitetet.</i>  <i>Ev.80.Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit _Karrierës.</i>  <i>Ev.99.UAMD Udhezues nga Qendra e Karrieres dhe Alumni.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e Karrierës dhe Alumn-it shërben si urë lidhëse midis studentëve dhe tregut të punës, me qëllim promovimin e studentëve dhe kërkimin e mundësive të reja të punësimit. Zyra e Karrierës është në shërbim të studentëve duke ofruar informacion në lidhje me mundësi punësimi dhe asistencë për kryerjen e aplikimeve.</p> <p>Zyra e Karrierës orienton studentët në drejtim të njohjes të tregut të punës dhe procesit të punësimit si përgatitja e CV, shkrimi i letrës së interesit, planifikimi dhe ndjekja e intervistës të punës.</p> <p>Qendra Alumni mban kontakte me studentët e diplomuar duke krijuar një bazë të dhënash lidhur me punësimin e tyre, si rezultat i gjurmimit të përditësuar.</p> <p>UAMD ka mbështetur aktivitete të përbashkëta me industrinë të zhvilluara nga Qendra e Karrierës në bashkëpunim me njësitë bazë si Panairin e Punës dhe Karrierës.</p> <p><i>Ev.51.Shoqata Alumni UAMD dhe Aktivitetet.</i>  <i>Ev.80.Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit _Karrierës.</i>  <i>Ev.84.Draft_Agjendë_panairi i punes dhe i karrieres 2022.</i>  <i>Ev.99.UAMD Udhezues nga Qendra e Karrieres dhe Alumni.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna</p>	<p>Zyra e Karrierës dhe Alumn-it është një strukturë e ngritur e cila funksionon në bazë të statutit të UAMD që ka si objektivi të punës së saj</p>

mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	<p>mbështetjen e studentëve përgjatë gjithë rrugëtimit të tyre akademik dhe më tej përgjatë viteve të punësimit.</p> <p>Zyra e Karrierës dhe Alumn-it përmes njoftimeve në web dhe përmes materialeve informuese të afishuara në mjediset e universitetit njofton vazhdimisht studentët për mundësi për aplikime në lidhje me punësimin e tyre</p> <p>Rrjeti “Alumni” synon mbështetjen e studentëve dhe të diplomuarve në UAMD për të thelluar njohuritë e tyre profesionale; ndihmon në rritjen e tyre në karrierë; përfshirjen në projekte dhe edukim të vazhduar.</p> <p><i>Ev.51.Shoqata Alumni UAMD dhe Aktivitetet.</i>  <i>Ev.80.Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit _ Karrierës.</i>  <i>Ev.84.Draft_Agjendë_panairi i punes dhe i karrieres 2022.</i>  <i>Ev.99.UAMD Udhezues nga Qendra e Karrieres dhe Alumni.</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	GVJ gjatë takimi në institucion konstatoi angazhimin e UAMD për të përmirësuar përvojën e studentëve dhe për të siguruar se ata kanë mundësi për të adresuar çdo problem ose ankimim gjatë rrugëtimit të tyre të arsimit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X
---	----------------	-----------------------	----------------------	----------------------------

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi VI.1</b> Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri I.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve. lëndëve/moduleve.	Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. UAMD e targeton cilësinë në mësimdhënie si një tipar të rëndësishëm të institucionit. IAL mbështetet në strategji si “Plani Strategjik i Zhvillimit 2020-2025, në vizionin e të cilit përmendet se “Universiteti “Aleksandër Moisiu”, synon të karakterizohet gjithnjë e më shumë si një qendër akademike cilësore dhe inovatore, si një realitet i ri dhe dinamik duke ofruar një alternativë serioze në panoramën e Arsimit të Lartë., në këtë strategji përfshihen një sërë objektivash dhe plan




	<p>aktivitetesh. Rishikimi i programeve mësimore, është një prej tyre, jo vetëm për të sanksionuar këto aktivitete por edhe për t'iu përgjigjur nevojave të tregut. Në planin strategjik përmendet dhe fokusi në rajon për trajnimin e specialistëve në sektorët e turizmit, detarisë, menaxhimit dhe shërbimeve financiare. Po kështu IAL i kushton një rëndësi të vecantë përdorimit me efektivitet të marrëveshjeve ekzistuese mbi praktikën e studentëve dhe arritja e marrëveshjeve të reja që synojnë krijimin e lidhjeve reale me tregun e punës me qëllim punësimin e mundshëm të tyre si edhe krijimi i një mekanizmi ndërlidhës efektiv e të drejtpërdrejtë të Zyrës së Karrierës dhe Alumni me departamentet e ndryshme të universitetit. Ofrimi i lëndëve në gjuhë angleze, është një tjetër faktor që tregon përpjekjen e UAMD për të rritur mobilitetin hyrës dhe dalës të studentëve.</p> <p><i>Ev.1.Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025.</i>  <i>Ev.3.Plani Strategjik për Departamentin e Marketingut-2021 – 2025.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>UAMD ka struktura bazë për kontrollin dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies: Komisionin e Sigurimit të Cilësisë dhe Njësinë e Sigurimit të Cilësisë (<i>Statuti UAMD, neni 77-81</i>).</p> <p>Në nivel Institucional strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë;</li> <li>• Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë/Koordinatori Institucional pranë ASCAL;</li> <li>• Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë.</li> </ul> <p>Në nivel Fakulteti përgjegjës për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve (NjBSC Fakulteti);</li> <li>- Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program (GVB.Bch. /GVB.MP. /GVB.Msc.);</li> <li>- Koordinatorët e Programeve (Ko.Bch. / Ko.MP / Ko.Msc.).</li> </ul> <p>Zyra e Sigurimit të Cilësisë është përgjegjëse për sigurimin e cilësisë dhe përmirësimin e këtij niveli duke përdorur një sërë mekanizmesh si: hartimit të politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, të cilat miratohen në Senat Akademik; vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore; në fund të semestrit, para sezonit të provimeve, organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi; realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimin të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga institucioni i arsimit të lartë; harton dhe i propozon Senatit standardet për sigurimin e cilësisë</p>



në përputhje me Kodin e Cilësisë; prezanton raportin vjetor të vlerësimit të brendshëm të cilësisë së UAMD-së në Senatin Akademik, i cili miraton raportin vjetor përfundimtar të vlerësimit të brendshëm të cilësisë në UAMD.

IAL, më konkretisht Zyra e Sigurimit të Cilësisë, realizon vlerësimet periodike të studentëve për pedagogun, të cilat kryhen nëpërmjet plotësimit të një formulari në formë anonime. Duke ofruar sugjerime, studentët ndihmojnë jo vetëm në vlerësimin e cilësisë së punës së pedagogut, por edhe përfshihen në përmirësimin e programit të studimit.

Vlerësimet e lartpërmendura të pedagogëve i dërgohen drejtuesit të departamentit, i cili ia dërgon Dekanit dhe me pas Rektoratit. Në paketën e cilësisë paraqitet dhe relacion i rektorit për stafin që ka marrë një vlerësim të ulët. Në këtë relacion titullari i UAMD kërkon nga njësia bazë të dëshmojë për masat e marra në raport me stafin dhe menaxhimin e rezultateve jo të mira të stafit mësimdhënës.

Paketa e vlerësimit të cilësisë përbëhet nga:

1. Pyetësor online për studentët nga Njësia Kryesore për vlerësimin e stafit administrativ dhe akademik;
2. Pyetësor për studentët Bsc. MM mbi përmirësimin e metodikës së mësimdhënies;
3. Model pyetësori për vlerësimin e stafit akademik;
4. Formular vetëvlerësimi.

*Megjithëse IAL bën përpjekje të vazhdueshme për të përmirësuar cilësinë, GVJ rekomandon një analizë të rezultateve si dhe masat që merr IAL në raport me ato rezultate.*

*Ev.2.Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës.*

*Ev.103.Memo-Pergjigje Rektoratit në lidhje me vlerësimin e stafit akademik të Departamentit Marketing.*

*Ev.104.Pyetësor online për studentët nga Njësia Kryesore për vlerësimin e stafit administrativ dhe akademik.*

*Ev.105.Raport vlerësimi për stafin akademik nga studentët shembull.*

*Ev.106.Pyetësor për studentet Bsc MM mbi përmirësimin e metodikës së mësimdhënies.*

*Ev.107.Relacion i NjBSC mbi realizimin e mesimdhënies online dhe pyetësor .*

*Ev.108.Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD.*

*Ev.109.Model pyetësori për vlerësimin e stafit akademik.*

*Ev.118.Analiza e rezultateve të anketimit për studentët, stafin akademik dhe administrativ).*

*Ev.10.Formular vetëvlerësimi.*

	<i>Ev.111. Urdheri i Rektorit per ngritjen e NjSBC.</i>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Mbështetur në Statut, në rregulloret e FB dhe Departamentit të Marketingut studenti është në qendër. Në planin strategjik të Departamentit të Menaxhimit 2020-2025, paraqiten të gjitha aktivitetet që kanë në fokus studentin si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ofrimi i konsultimeve të rregullta përmes takimeve në orare të caktuara dhe postës elektronike;</li> <li>• Identifikimi i problemeve të studentëve dhe orientimin për ndërtimin e strategjive për zgjidhjen e tyre;</li> <li>• Identifikimi i pritshmërive dhe interesave të tyre mbi tregun e punës dhe mundësinë e vijimit të studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë, drejtpërdrejt ose pa shpëputje nga puna;</li> <li>• Informim në çdo kohë i studentëve përmes rrjeteve sociale të fakultetit, departamentit, si dhe faqes së internetit mbi veprimtarinë akademike të departamentit;</li> <li>• Organizimi i “ditëve të informimit” dhe këshillimit, duke filluar me të interesuarit për të ndjekur studimet në fushën e marketingut dhe orientim karriere për studentët në prag të diplomimit;</li> <li>• Bashkëpunim me Zyrën e Alumnit të UAMD për shkëmbime të dhënash;</li> <li>• Zgjerimi i shërbimit të karrierës dhe zhvillimit profesional për studentët, përfshirë intervistat, intership-et, krijimin e rrjeteve dhe ofrimin e mundësive të ndryshme;</li> <li>• Sigurimi i mundësive të gjera të karrierës për të diplomuar studentë të gatshëm për tregun e punës;</li> <li>• Mbështetje e ofruar pas-diplomimit për alumnit, përfshirë angazhimin në fakultet dhe mundësive për suport të karrierës së tyre;</li> <li>• Seanca trajnimesh për të orientuar studentët që diplomohen për tregun e punës, për hartimin e CV-ve, teknikat e aplikimit për punë etj.</li> </ul> <p><i>(Ev.3. Plani Strategjik per Departamentin e Marketingut-2021-2025).</i></p> <p>Po kështu në paketën e dokumentave të tjera të IAL si: Rregullorja e Fakultetit të Biznesit (neni 88 për këshillat e studentëve), Statuti UAMD neni 90 mbi këshillat e studentëve. NJSBC në rang fakulteti, etj, sanksionohet e drejta e studentëve për t’u përfaqësuar dhe patur rol në vendimarrje. Pjesëmarrja e studentëve në komisione, në Senat në grupet e vlerësimit të brendshëm të programeve është mundësi e drejtpërdrejtë për të ndikuar në rishikimin e përmirësimit të programeve. Pjesë e rëndësishme e pjesëmarrjes së studentëve në vlerësimin e procesit akademik është dhe zhvillimi i procesit të vlerësimit të lëndës, që krijon mundësi e analizave të mëtejshme në</p>

	<p>terma të përmbajtjes së lëndës, por dhe mënyrës së zhvillimit të saj nga pedagogu, si dhe në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të kurrikulës. Nga takimi i GVJ me studentët që ndjekin programin e studimit Menaxhim Marketing, studentët deklaruan se plotësojnë 2 pyetësorë një për IAL në përgjithësi dhe një pyetësor të përveçëm për secilën lëndë. Ata u shprehën se kanë mundësi të shprehen për përmirësime të programit të studimit te seksioni i sugjerimeve. Studentët gjithashtu pohuan që nuk kanë një forum të veçantë komunikimi ku të shprehin kërkesat ndaj pedagogëve por ata i drejtohen përgjegjësit të departamentit nëpërmjet mailit. <b>GVJ sugjeron që njësia kryesore duhet të bëjë më shumë përpjekje për të përfshirë studentët në mbledhjet e departamentit.</b></p> <p><i>Ev.2.Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës.</i>  <i>Ev.3.Plani Strategjik per Departamentin e Marketingut-2021 – 2025.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Departamenti i Marketingut/FB përdor mënyra periodike vlerësimi për përmirësimin e mësimdhënies nga instanca të ndryshme të cilat mund të përmbledhen në vlerësimin nga Drejtuesi i Departamentit, përgjegjës për organizimin e punës didaktike dhe zhvillimin strategjik të departamentit nëpërmjet analizave vjetore. Ky proces kryhet nëpërmjet analizave periodike të personelit akademik, kontrollit të cilësisë së syllabuseve, harmonizimit të ngarkesës së stafit akademik, ndihmës që i ofrohet stafit të ri, trajnimit për përgatitjen e kurrikulave akademike, vlerësimit të performancës së stafit akademik, etj. Po kështu në nivel institucional në nenin 15 të Rregullores për funksionimin dhe organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë paraqiten treguesit kyç të performancës si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• ecuria e studentëve dhe nivelet e suksesit;</li> <li>• mundësitë e punësimit të të diplomuarve;</li> <li>• profilin e popullatës studentore;</li> <li>• raportin pedagog/studentë;</li> <li>• plotësimi i kërkesave të studentëve me programet e tyre;</li> <li>• efektivitetin e pedagogëve;</li> <li>• koston e burimeve të mësimnxënies dhe disponueshmërinë e tyre;</li> <li>• monitorimin e situatës së punësimit të të diplomuarve;</li> <li>• nivelin e largimit/transferimit të studentëve ;</li> <li>• numrin i stafit dhe studentëve që pranohen dhe largohen;</li> <li>• treguesit kyç të performancës së institucionit dhe elementë të ngjashëm.</li> </ul> <p>Në analizën vjetore të Departamentit të Marketingut paraqiten aspekte të vlerësimit të cilësisë së programit të studimit si dhe aspekteve të tjera që lidhen me punën mësimore dhe kërkimore të stafit. Analizat bëhen publike në të gjithë pjesëtarët e departamentit dhe dorëzohen më pas në</p>




	<p>Dekanat, ky i fundit bën analizën përmbledhëse për të gjitha programet e studimit që ofrohen nga njësia kryesore. Po kështu, NJSBC dërgon vlerësimet e instrumentave të përdorur të njësia bazë e cila më pas ia komunikon stafit në mënyrë individuale.</p> <p><i>Ev.21.Dep Marketingut Analiza Vjetore 2019-2020.</i>  <i>Ev.108.Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD.</i>  <i>Ev.2.Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës.</i>  <i>Ev.3.Plani Strategjik per Departamentin e Marketingut-2021 – 2025.</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizitës në IAL vlerëson se nuk gjeti mekanizma të promovimit të praktikave të mira të institucionalizuara. Megjithatë, nga takimi me stafin, vihet re pjesëmarrje e konsiderueshme në mobilitete. Nga takimi me zyrën e projekteve u evidentua që ndërkombëtarizimi është një pikë e fortë e IAL. Sipas kësaj zyre UAMD tashmë ka firmosur 70 marrëveshje Erasmus. Duke i ofruar mundësinë stafit akademik të përmirësojë kapacitetet e veta nëpërmjet shkëmbimeve.</p> <p><i>Vizita në Institucion, takimi i GVJ me stafin e zyrës së projekteve.</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ vlerëson që IAL ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit. Megjithëse IAL bën përpjekje të vazhdueshme për të përmirësuar cilësinë, GVJ rekomandon një analizë të rezultateve si dhe masat që merr IAL në raport me ato rezultate. GVJ sugjeron që njësia kryesore duhet të bëjë më shumë përpjekje për të përfshirë studentët në mbledhjet e departamentit.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p><b>Standardi VI.2</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Sikurse është evidentuar edhe më lart, në UAMD funksionojnë Njësitë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në nivel IAL si dhe në nivel të njësisë kryesore. Këto njësi krijojnë “Strukturën e Cilësisë” dhe hartojnë raporte për veprimtarinë dhe për iniciativat që lidhen me sigurimin e cilësisë. Funksionimi i tyre është i rregulluar nga Statuti i UAMD, në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të lartë si dhe Rregullorja e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë në UAMD. NJSBC e fakultetit përpilon dhe harton raporte në lidhje me respektimin e standardeve dhe kriterëve të cilësisë mbi bazën e një metodologjie të përcaktuar ngë në rregulloren e NJSBC.</p>

	<p><i>Ev.2.Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës.</i>  <i>Ev.108.Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Sigurimi i brendshëm i cilësisë menaxhohet nga Zyra e Cilësisë që është pjesë e Drejtorisë së Kurrikulave dhe Standarteve të UAMD-së. Kjo zyrë në bashkëpunim me Komisionin e Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë të UAMD-së, me NJSBC-të në nivel fakultesh ka për qëllim kryesor të kontrollojë veprimtarinë e sigurimit të cilësisë në UAMD dhe të garantojë zbatimin e kriterëve të cilësisë në IAL sipas Kodit të Cilësisë. NJSBC në bashkëpunim me drejtuesit e njësive aplikon, koordinon dhe finalizon të gjithë procedurën e akreditimeve institucionale. Në nenin 9 të Rregullores së Sistemit të Brendshëm të Cilësisë, paraqitet që NjBSC në nivel institucional duhet të gjenerojë një dokument bazë për vizitat në terren të agjencisë së vlerësimit të jashtëm (ASCAL) për çështje të monitorimit dhe akreditimit institucional dhe të programeve të studimit. Gjithashtu, IAL angazhohet në trajnimin dhe zhvillimin profesional për çështjet e “cilësisë”, si dhe kompetencave të tjera funksionale të stafit akademik dhe atij administrativ.</p> <p><i>Ev.108. Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Strukturat e sigurimit të cilësisë Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të cilësisë dhe NJSBC funksionojnë në zbatim të ligjit për arsimin e lartë, statutin e UAMD-së dhe rregulloret përkatëse të harmonizuara me Rregulloren e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD. Sigurimi i brendshëm i cilësisë menaxhohet nga Zyra e Cilësisë që është pjesë e Drejtorisë së Kurrikulave dhe Standarteve të UAMD-së. Kjo zyrë në bashkëpunim me Komisionin e Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë të IAL-së, me NJSBC-të në nivel fakultetesh ka për qëllim kryesor të kontrollojë veprimtarinë e sigurimit të cilësisë në UAMD dhe të garantojë zbatimin e kriterëve të cilësisë në IAL sipas Kodit të Cilësisë. NJSBC në bashkëpunim me drejtuesit e njësive aplikon, koordinon dhe finalizon të gjithë procedurën e akreditimeve institucionale. Vlerësimi i jashtëm menaxhohet nga ASCAL.</p> <p><i>Ev.2.Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës.</i>  <i>Ev.103.Memo-Pergjigje Rektoratit në lidhje me vlerësimin e stafit akademik të Departamentit Marketing.</i>  <i>Ev.104.Pyetesor online për studentët nga Njësia Kryesore për vlerësimin e stafit administrativ dhe akademik.</i>  <i>Ev.105.Raport vlerësimi për stafin akademik nga studentët shembull..</i>  <i>Ev.106.Pyetesor per studentet Bsc MM mbi permisimin e metodikes se mesimdhënies.</i></p>
	<p><i>Ev.107.Relacion i NjBSC mbi realizimin e mesimdhënies online dhe pyetesori.</i>  <i>Ev.108.Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD.</i>  <i>Ev.109.Model pyetsori për vlerësimin e stafit akademik.</i></p>

	<i>Ev.110. Formular vëtvlerësimi.</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	<p>Sikurse është përmendur më sipër, UAMD ka hartuar planin strategjik të zhvillimit në nivel IAL-je dhe në nivel njësie bazë. Megjithëse në këto plane strategjike nuk vihen re objektiva specifike, tregues të matshëm dhe aktivitete të parashikuara, GVJ vlerëson që IAL ka krijuar një praktikë të informimit të të gjithë palëve të interesuara për rëndësinë e procesit të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë.</p> <p>Kështu, në Nenin 10 të rregullores një aspekt i rëndësishëm është paraqitja e funksioneve të koordinatorit të programit të studimit i cili ka një rol kyç në sigurimin e cilësisë së programeve akademike në UAMD. Në bashkëpunim me koordinatorin e departamentit për kërkimin shkencor, përgatit një raport vjetor dhe kur kërkohet nga NjBSC-ja gjatë një procesi akreditimi, mbi veprimtarinë kërkimore- shkencore duke vlerësuar: a) Numrin e publikimeve në pesë vitet e fundit të stafit akademik të angazhuar në departamentin ofruar të programit. b) Numrin e citimeve nga autorët e huaj (duke u bazuar në databazat e citimeve dhe faktorit të impaktit) të artikujve të publikuar nga stafi akademik në departamentin ofruar të programit. c) Numrin e projekteve të propozuara dhe realizuara nga departamenti dhe/ose stafi përbërës i tij. d) Numrin e konferencave dhe aktiviteteve shkencore të organizuara nga departamenti dhe/ose fakulteti, që kanë në fokus tematikat e programit të ofruar.</p> <p><i>Ev.1.Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025.</i>  <i>Ev.3.Plani Strategjik për Departamentin e Marketingut-2021 – 2025.</i>  <i>Ev.108.Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD.</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<i>IAL disponon akte normative dhe rregullatore në nivel IAL-je, të cilat ndihmojnë në ndërgjegjësimin dhe operacionalizimin e monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi VI.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësie të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e	Në përfundim të çdo viti akademik nga rektorati kërkohet hartimi i raporteve në nivel departamenti dhe fakulteti, ku përshkruhen të gjitha aktivitetet e kryera për përmbushjen e këtyre të mësimdhënies, cilësisë së tyre dhe ato të kërkimit shkencor. Po kështu kryhet vlerësimi i stafit akademik në lidhje me realizimin e objektivave të marra, si edhe hartohet një plan veprimi për të mundësuar realizimin e tyre në të ardhmen. Ky plan veprimi përdoret në vitet në vijim edhe bëhet pjesë e

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

78

<p>arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>objektivave që duhet të përmbushin pedagogët apo departamentet, me objektivat dhe indikatorë specifikë për arritjen e tyre, objektivat janë përmendur më sipër, bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga IAL. GVJ vlerëson si pozitive raportin e ecurisë së departamentit në përputhje me treguesit e vendosur nga metodologjia e NJSBC-së.</p> <p>Të gjitha raportet e hartuara kombinohen në raportin përfundimtar institucional, i cili miratohet në Senat dhe i dërgohet MASR. I gjithë ky proces dokumentohet në të gjitha hapat e tij, për të siguruar transparencën e nevojshme dhe një proces sa me gjithëpërfshirës për të promovuar praktikatat pozitive. Si u përmend më lart, nga vlerësimi i analizave mësimore kërkimore evidenton tregues konkret cilësore sa i përket, kërkimit shkencor, projekteve dhe ndërkombëtarizimit.</p> <p><i>Ev.1.Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025.</i>  <i>Ev.3.Plani Strategjik per Departamentin e Marketingut-2021 – 2025.</i>  <i>Ev.108.Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD.</i>  <i>Ev.21.Dep Marketingut Analiza Vjetore 2019-2020.</i>  <i>Ev.65.Analiza Vjetore e Departamentit të Marketingut, 2021-2022.</i>  <i>Ev.115.Raporti-i-Vetevleresimit 2019-2020 NJSBC.</i>  <i>Ev.52.Strategjia e nderkombetarizimit UAMD.</i>  <i>Ev.116.RVB e fakultetit te biznesit 2020-2021.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Në evidencat dhe dokumentat strategjike të cituar më sipër, IAL ka paraqitur në mënyrë specifike objektivat në lidhje me mësimdhënien dhe përmirësimin e saj si indikator vlerësimi i programit nga brenda dhe jashtë nëpërmjet ASCAL, si dhe në RVB gjithashtu citohet vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm si një metodologji e strukturuar për të marrë masa në lidhje me promovimin dhe adresimin e gjetjeve. <i>Megjithatë, GVJ do vlerësonte nëse IAL do të kishte dëshmuar një praktikë të marrjes parasysh të rekomandimeve që i janë bërë gjatë akreditimit të fundit.</i></p> <p><i>Ev.21. Dep Marketingut Analiza Vjetore 2019-2020.</i>  <i>Ev.65. Analiza Vjetore e Departamentit të Marketingut, 2021-2022.</i>  <i>Ev.115. Raporti-i-Vetevleresimit 2019-2020 NJSBC.</i>  <i>Ev.116. RVB e fakultetit te biznesit 2020-2021.</i>  <i>Ev.108. Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime</p>	<p>Sikurse u përmend më sipër, në nivel IAL-je është hartuar nga Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Cilësisë në rang universiteti, dhe është miratuar nga Senati paketa e instrumenteve matës të cilësisë në UAMD. Më sipër janë detajuar elementët e vlerësimit. Gjithashtu GVJ vlerëson që raportet duhet të paraqesin jo vetëm narrativën e rezultateve por edhe një reflektim të përmirësimit mbi bazën e gjetjeve.</p> <p><b><i>GVJ rekomandon konsolidimin e këtij raporti si mundësi për evidentimin e gjetjeve për përmirësimin e mëtejshëm të programit të studimit.</i></b></p>

<p>ndërinstitucionale apo kombëtare. si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p><i>Po kështu, në dokumentacion nuk evidentohen praktika si vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, vlerësime të tjera të studentëve dhe jo vetëm intervista e strukturuar psh fokus grupet.</i></p> <p><i>Ev.115. Raporti-i-Vetevleresimit 2019-2020 NJSBC.</i>  <i>Ev.116. RVB e fakultetit te biznesit 2020-2021.</i>  <i>RVB Bsc.Menaxhim Marketing.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi. si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Sikurse u përmend edhe më sipër, nga IAL është hartuar paketa e cilësisë. Paketa e vlerësimit të cilësisë e përbërë nga 1.Pyetësor online për studentët nga Njësia Kryesore për vlerësimin e stafit administrativ dhe akademik; 2.Pyetësor për studentët Bsc MM mbi përmirësimin e metodikës së mësimdhënies; 3.Model pyetësori për vlerësimin e stafit akademik; 4.Formular vetvlerësimi. <b><i>Megjithëse IAL bën përpjekje të vazhdueshme për të përmirësuar cilësinë, GVJ rekomandon një analizë të rezultateve si dhe masat që merr IAL në raport me ato rezultate. Si dhe GVJ rekomandon pasurimin e paketës së monitorimit në drejtim të vlerësimit të cilësisë që targeton psh fokus grupet.</i></b></p> <p>Zyra e Karrierës dhe Alumni e UAMD mban kontakte të vazhdueshme me Alumni duke i angazhuar vazhdimisht në aktivitetet e organizuara nga universiteti, më konkretisht në Panairin e punës në vitin 2021. Praktika në IAL të tjera në vend tregojnë që ky burim informacioni është shumë i vlefshëm për konsolidimin e kërkimit të tregut.</p> <p><b><i>GVJ rekomandon që kjo zyrë mund të mbledhë informacione cilësore duke drejtuar një pyetësor të posaçëm për Alumni.</i></b></p> <p><i>Ev.2. Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës.</i>  <i>Ev.103.Memo-Pergjigje Rektoratit në lidhje me vlerësimin e stafit akademik të Departamentit Marketing.</i>  <i>Ev.104.Pyetësor online për studentët nga Njësia Kryesore për vlerësimin e stafit administrativ dhe akademik.</i>  <i>Ev.105.Raport vlerësimi për stafin akademik nga studentët shembull.</i>  <i>Ev.106.Pyetësor per studentet Bsc MM mbi permisimin e metodikes se mesimdhënies.</i>  <i>Ev.107.Relacion i NjBSC mbi realizimin e mesimdhënies online dhe pyetesori.</i>  <i>Ev.108.Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD.</i>  <i>Ev.109.Model pyetësori për vlerësimin e stafit akademik.</i>  <i>Ev.118.Analiza e rezultateve të anketimit për studentët, stafin akademik dhe administrativ).</i></p>
	<p><i>Ev.10.Formular vetvleresimi.</i>  <i>Ev.111.Urdheri i Rektorit per ngritjen e NjSBC.</i>  <i>Ev.83.Vendim grupi i punes_paniri i punes dhe i karrieres.</i></p>



	Ev.84. Draft Agjendë panairi i punës dhe i karrierës 2022. Ev.99. UAMD Udhëzues nga Qendra e Karrierës dhe Alumni.			
<b>Konkluzione</b>	GVJ vlerëson që IAL ka krijuar strukturat dhe ka vendosur objektiva të qartë për të garantuar në cilësinë e programit të studimit dhe rekomandojmë një zgjerim të aktiviteteve për të mbledhur sa më shumë gjetje në raport me tregun e punës. Megjithëse IAL bën përpjekje të vazhdueshme për të përmirësuar cilësinë, GVJ rekomandon konsolidimin e raportit të cilësisë si mundësi për evidentimin e gjetjeve dhe për përmirësimin e mëtejshëm të programit të studimit. Si dhe rekomandon pasurimin e paketës së monitorimit në drejtim të vlerësimit të cilësisë që targeton psh fokus grupet.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi VI.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Strukturat e ngritura dhe procedurat e zbatuara janë në përputhje me Kodin e Cilësisë në Republikën e Shqipërisë, si edhe me Manualin “Per Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit”.  KPSSC dhe NJSBC si strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë mbështeten nga eksperti i jashtëm dhe nga ai ligjor në përmbushjen e detyrave dhe bazohen në respektimin e procedurave të sanksionuara në Rregulloren e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD.  <i>Ev.2. Statuti i UAMD.</i> <i>Ev.108. Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	KPSSC dhe NJSBC kanë hartuar një rregullore të brendshme për organizimin dhe punën e Komisionit të Përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë, si edhe njësimin e sigurimit të cilësisë. Kjo rregullore është hartuar duke u bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë Nr. 80/2015, nenin 103 dhe 104, dhe në kreun e VII-të të Statutit të UAMD, si edhe në Rregulloren e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD.  <i>Ev.2. Statuti i UAMD.</i> <i>Ev.108. Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD.</i>
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin	KPSSC dhe NJSBC së bashku me Dekanët e Fakulteteve dhe Drejtuesin e Departamentit të Menaxhim Marketing janë përgjegjës për çështjet e cilësisë, duke monitoruar të gjitha proceset aktivitetet dhe veprimtaritë

<p>e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>si akademike edhe të shërbimeve, falë mekanizmave të përmendura më lart.</p> <p><i>Ev.2. Statuti i UAMD.</i> <i>Ev.108. Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>IAL përfshin aktorë të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit. Kjo evidentohet nga mekanizmat e përmendur më sipër si dhe vendimet e marra për krijimin e Grupeve të Vlerësimit të Brendshëm. Nga takimi me GVB u evidentua pjesëmarrja e një pedagogu të jashtëm i cili vjen nga fusha e biznesit. Po kështu në këtë grup ishte prezent dhe një student.</p> <p><i>Ev.2. Statuti i UAMD.</i> <i>Ev.108. Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD.</i> <i>Ev.120. Takim informues i NJSBC me koordinatore të GVB-te</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vryera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Nga takimi i GVJ me drejtuesin e Departamentit të Marketingut evidentohet që për hapjen e programit të studimit Menaxhim Marketing janë përdorur inputet e një sërë aktorëve si studentët e punësuar, praktika ndërkombëtare, si dhe biznesi. Nga konsultimet me ta u krijua një program studimi i cili ndërthurte tre shkenca, përkatësisht, marketing, komunikim dhe lëndë IT-je. Peshë e lëndëve ekonomike është ulur ndjeshëm për të plotësuar nevojat specifike që lidhen me menaxhimin e aktiviteteve të marketingut. Po kështu përgjegjësi i departamentit të Marketingut pohoi që IAL do të realizojë çdo vit panarin e punës. Në këtë panair mund të merret feedback nga bizneset. Për këtë qëllim është zhvilluar një pyetësor për të matur impaktin e panairëve në punësimin e studentëve. <i>Megjithatë GVJ nuk e ka evidentuar një praktikë të tillë.</i> Për më tepër në analizën e departamentit nuk ka një evidencë për punësimin e studentëve në lidhje me fushën e programit të studimit që ata kanë ndjekur, më konkretisht BA në Menaxhim Marketing. Gjithashtu përgjegjësi i departamentit pohoi se nga marrëveshjet që IAL ka me bizneset do të bëhet e mundur shpallja në portal e nevojave të tyre. <i>GVJ vëren se pavarësisht marrëveshjeve, departamenti duhet të bëjë edhe një monitorim të efektivitetit të tyre në raport me këtë program studimi me indikatorë konkretë si numri i praktikave, punësimit të studentëve, takime për sugjerime kurrikule etj.</i></p> <p><i>Ev.13. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit.</i> <i>Ev.16. Marrëveshjet e bashkëpunimit Dep Marketingut.</i> <i>Ev.18. Marrëveshje Bashkëpunimi UAMD.</i> <i>Ev.19. Lista e marrëveshjeve bilaterale për shkëmbime.</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson që për programin e studimit Bachelor në Menaxhim Marketing, IAL përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim</i></p>

	të tyre. GVJ vëren se pavarësisht marrëveshjeve, departamenti duhet të bëjë edhe një monitorim të efektivitetit të tyre në raport me këtë program studimi me indikatorë konkretë si numri i praktikave, punësimit të studenteve, takime per sugjerime kurrikule etj.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi VI.5</b>	
<b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Politikat dhe procedurat që lidhen me sistemin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për të gjitha programet e studimit përfshihen në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë dhe Statutin e UAMD. Po kështu, IAL ka hartuar edhe strategjinë e komunikimit në UAMD. Qëllimi i kësaj strategjie është të forcojë imazhin e UAMD-së si si një institucion akademik elitare, me kërkim shkencor të standardeve më të larta akademike, në zhvillim të vazhdueshëm. Në strategjinë e tij, UAMD synon në mënyrë të vazhdueshme të arrijë standardet akademike bashkëkohore, si dhe të përkrahë aspiratat arsimore dhe arrijtjet e kujtdo që kërkon të përfitojë nga arsimit i lartë.</p> <p>Përmirësimi i nivelit të komunikimit dhe informimit përmes zgjerimit të grupeve të audiencës me të cilat duhet komunikojë UAMD dhe brandimi i pikave të forta (sipas fakulteteve) nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Intensifikimit të komunikimit brenda universitetit dhe normimin e tij përmes një rregulloreje të posaçme;</li> <li>• Krijimin e strukturave informuese për çdo fakultet, për komunikimin me publikun dhe brandimi i pikave të forta të secilit fakultet;</li> </ul> <p>Në kuadër të transparencës UAMD në faqen web (<a href="https://uamd.edu.al/transparenca/">https://uamd.edu.al/transparenca/</a>) ka të paraqitur të gjithë elementët strategjikë e rregullatorë të institucionit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pyetësor mbi mësimdhënien Online;</li> <li>• Raporti i Vetëvlerësimit;</li> <li>• Relacion i Njësisë së Sigurisë së Brendshme të Cilësisë mbi “Pyetësorin e studentëve për realizimin e mësimin online”;</li> <li>• Rregullore e Njësisë së Sigurisë së Brendshme të Cilësisë;</li> <li>• Raport i përmbledhur.</li> </ul> <p><i>Ev.80.Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit _ Karrierës.</i> <i>Ev.101.Strategjia e Komunikimit – UAMD.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e</p>	<p>Në UAMD në përputhje me nenin 7 të ligjit 119/2014“ Për të drejtën e informimit” është përgatitur programi i transparencës i cili konsiston në</p>

<p>vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>përcaktimin e rregullave bazë të organizimit dhe të funksionimit të universitetit në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë. Programi i transparencës në UAMD i shërben rritjes së transparencës, integritetit dhe përgjegjshmërisë institucionale të universitetit sipas objektit dhe qëllimit të këtij ligji duke pasur parasysh interesin më të mirë të publikut <a href="https://uamd.edu.al/program-i-transparences">https://uamd.edu.al/program-i-transparences</a>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Vlerësimet e kryera dhe rezultatet përkatëse për programin pasqyrohen në Raportin Vjetor të Departamentit dhe shoqërohen me një plan veprimi. Duke u nisur nga ky plan veprimi dhe bazuar në një kalendar të brendshëm, Rektorati i kërkon Përgjegjësve të Departamenteve dhe Dekanëve që të hartojnë projekt-buxhetet e tyre me zërat përkatës duke përfshirë nevojat akademike dhe aktivitetet e departamenteve që synojnë rritjen dhe përmirësimin e cilësisë akademike.</p> <p><i>Ev.21. Dep Marketingut Analiza Vjetore 2019-2020</i>  <i>Ev.115. Raporti-i-Vetevleresimit 2019-2020 NJSBC.</i>  <i>Ev.116. RVB e fakultetit te biznesit 2020-2021.</i>  <i>RVB Bsc. Menaxhim Marketing.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ vlerëson si u përmend më lart që raportet dhe analizat mësimore kërkimore bazohen te metodologjia e NJSBC-së. <i>Megjithatë, IAL duhet të bëjë më shumë përpjekje për të hartuar indikatorë SMART në strategjinë e zhvillimit të IAL dhe departamentit përkatës. Vetëm në këtë mënyë do të mund të zhvillohet një proces monitorimi dhe vlerësimi.</i></p> <p><i>Ev.21. Dep Marketingut Analiza Vjetore 2019-2020</i>  <i>Ev.115. Raporti-i-Vetevleresimit 2019-2020 NJSBC.</i>  <i>Ev.116. RVB e fakultetit te biznesit 2020-2021.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Sipas RVB, por edhe nga takimet, evidentohet që personeli akademik i Departamentit të Marketingut-UAMD është vazhdimisht i informuar mbi rezultatet e procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë. Analizat e punës mësimore shkencore të zhvilluara periodikisht, analizat e pyetësorve të pedagogëve dhe të programit u bëhen me dije përmes mbledhjeve përkatëse në nivel departamenti dhe fakulteti. Studentët janë gjithashtu pjesë e këtij procesi përmes përfaqësuesve të tyre në organet e UAMD-së.</p> <p><i>Ev.116.RVB e fakultetit te biznesit 2020-2021.</i>  <i>Ev.108.Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD.</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ vlerëson që IAL bën përpjekje të vazhdueshme për të bërë publike politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit por edhe elementë të tjerë të lidhur me të. <i>Megjithatë, IAL duhet të bëjë më shumë përpjekje për të hartuar indikatorë SMART në strategjinë e zhvillimit të IAL dhe departamentit përkatës.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë në “Menaxhim Marketing”, ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës**

**Pika të forta dhe afirmime:**

1. Përvoja shumë vjeçare në tregun e arsimit të lartë të UAMD mbështet konsolidimin e programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Marketing” në përputhje të plotë me misionin dhe objektivat e përcaktuara në strategjinë e zhvillimit të programit.
2. Ndërkombëtarizimi i vazhdueshëm i stafit të angazhuar në programin e studimit dhe pjesëmarrja në projekte/mobilitete trajnimi, i mundëson personelit akademik dhe studentëve të përfitojnë nga shkëmbimi dhe bashkëveprimi me kërkues shkencor nga vendet e Bashkimit Evropian, përfshirë këtu pjesëmarrjen në trajnime dhe konferenca tematike.
3. Staf i angazhuar në programin e studimit ka eksperiencë të mëparshme në fushën e biznesit, drejtimi i institucioneve publike e private në qark, duke luajtur një rol të rëndësishëm në ndërveprimin universitet - biznes ose departament - biznes.
4. Staf proaktiv dhe i angazhuar në projekte kombëtare e ndërkombëtare dhe në organizimet shkencore të UAMD.
5. Godina, biblioteka, ambjentet mësimore janë të një standardi të lartë duke krijuar në këtë mënyrë një mjedis që mbështet arritjen e objektivave të programit të studimit.
6. Marrëveshje bashkëpunimit me institucione private e publike që garantojnë dhe forcojnë marrëdhënien me tregun e punës.

**Pika të dobëta:**

1. Mungesa e përfshirjes në kurrikulën e programit të studimit të disa lëndëve si inovacioni, psikologjia, sociologjia, digjitalizimi në biznesin e vogël, apo lëndë nga turizmi, të cilat për nga pikëpamja e përmbajtjes kanë më tepër rëndësi për studentët në menaxhimin e proceseve të marketingut, krahasuar me disa lëndë të përfshira në program, si Rajonizimi Ekonomik apo Hyrje në Shkencat Politike, me të cilat mund të zëvendësohen (**Standardi II.1, kriteri 2; Standardi III.4, kriteri 1**).
2. Klasifikimi i disa prej lëndëve të programit (*Drejtim i Burimeve Njerëzore, E-Marketing, Menaxhim Shitje*) sipas kategorive formuese nuk është i përshtatshëm, duke patur parasysh përmbajtjen e tyre dhe qëllimin e programit të studimit (**Standardi II.1, kriteri 2; Standardi III.4, kriteri 1**).
3. Ngjashmëri e lartë mes programeve të ofruara nga Departamenti i Menaxhimit dhe Departamenti i Marketingut (**Standardi II.4, kriteri 4; Standardi IV.5, kriteri 3**).
4. Disa prej titullarëve të lëndëve nuk i përkasin kategorisë “Profesor”, sikurse kërkohet nga legjislacioni në fuqi, si dhe një pjesë e personelit akademik tejkalon normën mësimore të përcaktuar (**Standardi IV.1, kriteri 1**).
5. Literatura nuk është e 5 viteve të fundit në lëndët si Bazat e Biznesit, Makroekonomi I, Shkrim Akademik, Hyrje në Shkencat Politike, Metodatat e Kërkimit Shkencor, Drejtim Marketing (**Standardi II.4, kriteri 5**), ciklet e leksioneve të përgatitura nga pedagogu



titullar, në disa prej syllabuseve të programit, nuk shoqërohen me një listë të detajuar të burimeve dhe literaturës së përdorur, si dhe në syllabuset e lëndëve nuk pasqyrohet kërkimi shkencor i personelit akademik (**Standardi IV.3, kriteri 2**).

6. Mungesa e një analize të mirëfilltë për të evidentuar kompetenca në ndryshim e sipër për shkak të ndryshimeve dinamike teknologjike (**Standardi II.5, kriteri 1, 2, 3**).
7. Mungesa e analizave për përfitimet konkrete të marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit mësimor (**Standardi I.2, kriteri 4**).

#### Rekomandime:

1. Institucioni, të shikojë mundësinë e zëvendësimit të disa prej lëndëve që ofrohen në program si “Hyrje në Shkenca Politike” apo “Rajonizimi Ekonomik”, me lëndë si psikologji, sociologji, lëndë nga marketingu i turizmit, etj., si dhe të rishikojë klasifikimin e lëndëve “Drejtimit i Burimeve Njerëzore”, “E-Marketing” dhe “Menaxhim Shitje” sipas kategorive formuese (**Standardi II.1, kriteri 2; Standardi III.4, kriteri 1**).
2. Institucioni, të mundësojë diferencimin e programeve të studimit të ofruara nga Departamenti i Marketingut dhe ai i Menaxhimit. Njësia bazë dhe ajo kryesore sugjerohet të promovojnë ndryshimet midis programeve të studimit që ata ofrojnë dhe kë inventar kapacitetesh dhe njohurish kanë objektiv të ofrojnë me segmente punonjësish të caktuar (**Standardi II.4, kriteri 4; Standardi IV.5, kriteri 3**).
3. Institucioni, të marrë masa për zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi lidhur me caktimin si titullar lëndësh personelit akademik të kategorisë “Profesor” dhe mostejkalimin e normës mësimore të përcaktuar nga ana e personelit akademik. (**Standardi IV.1, kriteri 1**).
4. Institucioni, të marrë masa për përditësimin e literaturës në ato syllabuse ku nuk reflektohet literatura e pesë viteve të fundit, ciklet e leksioneve të përgatitura nga pedagogu titullar të shoqërohen me një listë të detajuar të burimeve dhe literaturës së përdorur, si dhe të përfshihen punimet shkencore të pedagogëve në literaturën e rekomanduar apo në rastet studimore të mbështetura (**Standardi II.4, kriteri 5; Standardi IV.3, kriteri 2**).
5. Për të adresuar tkurrjen e numrit të studentëve, rekomandohet për tu patur në konsideratë në të ardhmen një analizë e thellë e avantazhit krahasues të programeve të studimit, të përqendruar në:
  - Ndërthurjen me trendet e tregut: identifikimin e mënyrave se si këto programe i përgjigjen kërkesave aktuale dhe të ardhshme të tregut të punës, si psh. vlerësimi i aftësive digjitale dhe analitike që janë në kërkesë dhe përfshirja e tyre në kurrikula;
  - Bashkëpunimet me Industrinë: krijimi i partneriteteve me kompani dhe organizata për të ofruar praktika, projekte dhe raste studimore që janë të lidhura ngushtë me sfidat reale të biznesit;
  - Përshtatshmëria dhe Inovacioni në Mësimdhënie: integrimi i metodave të reja të mësimdhënies që përfshijnë mësimdhënie hibride, projekte praktike dhe përdorimi i teknologjisë për të pasuruar përvojën e mësimin (**Standardi II.5, kriteri 1, 2, 3**).

6. Institucioni, të realizojë analiza periodike për përfitimet konkrete të marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit mësimor (**Standardi I.2, kriteri 4**).

**Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor in "Marketing Management", provided by the Higher Education Institution "Aleksandër Moisiu" University**

**Strengths and affirmations:**

1. The extensive experience in the higher education market of UAMD supports the consolidation of the Bachelor's study program in "Marketing Management" in full accordance with the mission and objectives set out in the program's development strategy.
2. The continuous internationalization of the staff involved in the study program and participation in training projects/mobilities enable academic staff and students to benefit from exchange and interaction with researchers from European Union countries, including participation in thematic training and conferences.
3. The staff involved in the study program have previous experience in the field of business, managing public and private institutions in the region, playing a significant role in university-business or department-business interaction.
4. Proactive and engaged staff in national and international projects and scientific organizations of UAMD.
5. The buildings, library, and teaching environments are of a high standard, thus creating an environment that supports the achievement of the study program's objectives.
6. Cooperation agreements with private and public institutions guaranteeing and strengthening the relationship with the labor market.

**Weaknesses:**

1. The lack of inclusion in the curriculum of certain subjects such as innovation, psychology, sociology, digitalization in small business, or subjects from tourism, which in terms of content are more relevant for students in marketing process management compared to some subjects included in the program, such as Economic Regionalization or Introduction to Political Science, which could be replaced with them (**Standard II.1, criterion 2; Standard III.4, criterion 1**).
2. The classification of some program subjects (*Human Resource Management, E-Marketing, Sales Management*) according to formative categories is not suitable, considering their content and the purpose of the study program (**Standard II.1, criterion 2; Standard III.4, criterion 1**).
3. High similarity between the programs offered by the Management Department and the Marketing Department (**Standard II.4, criterion 4; Standard IV.5, criterion 3**).





4. Some of the subject holders do not belong to the “Professor” category, as required by current legislation, and some academic staff exceeds the defined teaching norm **(Standard IV.1, criterion 1)**.
5. Literature is not from the last 5 years in subjects such as Business Basics, Macroeconomics I, Academic Writing, Introduction to Political Science, Research Methods, Marketing Management **(Standard II.4, criterion 5)**, lecture cycles prepared by the titular lecturer are not accompanied by a detailed list of used sources and literature, and academic research of the staff is not reflected in the subject syllabi **(Standard IV.3, criterion 2)**.
6. The lack of a thorough analysis to identify changing competencies due to dynamic technological changes **(Standard II.5, criterion 1, 2, 3)**.
7. The absence of analyses for the concrete benefits of cooperation agreements in function of achieving the educational program **(Standard I.2, criterion 4)**.

#### **Recommendations:**

1. The institution should consider the possibility of replacing some of the subjects offered in the program, such as “Introduction to Political Science” or “Economic Regionalization” with subjects like psychology, sociology, tourism marketing, etc., and reconsider the classification of subjects such as “Human Resource Management”, “E-Marketing” and “Sales Management” according to formative categories **(Standard II.1, criterion 2; Standard III.4, criterion 1)**.
2. The institution should enable differentiation between study programs offered by the Marketing Department and the Management Department. The base unit and the main one should promote changes between the study programs they offer, and their inventory of capacities and knowledge should aim to offer specific employee segments **(Standard II.4, criterion 4; Standard IV.5, criterion 3)**.
3. The institution should take measures to implement current legal provisions regarding the appointment of academic staff of “Professor” category as subject holders and adherence to the defined teaching norm by academic staff **(Standard IV.1, criterion 1)**.
4. The institution should update the literature in syllabi where the literature from the last five years is not reflected, lecture cycles prepared by titular lecturers should be accompanied by a detailed list of used sources and literature, and scientific works of lecturers should be included in the recommended literature or supported study cases **(Standard II.4, criterion 5; Standard IV.3, criterion 2)**.
5. To address the decrease in the number of students, it is recommended to consider in the future a thorough comparative analysis of the advantages of study programs, focusing on:
  - **Alignment with market trends:** Identifying how these programs meet current and future demands of the job market, such as assessing digital and analytical skills in demand and integrating them into curricula.
  - **Industry Collaborations:** Establishing partnerships with companies and organizations to offer internships, projects, and case studies closely related to real business challenges.




- Adaptability and Innovation in Teaching: Integrating new teaching methods including hybrid teaching, practical projects, and the use of technology to enrich the learning experience (**Standard II.5, criterion 1, 2, 3**).
6. The institution should conduct periodic analyses to determine the concrete benefits of cooperation agreements in achieving the educational program (**Standard I.2, criterion 4**).

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X